



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës
Kuvendi i Komunës së Junikut
Numër: 002/14
Datë: 22.07.2026

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut
Nga: **Leonard Llojuni** - kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut
Lënda: Mbledhja e shtatë - (2026) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut
Data: 31.07.2026, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Informatë lidhur me gjendjen e Shërbimeve Publike në Komunën e Junikut, për periudhën Janar - Qershor 2026,
2. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Junikut për vitin 2025 dhe planin e Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve,
3. Informatë lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2025-2026, për institucionet Edukative-Arsimore në Komunën e Junikut,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut, për periudhën 2026-2030 (Leximi i parë),
5. Shqyrtimi i raportit financiar, Janar-Qershor për vitin 2026, në Komunën e Junikut,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit për menaxhimin e Tokave Rurale 2026 - 2030 (Leximi i parë),
7. Informatë mbi raportin e performancës së Administratës të Komunës së Junikut, për periudhën Janar - Qershor 2026,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Draftit Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 - 2033, (Leximi i parë),
9. Informatë rreth korrije-shirjeve në Komunën e Junikut për vitin 2026,
10. Formimi i komisionit për emërtimin e zonave të reja të qarkullimit në territorin e Komunës së Junikut,
11. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK / OPŠTINA JUNIK / MUNICIPALITY OF JUNIK

01/No. Prot. 2-155/5120
No. / Broj. 1567
Data 2025

REFERENC-Ë:	Nr. I – 09/19/26
DATE/A:	14.07.2026
PËR/ZA/TO:	z. Leonard Llojuni – Kryesues i Kuvendit Komunal
CC:	z. Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunes
NGA/OD/FROM:	z. Demokrat Ganiqaj – Drejtor për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkese



I nderuar,

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, kërkojmë që të futet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe në atë të Kuvendit Komunal, raportimi informata lidhur gjendjen e Shërbimeve Publike në Komunën e Junikut për periudhën Janar-Qershor 2026.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA/JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

Qs/No. Pril: 4-155/5198
 Nje. Org: 1
 Nr. i flet. 14 / 07 / 2026
 Data



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



DATE/A:	14.07.2026
PËR/ZA/TO:	z. Leonard Llojuni Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shchu -Kryetar i Komunës, Junik
NGA/OD/FROM:	znj. Ardita Hoxha- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e KPF-së dhe Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunes së Junikut për vitin 2025 dhe Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve.

I nderuar,

Bazuar në Rregulloren e Punës për zbatimin e Auditimit dhe Planeve të Veprimit, kërkojmë që të shqyrtohet Raporti i Auditimit nga ZKA-ja për vitin 2025 si dhe Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Të bashkangjitur në kërkesë gjeni Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunes së Junikut për vitin 2025 dhe Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMETARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

04 47 1124 1

Per:	Kuvendi i Republikës së Kosovës Ruzhdi Shehu, Kryetar Kryetar i Komunës së Junikut Kryetarin e Kuvendit Komunal të Komunës së Junikut
Kopje elektronike:	Komisioni i KMFP Komisioni i KBPT
Nga:	Vlora Spanza, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës
SUBJEKTI:	Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Junikut për vitin 2025.

Nr. Zyrës:	Ext:	Data: 23.06.2026
------------	------	------------------

Data	Zyra e Pranimi	Komentet/Veprimet	Iniciale	Nat
		Bashkëngjitur mund të gjeni Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Junikut për vitin 2025. Sipas nenit 23, pikë 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kompetare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimi të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzojë një Plan Veprimi ku përcaktohet se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.		



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBETARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2026

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Junikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Junikut (Junik), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Junikut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Junikut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Junikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Junikut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari

Gjetja

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi (LMFPP) nr. 03/L-048 neni 39.1 përcakton se; çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa sipas nenit 40 fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbartuesi. Po ashtu ligji për marrëdhëniet detyrimeve nr. 04/L 077 neni 382.2 taksativisht parasheh; Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Gjatë testimit të pagesave të ekzekutuara nga komuna, kemi vërejtur se në një (1) rast, fatura në vlerë totale prej 597€ e paraqitur në pasqyra, përfaqësonë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë deri në 50 ditë.

Në rastin tjetër kemi vërejtur se përmes procedurave përmbartimore /gjyqësore dhe në bazë të vendimeve gjyqësore, ishin paguar për kategorinë investime kapitale 149,727€, nga kjo shumë borxhi kryesor ishte 119,334€, kamata 29,499€ dhe pjesa tjetër shpenzime për ekspertizë/avokat/procedura përmbartimore në vlerë 894€. Kjo formë e pagesave, ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve të procesit përmbartimor dhe kamata ligjore.

Hyrja në obligime është si shkak i kontraktimeve dhe realizimeve të punëve pa pasur buxhet të mjaftueshëm dhe mos përgjegjësisë së zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mosrealizimin e pagesave brenda afatit kohorë ligjor që ka rezultuar më pagesën e tyre përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore më shpenzime shtesë për procedurat përmbartimore dhe kamatëvonesat.

Ndikimi

Si pasojë e vonesave në pagesa dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar likuiditetet e saj nga vendimet përmbartimore përmes thesarit ku ka ndikim direkt në rritjen e kostos për komunën.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të objekteve

Gjetja

Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, neni 15, pika 2 përcakton se; Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Nga 1,134 objekte të evidentuara në bazën e të dhënave, komuna ka arritur

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pagat dhe mëditjet

Vlera buxhetore e paraqitur në RVF e kategorisë ekonomike pagat dhe shtesat është 1,654,862.€, gjersa realizimi gjatë vitit është në shume prej: 1,654,450€, apo 99.98% të buxhetit final.

Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e transferimit të punëtorëve

Gjetja

Sipas nenit 6 të Ligjit të pagave nr. 08/L-196, paga përfitohet për punën e kryer me orar të plotë apo punën me orar të pjesshëm që konsiderohet si punë me orar të plotë, në një funksion apo pozitë të caktuar që përcaktohet nga grupi dhe klasa e pagës së cilës i përket funksioni apo pozita, ashtu siç është përcaktuar në shtojcat e këtij ligji.

Nga testimi ka rezultuar se komuna e Junikut, kishte paguar paga për tri (3) zjarrfikës dhe katër (4) pyllëtar të cilët nuk kanë ofruar shërbim për komunën.

Sipas zyrtarëve të komunës këtyre punonjësve paga iu është paguar nga komuna, mirëpo ata nuk janë evidentuar në regjistrin e vijueshmërisë në punë të komunës. Rrjedhimisht ata nuk janë evidentuar në regjistrat e komunës për vijueshmërinë në punë dhe as nuk kanë bërë as kërkesa për pushim dhe të tjera në komunë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos menaxhimit të duhur të vendimit për transferrin e këtyre kategorive të punonjësve, nga niveli qendror.

Ndikimi

Dobësit në transferin e punonjësve nga një institucion në tjetrin, mund të ndikojnë që pagesa e pagave dhe kompenzimeve të tjera të bëhen pa e marrë shërbimin për të cilin janë angazhuar. Mos evidentimi i punonjësve në regjistrin e vijueshmërisë në punë rezulton me pagesë të pagave pa ofruar shërbime në njërin anë, ndërsa në anën tjetër e pengon komunën që të rekrutojë punonjës për vendet e punës nga të cilat nuk merr shërbime.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të marrë veprime që punonjësit e transferuar në institucionet tjera të largohen nga lista e pagave të punonjësve të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^a	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	2,340,142	3,031,115	2,567,139	2,218,403	2,163,218
Grante Qeveritare - Buxheti	2,135,200	2,229,220	2,227,230	2,011,307	1,949,109
Të bartura nga viti i kaluar	0	108,485	107,008	82,728	102,629
Të hyrat vetanake	204,942	204,942	117,546	124,368	111,480
Donacionet vendore	0	18	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	488,450	115,354	0	0


Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për vlerën 690,973€ ose rreth 30%, duke reflektuar një rritje të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit fiskal. Në vitin 2025, janë shpenzuar 2,567,139€, që përfaqëson rreth 85% të buxhetit final, duke treguar një nivel mesatar të realizimit të buxhetit.

Burimi kryesor i financimit mbetet Grantet Qeveritare - Buxheti, ndërsa:

- Të barturat nga viti i kaluar në vlerë 108,485€ kanë kontribuar në financimin e aktiviteteve;
- Të hyrat vetanake në vlerë 204,942€ përbëjnë një burim shtesë financiar;
- Donacionet e jashtme në vlerë 488,450€ kanë pasur ndikim të rëndësishëm në rritjen e buxhetit final, megjithatë realizimi i tyre në shpenzime (115,354€) është dukshëm më i ulët, si rrjedhojë e hartimit të projektit EFFORT në periudhe kohore tre vjeçare dhe
- Donacionet vendore janë në vlerë simbolike dhe pa ndikim të konsiderueshëm.

Krahasuar me vitet paraprake, vërehet një rritje e shpenzimeve në vitin 2025, megjithatë jo në proporcion me rritjen e buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Komuna për vitin 2025 kështu pranu të hyra nga gjat nga trafiku në vlerë 15,355€ të cilat alokohen për shpenzim në baza të rregullta tremujore. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme, pasi ato planifikohen dhe realizohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Buxheti fillestar dhe ai final për të hyrat ishte 204,942€, ndërsa realizimi në vitin 2025 arriti në 151,135€, që përfaqëson rreth 74% të planifikimit buxhetor. Realizimi i të hyrave lidhet me arkëtimin nga tatimi në pronë, taksa për lejet e ndërtimit, taksat rrugore, tarifatat për lëshimin e certifikatave, si dhe nga shërbime të ndryshme administrative, etj.

- Të hyrat tatimore janë realizuar në 101,762€, që përfaqëson rreth 87% të planifikimit dhe mbeten burimi kryesor i të hyrave;
- Të hyrat jo tatimore janë realizuar në 49,373€, që përfaqëson rreth 56% të planifikimit, duke treguar nën-realizim në këtë kategori; dhe
- Të hyrat tjera nuk kanë pasur realizim gjatë vitit.

Krahasuar me vitet 2024 dhe 2023, vërehet një rënie e të hyrave në vitin 2025, duke reflektuar performancë më të dobët në mbledhjen e tyre.


4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare (PFV-të) për vitin 2024 të Komuna e Junikut (KJ) ka identifikuar gjashtë (6) rekomandime për të përmirësuar efikasitetin dhe proceset. KJ ka zhvilluar një plan veprimi për të adresuar këto rekomandime në mënyrë të detajuar.

Gjatë periudhës së auditimit për vitin 2025, katër (4) nga rekomandimet janë zbatuar me sukses, ndërsa dy (2) ende nuk janë adresuar.

Për të dhënë një shpjegim më të detajuar të çdo rekomandimi dhe si janë trajtuar ato, ju lutemi referohuni tabelës 4 në vijim.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak



Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Grup i Operatimeve Ekonomike "Albaudit" SH.P.K. & "ProAudit" SH.P.K.
(Hajdar Hoxha, person i autorizuar në emër të grupit)



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare* duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë opinion të pa-modifikuar nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare,

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.



1-1645023
10 of 2023

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JINIK – OPŠTINA JINIK – MUNICIPALITY OF JINIK



Për : Zyrenë Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës së Jinikut

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit

N r. Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1 Çështja A1 - Vonesa në pagesën e fakturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuar nga thesari	Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi (LMFPF) nr. 03/L-048 neni 39.1 përcakton se, çdo fakturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime e furnizuar dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda (30) ditëve kalendarike pas pranimit të fakturës. Ndërsa sipas neni 40 faktura mund të ekzekutohet direkt nga thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbaruesi. Po ashtu ligji për marrëdhëniet detyrimeve nr. 04/L-077 neni 382.2 taksativisht parashihet: Lartësia e kamatëvonesës është tërë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë. Gjatë testimit të pagesave të ekzekutuara nga komuna, kemi vërejtur se në një (1) rast, faktura në vlerë totale prej 597€ e paraqitur në pasqyra, përfaqësonë faktura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë deri në 50 ditë. Në rastin fjetër kemi vërejtur se përmes procedurave përmbarimore / gjyqësore dhe në bazë të vendimeve gjyqësore, ish-in paguar për kategoritë investive kapitale 149,727€, nga kjo shumë borxhi kryesor ishte 119,334€, kamata 29,499€ dhe pjesa tjetër shpenzime për ekspertizë/avokat/ procedura përmbarimore në vlerë 894€. Kjo formë e pagesave, ka ndikuar edhe	Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.	1. Evidencimi periodik i fakturave të pranuar dhe kontrollimi i pagesës së tyre 2. Raportimi periodik i fakturave të pranuar dhe të papaguara 3. Zotimi i mjeteve dhe inicimi i procedurave të shpenzimit të fakturave brenda afateve ligjore	ZKA Drejtoria e drejtoive ZKP	31.12.2026	

	në rrëfjen e shpenzimeve të procesit përmbartimor dhe kamata ligjore. Hyrja në obligime është si shkallë kontraktive dhe realizimeve të punëve pa pasur buxhet të mjaftueshëm dhe mos përgjegjësi të zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mosrealizimin e pagesave brenda atëdit kohore ligjor që ka rezultuar në pagesën e tyre përmas vendimeve gjyqësore/përmbartimore në shpenzime shtesë për procedurat përmbartimore dhe kamatëvonesat.					
2	Çështja A2 - Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të objekteve Ligji Nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, rreth 15, pika 2 përcakton se: Komuna çdo vit duhet të kryejë veprimet të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës. Nga 1,134 objekte të evidentuara në bazën e të dhënave, komuna ka arritur të kryejë 83 modifikime, apo rreth 7%. Niveli i përqindjes së verifikimit është i ulët, prandaj kërkohen veprimet konkrete për përmirësimin e gjendjes në të terren. Mos verifikimi i pronave, si rezultat i mungesës së anketuesve në terren dhe kontrolleve të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë, si dhe mos funksionimi i sistemit.	Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky buxhet do të ndikojë drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rrëfjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.	1. Hartimi i Planit të Rianketimit 2. Realizimi i verifikimit dhe anketimit në terren nga anketuesi 3. Monitorimi i planit për realizim të 20% të objekteve nga zyra e tatimit në pronë.	ZKA ZKP DBF Udhëheqesja e tatimit në Pronë	30.11.2026	

3	Gëshija B1 - Dobësi në menaxhimin e transferimit të punëtoreve	Sipas nenet 6 të Ligjit të pagave nr. 08/L-196, paga përfshihet për punën e kryer me orar të plotë apo punën me orar të pjesshëm që konsiderohet si punë me orar të plotë, në një funksion apo pozitë të caktuar që përcaktohet nga grupi dhe klasa e pagës së cilës i përket funksioni apo pozita, ashtu siç është përcaktuar në shtojcat e këtij ligji. Nga testimi ka rezultuar se komuna e Junikut, kishite paguar paga për tri (3) zjarëfikës dhe katër (4) pyllëtar të cilët nuk kanë ofruar shërbim për komunën. Sipas zyrtarëve të komunës këtyre punonjësve paga iu është paguar nga komuna, mirëpo ata nuk janë evidentuar në regjistrin e vijueshmërisë në punë të komunës. Kryedhënisti ata nuk janë evidentuar në regjistrat e komunës për vijueshmërinë në punë dhe as nuk kanë bërë as kërkesa për pushim dhe të tjera në komunë. Kjo ka ndodhur si rezultat i mos menaxhimit të duhur të vendimit për transferrin e këtyre kategorive të punonjësve, nga niveli qendror.	Rekomandimi B1 Kryetari duhet të marrë veprime që punonjësit e transferuar në institucionet tjera të largohen nga lista e pagave të punonjësve të komunës.	1. Kërkese përfaqësuesve për gjegjësinë për mundësinë e transferimit 2. Aprovimi nga institucionet për gjegjësinë për transferim të stafit 3. Barja e stafit tek institucionet përkatëse	ZKA Udhëheqësi i personelit DSHPIIM DZHE DBF	31.12.2026	Komenti ynë është se pas hartimit të planit të veprimit zbatimi i këtij rekomandimi nuk varët nga komuna e Junikut por nga niveli Qendror
4	Gëshija B2 - Menaxhimin jo efikas i logarive të arkëtueshme	Sipas nenet 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të kështjellë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se	Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të	1. Evidentimi i borjeve në baze të krijuara të vendosura për klasifikimin e tyre 2. Njoftimet për shlyerjen e obligimeve 3. Mënyra e masave për	ZKA DBF DZHE ZKF Udhëheqësi i sektorit të tatimit në prone	31.12.2026	

	dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Komuna në RVF e vitit 2025 ka shpalosur llogarit të arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 265,600€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 262,850€ dhe qiraja nga objektet publike 2,750€, vetëm tatimi në pronë është ritur për 26,818€ në krahasim me vitin 2024. Komuna kishhte proceduar njoftimit për tatim paguesit, nëtëpo edhe për kunder kësaj, llogarit e arkëtueshme janë ritur.	arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	ekzekutim të detyrueshëm të borjeve				
--	---	--	-------------------------------------	--	--	--	--

Kryetar i Komunës së Junikut

Ruzhdi Shehu



Data: 10.07.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	13.07.2026
Referenc:	7/18
PËR/ZA/TO:	z.Leonard Lolluni Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shchu -Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z.Xhavit Velijaj- Drejtori për Arsimit, Kulturë, Rinë dhe sport (DAKRS)
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informata lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2025-2026 për Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunë e Junikut.

I nderuar,

Duke u bazuar në planin e punës së Kuvendit Komunal, kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të KPF-së dhe në mbledhjen e Kuvendit Komunal të shtohet si pikë e rendit të ditës informata lidhur me përfundimin e vitit shkollor 2025-2026 për institucionet edukativo-arsimore në komunë e Junikut.

Kjo pikë e rendit të ditës është e rëndësishme për të informuar anëtarët e kuvendit për ecurinë e vitit shkollor 2025-2026, sfidat dhe sukseset e arrituara, si dhe për të diskutuar mbi planet dhe përmirësimet e mundshme për vitin shkollor të ardhshëm.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY JUNIK

DRAFT PLANI ZHVILLIMOR I ARSIMIT I KOMUNËS SË JUNIKUT 2026-2030 (leximi i parë)

Korrik 2026

Grupi punues për hartimin e planit zhvillimor I ARSIMIT PER Komunën e Junikut 2026-2030

1. Xhavit Velijaj- Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kryesues i grupit punues
2. Klodiana Pepshi-Zyrtare e lartë e arsimit
3. Nezir Shehu-Drejtor i Gjimnazit “Kuvendi i Junikut”
4. Bekim Gaxherri-Drejtor i SHFMU “Edmond Hoxha”
5. Jetmira Gaxherri- U.D e IP “Yjet e Gjeravicës”

Përmbajta

<i>Përmbajtja</i>	2
<i>Lista e shkurtesave</i>	3
<i>Përmbledhje ekzekutive</i>	4
<i>1. Hyrja dhe metodologjia</i>	5
<i>2. Sfondi</i>	6
<i>2.1. Arsimi në Komunën e Junikut</i>	6
<i>2.2. Analiza e gjendjes</i>	8
<i>2.2.1. Menaxhimi i arsimit dhe autonomia e shkollës</i>	9
<i>2.2.2. Mjedisi shkollor dhe gjithëpërfshirja</i>	10
<i>2.2.3. Sigurimi i cilësisë dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve</i>	12
<i>2.2.4. Zbatimi i kurrikulës së re</i>	13
<i>2.2.5. Arsimi dhe aftësimi profesional</i>	14
<i>3. Qasja strategjike për zhvillimin e arsimit në Komunën e Junikut</i>	15
<i>3.1. Vizioni, misioni dhe vlerat e arsimit në Komunën e Junikut</i>	15
<i>3.2. Objektivat strategjike dhe masat</i>	16
<i>3.2.1. Menaxhimi dhe autonomia e shkollës</i>	17
<i>3.2.2. Mjedisi shkollor dhe gjithëpërfshirja</i>	2019
<i>3.2.3. Sigurimi i cilësisë dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve</i>	20
<i>3.2.4. Zbatimi i kurrikulës së re</i>	23
<i>3.2.5. Arsimi dhe aftësimi profesional</i>	25

3.3. Analiza e rrezikut për Planin Zhvillimor të Arsimit dhe masat parandaluese.....	27
3. Plani i zbatimit dhe e buxheti	32-
5. <u>Shtojca 1: Korniza për vlerësimin e planit zhvillimor</u>	32
Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi	48

Lista e shkurtesave

PZhAKJ - Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Junikut

IEA- Institucionet edukativo arsimore

IP – Institucioni Parashkollor

PIA – Plani individual për Arsim

MASH – Ministria për Arsim dhe Shkencë

DAKRS –Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

SËOT- Strengths (Pikat e forta), Weaknesses (Dobësit), Opportunities (mundësit), Threats (Kërcënimet)

SAK – Strategjia e Arsimit të Kosovës

OS - Objektiv Strategjik

PZhSh - Plani Zhvillimor i Shkollës

SC -Sigurimi i Cilësisë

SMIA -Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim

UA - Udhëzim Administrativ

ZHPM- Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

IP – Institucionet Parashkollor

KDIEA – Këshilli drejtues i Institucioneve Edukativo Arsimore

EPRBM - Ekipi për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit

ShMU – Shkolla e Mesëm e Ulët

ShML - Shkolla e Mesëm e Lartë

KKK – Korniza Kurrikulare e Kosovës

KK – Korniza Kurrikulare

IAAP-Institucioi per Arsimin dhe Aftësimin Profesional

Përmbledhje ekzekutive

Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Junikut është dokumenti kryesor për zhvillimin e sektorit të arsimit në komunë në periudhën 2026-2030. PZhAKJ, bazohet në Planin Plani Zhvillimor Komunal i Junikut 2024- 2033, në Strategjinë e Arsimit 2022-2026 të MASH dhe analizën e gjendjes të fushave prioritare të sektorit të arsimit në komunë.

Përgatitjen e PZHAKJ 2026-2030 e ka udhëhequr DAKRS përmes grupit punues dhe konsulentëve të jashtëm, si dhe në bashkëpunim me mësimdhënës, drejtorë të shkollave dhe zyrtarë të arsimit të komunës. Procesi i punës është realizuar nëpër katër faza dhe grupi punues për hartim të PZhAKJ, ka përcaktuar pesë fusha kryesore të veprimit:

Fusha 1:Menaxhimi i arsimit dhe autonomia e shkollës;

Fusha 2:Infrastruktura dhe gjithpërfshirja e IEA;

Fusha 3:Sigurimi i cilësisë në arsim dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve;

Fusha 4:Zbatimi i kurrikulës së re dhe

Fusha 5:Arsimi dhe aftësimi profesional.

PZHAKJ ka 5 objektiva strategjike, të përcaktuara për 5 fushat prioritare. Objektivat adresojnë problemet e identifikuara në kuadër të fushave të arsimit në komunë. Pastaj,

fushat janë të caktuara në bazë të objektivave strategjike të cilat janë të zbërthyer në aktivitete të caktuara për arritjen e Objektivat Strategjike.

Objektivi strategjik 1: Menaxhimi i arsimit dhe autonomia e shkollës

Objektivi strategjik 2: Infrastruktura dhe gjithëpërfshirja e IEA

Objektivi strategjik 3: Sigurimi i cilësisë dhe zhvillimi profesional i mësimeve

Objektivi Strategjik 4: Zbatimi i kurrikulës së re

Objektivi strategjik 5: Arsimi dhe aftësi profesionale

Për secilin objektiv strategjik është përgatitur plani i veprimave dhe aktivitetet që shpërndihen në arritjen e objektivit, brenda periudhës katër vjeçare duke i parashikuar implikimet buxhetore. Po ashtu është zhvilluar analiza e gjendjes gjithashtu identifikon masat parandaluese për rreziqet e perceptuara për zbatimin e PZHAKJ.

Gjithashtu, pjesë e Planit Zhvillimor është korniza për vlerësimin e performancës, e cila përcakton treguesit mbi bazën e të cilëve do të vlerësohet progresi për secilin nga pesë objektivat e Planit Zhvillimor.

Grupi punues për hartimin e këtij plani ka përcaktuar vizionin, misionin, vlerat dhe parimet përkatëse.

Vizioni: Të ndërtoj një arsim modern, gjithëpërfshirës dhe cilësor, që zhvillon potencialin e çdo nxënësi, promovon inovacionin, vlerat qytetare dhe përgadit të rinjtë për sfidat e së ardhmës në një shoqëri demokratike dhe të zhvilluar.

Misioni: Ofroj arsim dhe edukimit cilësor për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e komunës, duke zhvilluar njohuri dhe aftësi për në jetë, mundësi të barabarta për punë dhe pjesëmarrje aktive në shoqëri.

Vlerat:

Vendim marrja demokratike në arsim, diversitet, mirëqenia e të gjithë fëmijëve, klima pozitive, respekti dhe besimi reciprok, etika, bashkëpunimi, si dhe respektimi i vlerave tradicionale dhe gjuhës letrare në shkollë.

Parimet mbështetëse:

- Parimi i transparencës dhe llogaridhënies;
- Parimi i gjithëpërfshirjes dhe integritetit;
- Parimi i kodit etik dhe konfidencialitetit;
- Parimi i të nxënësit gjatë gjithë jetës; dhe
- Parimi i profesionalizmit

1. Hyrja dhe metodologjia

Hartimi i PZHAKJ është iniciuar, mbështetur dhe drejtuar nga (DAKRS) në Komunën e Junikut.

Procesi është karakterizuar me pjesëmarrje të gjerë të drejtorëve të shkollave të komunës, zyrtarëve të komunës dhe me konsultime të vazhdueshme me DAKRS-në dhe ekspertë të jashtëm.

Ky proces është zhvilluar në katër faza kryesore:

Faza 1: Analiza e gjendjes ekzistuese

Në këtë fazë janë analizuar dokumentet e politikave, legjislacioni dhe raportet e ndryshme relevante. DAKRS në Junik, për grupin punues ofroi të gjitha të dhënat e nevojshme në dispozicion për institucionet edukativo arsimore para-universitare në nivel komune, duke përfshirë edhe planet tjera zhvillimore në nivel të komunës së Junikut.

Grupi punues për planifikim dhe hartim të PZhAKJ, përcaktoi pesë fusha të veprimit me interes për arsimin në Komunën Junikut:

- Menaxhimi i arsimit dhe autonomia e shkollës;
- Infrastruktura dhe gjithëpërfshirja në IEA;
- Sigurimi i cilësisë dhe zhvillimi profesional i mësimeve;
- Zbatimi i kurrikulës së re; dhe
- Arsimi dhe aftësimi profesional.

Grupi punues në bashpunim me DAKRS ka organizuar puntori në muajin korrik 2026 ,ku moren pjesë përfaqësues nga IEA të komunës dhe përfaqësues nga komuna ku u analizua gjendja ekzistuese e arsimit në komunën e Junikut, për të përcaktuar analizën e gjendjes u shfrytëzuar metoda SWOT.

Faza 2: Përcaktimi i objektivave strategjike dhe masave për arritjen e tyre

Bazuar në shqyrtimin e analizës së gjendjes, në këtë fazë janë identifikuar sfidat kryesore për secilën fushë të intervenimit, pastaj janë përcaktuar objektivat strategjike për secilën fushë të intervenimit si dhe masat për arritjen e tyre. Kjo siguroi që të përcaktohet vizioni dhe misioni për zhvillimin e arsimit në komunë.

Faza 3: Hartimi i planit të veprimit dhe buxhetit

Në këtë fazë, në bashkëpunim me zyrtarët e komunës, si dhe me pjesëmarrjen e grupit punues, është hartuar plani i veprimit dhe buxheti i PZhAKJ. Plan i veprimit është realizuar sipas formatit të përcaktuar. Grupi punues ka përcaktuar buxhetin për të gjitha masat dhe aktivitetet e parapara për periudhën trevjeçare, duke e ndarë në kategori varësisht prej burimit të financimit, si dhe është detajuar plani i zbatimit të këtij plani zhvillimor të arsimit për periudhën trevjeçare, duke përcaktuar institucionet përgjegjëse për zbatim.

Faza 4: Hartimi i dokumentit të Planit Zhvillimor për Arsim të Komunës së Junikt 2026-2030

Në bazë të dokumenteve të hartuara gjatë procesit, në përfundim të tij u hartua edhe drafti i PZHAKJ, i cili, pasi u shqyrtua nga Grupi për hartimin e PZHAKJ -së, mori formën e draftit përfundimtar. Drafti u shqyrtua dhe u aprovua nga Kuvendi i Komunës.

2. Sfondi

2.1. Arsimi në Komunën Junik

Komuna Junik përfshinë 77.78 km², në të cilën jetojnë 3943 (2024) banorë, përkatësisht. Komuna Junik ka gjithsej 3 vendbanime. Në komunë janë të përfaqësuara të gjitha nivelet e arsimit para-universitar në Kosovë. Në këtë drejtim, Komuna Junik ka 3 institucione të nivelit parashkollor, fillor të mesëm të ulët, dhe të mesëm të lartë. Procesi mësimor zhvillohet në gjuhën shqipe. Numri i institucioneve arsimore sipas niveleve dhe numri i fëmijëve dhe nxënësve që vijnë në mësimet në secilin nivel është dhënë në tabelën 1.

Tabela 1. Numri i institucioneve arsimore dhe numri i fëmijëve dhe nxënësve sipas niveleve për vitin shkollor 2025-2026

Nr.	Niveli	Të dhënat për institucionet	Meshkuj	Femra	Gjithsej
1	Edukimi Parashkollor (0-5 vjeç)	IP “Yjet e Gjeravicës” 2-grupe	28	19	47
2	Edukimi Parafillor	SHFMU “Edmonf Hoxha” 1 paralele	8	10	34
3	Arsimi Fillor [Klasa 1-5]	SHFMU “Edmonf Hoxha” 13 paralel	98	77	175
4	Arsimi i mesëm i ulët [Klasa 6-9]	SHFMU “Edmonf Hoxha” 12 paralel	108	97	205
5	Arsimi i mesëm i lartë [Klasa 10-12]	Gjimnazi “Kuvendi I Junikut”-6 paralele	74	77	151

Tabela 2. Trendi i lëvizjes së numrit të nxënësve në pesë vitet e fundit

Nr	Niveli	2021/2022	2022/2023	2023/2024	2024/2025	2025/2026
1	Edukimi Parashkollor (0-5 vjeç)	20	25	25	25	47
2	Edukimi Parafillor	35	33	35	34	22
3	Arsimi Fillor (Klasa 1-5)	277	247	220	202	175

4	Arsimi i mesëm i ulët (Klasa 6-9)	211	216	219	202	205
5	Arsimi i mesëm i lartë (Klasa 10-12)	178	166	159	160	151
Gjithsej		721	687	658	623	600

Trendi i lëvizjës së nxënësve në pesë vitet e paraqitura në tabelën nr. 2 vërehet trendi i ramjes së numrit të nxënësve . Kjo rënje është si pasoj e migrimit të familjeve në qendrat urbane më të mëdha se Juniku dhe migrimit jashtë vendit në shtetet e zhvilluara siq janë Gjermani, Zvicerr, Francë, Itali, Slloveni , Kroaci etj.

Rënja numrit të nxënësve ndikon në zhvillimin normal të procesit mësimor, zvoglimit të paraleleve, szvoglimi i normativës për mësimdhënësve dhe zvoglimit të buxhetit, ku të gjithas këto janë të kalkuluara për numër të nxënësve.

Tabela 3. Numri i mësimdhënësve sipas niveleve të Institucioneve Edukativo-Arsimore dhe për vitin shkollor 2025/2026

Nr.	Niveli	Numri i mësimdhënësve dhe edukatoreve		
		M	F	GJ
1	Edukimi Parashkollor (0-5 vjeç)		6	6
2	Edukimi Parafillor,		1	1
2	Arsimi Fillor (Klasa 1-5)	1	12	13
2	Arsimi i mesëm i ulët (Klasa 6-9)	4	19	23
3	Arsimi i mesëm i lartë (Klasa 10-12)	7	6	13
Total:		12	44	76

Tabela 4. Numri i mësimdhënësve sipas niveleve të Institucioneve Edukativo-Arsimore dhe raporti mësimdhënës – nxënës për vitin shkollor 2025/2026

Nr.	Niveli	Numri i mësimdhënësve dhe edukatoreve	Nr. Fëmijëv dhe Nxënësve	Raporti Mësimdhënës - Nxënës
1	Edukimi Parashkollor (0-5 vjeç)	6	47	7.8
2	Edukimi Parafillor,	1	18	22
2	Arsimi Fillor (Klasa 1-5)	13	170	13.5
2	Arsimi i mesëm i ulët (Klasa 6-9)	23	203	9.6
3	Arsimi i mesëm i lartë (Klasa 10-12)	13	151	11.6

Tabela 5. Shpenzimet publike për arsimin në Komunën e Junikut - një pasqyrë nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026 për fushën e arsimit në nivel komune.

Drejtoria/Programi / Kategoria ekonomike	Vlerësimi për vitin 2024	Vlerësimi për vitin 2025	Vlerësimi për vitin 2026
Paga dhe mëditje	514.1	540.4	678.9
Mallra dhe shërbime	56.6	60.7	65.7
Komunali	8.6	10.9	11.25
Subvencione/transfere		20.0	20.0
Shpenzime kapitale	10.0	10.0	10.0

2.2. Analiza e gjendjes

Të dhënat për arsimin janë siguruar nga DAKRS, të bazuar në të dhënat nga Institucionet edukativo arsimore, Planin Zhvillimor Komunal 2024-2033 dhe Strategjinë e Arsimit të Kosovës 2022-2026. Gjithashtu është organizuar puntori me grupet e interesit që të japim kontributin në plotsimin e të dhënave të nevojshme për PZHAKJ.

Grupi për planifikim është pajtuar që përqëndrimi i Planit Zhvillimor për Arsimin në Komunën e Junikut të jetë në pesë fusha kryesore, të cilat kanë ndërlidhje në mes vete dhe plotësojnë njëra-tjetrën.

1. Menaxhimi i arsimit dhe autonomia e shkollës;
2. Infrastruktura dhe gjithëpërfshirja në IEA;
3. Sigurimi i cilësisë dhe zhvillimi profesional edukatoreve dhe mësimeve;
4. Zbatimi i kurrikulës së re dhe
5. Arsimi dhe aftësimi profesional.

Fushat e veprimit të PZhAKJ-së kanë ngjashmëri me objektivat strategjike specifike të SAK 2022-2026, fushat e planeve zhvillimore në komunat tjera të hartuara në bazë të Kornizës për Planet zhvillimore komunale, por me dallime të caktuara në përshkrimin e fushave, në bazë të specifikave të arsimit në komunën e Junikut.

- *Fusha e parë - Menaxhimi i arsimit dhe autonomia e shkollës*, i referohet përmirësimit të kapaciteteve për menaxhimin e arsimit dhe shkollave në nivel të komunës, planifikimit strategjik të arsimit në nivel komune, shtimit të transparencës dhe llogaridhënies, menaxhimit të personelit, si dhe aspekteve të tjera organizative në fushën e menaxhimit të arsimit në Komunën e Junikut.
- *Fusha e dytë - Infrastruktura dhe gjithëpërfshirja në IEA*, i referohet: përfshirjes së fëmijëve në edukim parashkollor 3-5 vjeç, aspekteve që lidhen me gjithëpërfshirjen në arsim,

rregulloreve për arsim në nivel të gjitha IEA, përfshirjes së prindërve në proceset që zhvillohen në IEA që lidhen me rolin e tyre, si dhe infrastrukturës së institucioneve arsimore, etj.

- *Fusha e tretë - Sigurimi i cilësisë dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve*, përfshinë mekanizmat për sigurim të cilësisë së arsimit në nivel të komunës, planifikimin zhvillimor në IEA në nivel të komunës, si dhe përqendrohet në zhvillimin profesional të mësimdhënësve.
- *Fusha e katërt- Zbatimi i kurrikulës së re*, kryesisht përqendrohet në adresimin e sfidave që lidhen me zbatimin e reformës kurrikulare, trajnimin udhëheqësve të shkollave dhe mësimdhënësve për zbatim të kurrikulës, sigurimin e mjeteve dhe burimeve mësimore të nevojshme për zbatimin e kurrikulës.
- *Fusha e pestë – Arsimi, dhe aftësimi profesional*, është fushë sektoriale dhe përqendrohet në një aspekt të rëndësishëm të lidhjes së arsimit, digjitalizimin e arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë edhe praktikën profesionale, si dhe këshillimin dhe orientimin në karrierë.

2.2.1. Menaxhimi i arsimit dhe autonomia e shkollës

- Në fushën e menaxhimit të arsimit në nivel komune dhe autonominë e shkollave, Komuna e Junikut respektivisht DAKRS është e përkushtuar në bashkpunimin nder institucional. DAKRS ne bashkpunim me IEA ka adresuar qështjet me rendësi për funksionalitetin e tyre, janë siguruar dokumentet ligjore dhe dokumentacioni pedagogjik, është përmirësuar menaxhimi i financave, janë fuqizuar organet në IEA.
- IEA në Komunën Junik, kanë themeluar organet qeverisëse, mirëpo mbetet sfida në funksionalitetin e tyre .

- Kuadri udhëheqës i IEA, akoma funksionon në bazë të kërkesave që vijnë nga DAKRS dhe MASH, nuk vërehet ndonjë përparim në iniciativa dhe përqendrimet në proceset e udhëheqjes, menaxhimit, mësimdhënies e nxënies, si dhe në rezultatet mësimore të shkollës. Në anën tjetër, zyrtarët në DAKRS akoma janë në proces të përgaditjes profesionale dhe trajnimeve adekuate për të monitoruar IEA dhe për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin arsimor për komunat dhe mungesë të iniciativave .
- Përkundër sukseseve të arritura, funksionalizimi i mëtejshëm i organeve qeverisëse në IEA, rritja e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies do të vazhdojnë të mbesin sfida për komunën e Junikut. Kjo kërkon ngritje të kapaciteteve komunale e shkollë për planifikim, monitorim, mbikëqyrje, udhëheqje, ndërtim të partneriteteve e të tjera.
- SAK 2022 – 2026 ofron një kornizë për planifikim më të mirë të punës së komunave dhe institucioneve edukative-arsimore, në kuadër të fushave që mbulon SAK. Kjo duhet shfrytëzohet edhe nga Komuna e Junikut, me qëllim që prioritetet komunale të ndërlidhen me prioritetet dhe masat e veprimit të nivelit qendror.
- Mungesa e mbikëqyrjes së vazhdueshme , mungesa e buxhetit për të plotësuar të gjitha nevojat e IEA, paraqesin një rrezik të vazhdueshëm për cilësinë e menaxhimit dhe qeverisjes së IEA.

Sfidë kryesore:

- Kapacitetet jo të mjaftueshme për menaxhim cilësor të shkollave në nivel të komunës, funksionalizimi i organeve qeverisëse në IEA në nivel komune;
- Analiza e raporteve për cilësinë e arsimit në nivel të komunës;
- Planifikimi dhe menaxhimi i punës me personelin e mësimdhënësve, planifikimi i buxhetit dhe financave në IEA.
- Vendimarrja në IEA

2.2.2. Infrastruktura dhe gjithëpërfshirja në IEA

Mjedisin e përbëjnë infrastruktura fizike, siguria në shkollë e rreth saj, shkalla e bashkëpunimit të shkollës me familje dhe anasjelltas, mjedisi dhe atmosfera në klasë dhe në shkollë, marrëdhëniet ndërnjerëzore, procedurat dhe masat për të identifikuar dhe adresuar faktorët që mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë si dhe shkallën e pjesëmarrjes së të gjithë faktorëve në përmirësimin e mjedisit dhe kulturës së IEA. Plotësimi i tyre përbëjnë parakusht themelor për nxënie efektive dhe të qëndrueshme të fëmijëve dhe nxënësve.

Në Komun Junik është themeluar IP “Yjet e Gjeravicës” në vitin 2025, i cili është duke punuar me orar të shkurtuar pre ores 8:00-12:00, planifikohet të ketë orarë të plotë posa të funksionalizojm kuzhinen. IP është pajisur me orendi dhe mjete të punës.

Komuna Junik ka bërë përpjekje që të përmirësojë infrastrukturën e shkollave. Me ndihmën e donatorëve të cilët kanë investuar në përmirësimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor, është arritur që të shënohet një përmirësim i dukshëm në infrastrukturën fizike të IEA, përfshirë ndërtesa, dhomat për fëmijët parashkollor, kabinete, pajisje teknologjike, hapësirë e rregulluar e jashtme, etj. Llogaritet se infrastruktura ekzistuese e IEA përmbush nevojat themelore dhe se, sa i përket hapësirës, probleme nuk do të ketë edhe në të ardhmen, duke marrë parasysh se numri i fëmijëve është në rënie prej viti në vit.

Sfidë do të mbetet menagjimi i hapsirave të mbrenshme të mbetuara bosh të objekteve të IEA, duke marrë parasysh renjen e vazhdueshme të nxënësve.

Me gjithë progresin e arritur, komuna Junik akoma përballet me sfida të shumta në kompletimin e infrastrukturës së nevojshme. Kjo pasqyrohet në numrin e madh të propozimeve për prioritet e projekteve kapitale për vitet 2026-2030 të lidhura me mjediset shkollore, si renovime të shkollave, poligone sportive dhe infrastrukturën e hapësirave të IEA. Përveç kësaj, është i pranishëm problemi i mirëmbajtjes të hapësirave mbrenda dhe jashtë IEA, që reflekton në përmirësimin e standardeve higjienike, por edhe të formave të tjera të mirëmbajtjes.

Në anën tjetër, përfshirja e ulët e prindërve dhe komunitetit në shkollë, lëvizja e pamënaxhuar mirë e nxënësve dhe mos zbatimi i plotë i rregulloreve komunale dhe të brendshëm të shkollave, etj., në masë të konsiderueshme janë duke penguar sigurimin e mundësive për të ndërtuar një mjedis atraktiv dhe miqësor për të gjithë nxënësit dhe për të ofruar mundësi të barabarta për shkollim cilësor për të gjithë.

Nuk vërehet ndonjë gatishmëri e shtuar për mbështetje të projekteve infrastrukturore nga ana e donatorëve dhe komunitetit, ndërkohë që nuk janë analizuar masat dhe mundësitë e gjetjes së alternativave për të avancuar gjendjen e mjedisit shkolllor, në veçanti të hapësirës së klasave dhe krijimit të hapësirave të veçanta për aktivitete rekreative në shkolla.

Janë identifikuar disa faktorë të jashtëm që potencialisht mund të lehtësojnë dhe përkrahin komunën dhe shkollat për rritjen e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor, zvogëlimin e braktisjes së shkollës, si dhe për të ndërtuar një mjedis atraktiv dhe miqësor në shkolla. Përfshirja në edukimin parashkollor cilësor e fëmijëve është prioritet dhe i përkrahur nga MASH-i, komuna

Sfidë kryesore:

- Përfshirja e ulët e fëmijëve në edukimin parashkollor (3-5 vjeç);
- Përfshirja e ulët e prindërve dhe komunitetit në IEA;
- Analiz e mirëfillt për shkaqet e lëvizjes së nxënësve në zona tjera urbane apo jashta vendit;
- Krijimi i cilësisë së shërbimeve në IEA;
- Krijimi i një strategjie për të ndërtuar mjedise atraktive dhe miqësore për fëmijë dhe nxënës dhe personel;

dhe donatorë, me një angazhim më të madh, do të mund të përfitonte nga institucione të ndryshme përkrahëse.

2.2.3. Sigurimi i cilësisë dhe zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Analiza e gjendjes në këtë fushë, tregon se ka disa arritje në IEA në Komunën Junik, të cilat duhet evidentuar, si: planet zhvillimore janë hartuar nga të gjitha shkollat e komunës, shkollat janë pajisur me dokumentet për sigurim të cilësisë, është zgjedhur e koordinatori i cilësisë në shkollë, ka filluar vlerësimi i performancës së shkollave, komuna e ka prioritet përmirësimin e cilësisë, etj. Me gjithë sukseset e arritura, deri tani, DAKRS nuk ka krijuar një sistem të unifikuar të planifikimit strategjik zhvillimor të arsimit. Në anën tjetër, shkollat kanë plane zhvillimore, por ato janë formale dhe nuk adresohen mjaftueshëm në planifikimet në nivel komune dhe nuk janë të ndërlidhura më prioritet e përcaktuara me SAK 2022-2026, si dhe me planet tjera strategjike të përcaktuara nga MASH.

Në anën tjetër, janë shënuar edhe disa arritje në përfshirjen e mësimitdhënësve në trajnimet për zbatimin e kurrikulës së re dhe në programe të tjera të trajnimit. Sipas raportimeve nga DAKRS lidhur me zhvillimin në karrierë të mësimitdhënësve, sistemin e licencimit, zhvillimin profesional dhe vlerësimin e performancës së mësimitdhënësve në Junik del se :43 mësimitdhënës nga Komuna e Junikut janë raportuar që kanë arritur numër të ndryshëm të orëve për zhvillim profesional, prej tyre 10 mësimitdhënës kanë nga 1-50 orë trajnimi, 13 mësimitdhënës kanë nga 51-99 orë trajnim, 16 mësimitdhënës kanë nga 100-150 orë trajnimi, ndërsa 4 mësimitdhënës kanë mbi 150 orë trajnime në programe të dryshme. Këto të dhëna tregojnë se megjithatë përfshirja e mësimitdhënësve në trajnime është larg përmbushjes së kërkesave minimale për përfshirje në trajnime sipas sistemit të licencimit të mësimitdhënësve, ku kërkohet që mësimitdhënësit nga marrja e licencës së mësimitdhënësve, brenda pesë viteve të ndjekin së paku 100 orë të zhvillimit profesional, në fusha të ndryshme të mësimitdhënies dhe të nxënies.

Sfidat kryesore:

- Vlerësimi performancës së shkollave, planeve zhvillimore dhe zbatimit e monitorimi të tyre;
- Kapacitet e pamjaftueshme për sigurim të cilësisë në komune dhe shkollë;
- Mungesa e analizës së nevojave për trajnime të mësimitdhënësve;
- Kapacitet te pa mjaftueshme për zhvillim profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë;
- Funksionimi i aktivave profesionale në nivel shkolle dhe komune;
- Cilësia e mësimitdhënies dhe nxënies;

Ndër shkaqet kryesore të faktorëve të brendshëm që ndikojnë në mungesën e sigurimit të cilësisë së arsimit në komunën e Junikut janë: mosfunksionalizimi mekanizmit për ndërlidhje të planifikimit zhvillimor në nivel shkolle me planifikimin në nivelin komunal, mungesa e analizës së nevojave dhe trajnimeve në metodologjitë lëndore, moszbatimi i mjaftueshëmi strategjive të reja mësimore, si dhe mungesa e organizimit të zhvillimit profesional me bazë në shkollë. Ndërsa, ndër faktorë të jashtëm vlerësohen të jenë mungesa e buxhetit për zhvillim profesional të mësimit dhe aktiviteteve të ndryshme që synojnë sigurimin e cilësisë, mungesa e informimit të mirëfilltë për sistemin e sigurimit të cilësisë dhe për kurrikulën e re, si dhe vështirësitë e mësimit dhe të aplikuar qasjen e re kurrikulare.

2.2.4. Zbatimi i kurrikulës së re

Zbatimi i kurrikulës së re nuk mund të jetësohet në frymën e parimeve të saj¹, pa një proces koordinimi në nivel MASH, komune dhe shkolle, pa ofrimin e mbështetjes së nevojshme për mësimit dhe shkollat, pa sigurimin e materialeve mësimore dhe pajisjeve të kabineteve me mjete konkretizuese e digjitale, informim të prindërve dhe komunitetit të gjerë në nivel komune, etj. Përkundër përpjekjeve nga DAKRS dhe Drejtorët e shkollave, ka pasur vështirësi në organizimin përmbajtësor të shkollave dhe në zhvillimin e mësimit për zbatimin e kurrikulës së re në të gjitha shkollat, kjo ndërlidhet me shumë faktoret objektiv dhe subjektiv.

Në nivel komune, ka mungesë të burimeve njerëzore në DAKRS për të mbështetur shkollat në zbatimin e kurrikulës së re, numër të vogël të trajnerëve për kurrikulë, mospërfshirje e personelit menaxherial të shkollave në trajnimet për kurrikulë, mungesë të një plan komunal për zbatimin e kurrikulës së re në të gjitha shkollat e komunës, mungesë të materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kurrikulës së re, etj.

Sfidat kryesore:

- Kapacitetet e kufizuara në nivel komunal për të mbështetur shkollat në zbatimin e kurrikulës së re;
- Kapacitetet e limituara në udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë dhe për trajnimin e mësimit për zbatimin e kurrikulës së re;
- Mungesa e kabineteve dhe laborator dhe puntori për zbatim të kurrikulës së re;
- Mungesë e bashkëpunimit për shkëmbimin e përvojave për zbatim të kurrikulës së re;

Sfidat e komunës dhe shkollave në zbatimin e kurrikulës së re, ndikohen edhe nga disa faktorë të jashtëm, si mungesa e informimit të mirëfilltë

¹Parimet e kurrikulës: 1. Gjithëpërfshirja; 2. Zhvillimi i kompetencave; 3. Mësimdhënia dhe të nxënëit e integruar dhe koherent/ të ndërlidhur; 4. Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle; dhe 5. Përgjegjësia dhe llogaridhënia

për kurrikulën e re, mungesa e teksteve të reja shkollore të bazuara në kurrikulën e re, trajnimet jo cilësore për zbatimin e kurrikulës së re, por edhe nga mungesa e përkrahjes financiare të komunës për të adresuar ndryshimet që sjell kurrikula e re në personel dhe në menaxhimin e institucioneve arsimore.

Me gjithë vështirësitë e brendshme dhe të jashtme, janë identifikuar disa faktorë të jashtëm që potencialisht mund të lehtësojnë dhe përkrahin komunën dhe shkollat në zbatimin e kurrikulës së re, si mundësia për të ndërlidhur planifikimin zhvillimor me prioritetet e MASH për zbatimin e kurrikulës së re, shfrytëzimi i dokumenteve kurrikulare dhe udhëzuesve për zbatim të kurrikulës së re, trajnimi i trajnerëve dhe mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës, dhe shfrytëzimin e donatorëve, që mbështesin me grante shkollore dhe trajnim të mësimdhënësve.

2.2.5. Arsimi dhe aftësimi profesional

Analiza e gjendjes në fushën e arsimit, digjitalizimit të arsimit dhe aftësimit profesional në komunën Junik tregon se IAAP nuk mund të zhvillohet në kushtet dhe rrethanat në të cilën gjendet komuna e Junikut. Në Junik kemi të hapur një paralele të ndarë të shkollës profesionale “Hysni Zajmi” drejtimi Infermieri në Gjakovë, e cila funksionon në kudër të Institucionit të Gjimnazit “Kuvendi i Junikut”. Kjo paralele e ndarë funksionon nga viti 2018, në këtë paralele të ndarë mbahet mësimi nga kl. 10-12 të cilat klasë kanë nga një paralele. Ndërsa kuadri profesional sigurohet nga shkolla amë, ndërsa lëndët bazike plotsohet me normative nga Gjimnazi “Kuvendi i Junikut”.

Komuna Junik ka parë si prioritet hapjen Drejtimi Turizem -Hotelier duke u bazuar në Planin Zhvillimor të Komunës Junik i cili ka ndër shtullat kryesore të zhvillimit ekonomik, turizmin. Që nga viti 2018 në kuadër të gjimnazit “Kuvendi i Junikut” ka qenë e themeluar drejtimi Turizem -Hotelieri, por për shkak të mos interesimit nga nxënësit nuk është arritur të krijohet asnjë paralele nga kl. 10-12. Me kohë është lëshur një Udhëzim Administrativ i cili nuk lejohej të ketë drejtime profesionale në IEA Gjimnaze. Për kundër kësaj nga viti 2022 janë bërë përpjekje të vazhdueshme që të hapet drejtimin Hotelieri-Turizem. Në bazë të udhëzimit Administrativ, komunat për të hapur drejtime profesionale duhet të krijohet IAAP, prandaj komuna Junik, nuk i ka burimet njerzore dhe infrastruktur për hapjen e këtij institucioni.

Përpjekjet tona kanë vazhduar, në bashkpunim me komunën e Pejës dhe komunës së Junikut është nënshkruar një marrëveshje të bashpunimit me të cilën Shkolla profesionale “Ali Hadri” në Pejë, do të hap paralelen e ndarë Turizem-Hotelieri në gjimnazin “Kuvendi i Junikut”. Pas shumë përpjekjeve MASH nuk ka dhënë pëlqimin për hapjen e kësaj paralele të ndarë për shkak se komunat mund të hapin paralele të ndara, vetëm mbrenda territorit të tyre.

Përmes këshilltarit për orientim në karrierë të bëhet identifikimi i nxënësve që kanë prirje për degë profesionale Komuna Junik, duhet të bëjë përpjekje që aftësimi profesional për nxënësit e komunës, të bëhet në komunat përreth me një bashkpunim apo marrëveshje që nxënësit të pranohen në shkollat profesionale të tyre dhe të përkrahen nga komuna

Sfidat kryesore:

- Mungesa e analizave të ndërlidhjes së AAP me tregun e punës;
- Perkahja e dhe mbështetja për arsim profesional nga komuna për nxënësit që regjistrohen jashta territorit të saj;
- Mungesa e mjeteve për të mbuluar shpenzimet lidhur me transportin, shujtat dhe pagesat simbolike të nxënësve të cilët regjistrohen në drejtime profesionale.

3.Qasja strategjike për zhvillimin e arsimit në Komunën e Junikut

3.1. Vizioni, misioni dhe vlerat e arsimit në Komunën e Junikut

Vizioni: Të ndërtoj një arsim modern, gjithëpërfshirës dhe cilësor , që zhvillon potencialin e çdo nxënësi , promovon inovacionin, vlerat qytetare dhe përgadit të rinjët për sfidat e së ardhmës në një shoqëri demokratike dhe të zhvilluar.

Misioni: Komuna e Junikut Ofron: arsim dhe edukim cilësor, dhe ambient të favorshëm për të gjithë fëmijët dhe në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar e komunës , duke zhvilluar njohuri dhe aftësi për jetë, mundësi të barabarta për punë dhe pjesëmarrje aktive në vazhdim të suksesshëm të shkollimit dhe punësimit.

Vlerat e arsimit - Vendimmarrja demokratike, diversiteti dhe mirëqenia e të gjithë fëmijëve, klima pozitive, respekti dhe besimi reciprok, etika dhe bashkëpunimi, si dhe respektimi i vlerave shoqërore, janë vlera që udhëheqin zhvillimin e arsimit në Komunën e Junikut.

Vlerat përcaktuara janë:

Qasshmëria: siguron qasjen në arsim për të gjithë nxënësit pa dallim duke tejkaluar vështirësitë për të vijuar mësimin shkollat e komunës.

Afërsia: siguron nxënësve mundësinë për të mësuar dhe zhvilluar vetveten në një mjedis afër shtëpisë dhe komunitetit, duke u përfshirë në një bashkësi lokale të arsimuar.

Kontrolli: sistemet arsimore komunale janë më të lehta për t'u menaxhuar nga autoritetet lokale, dhe kjo mund të rrisë ndikimin e prindërve dhe komunitetit në arsimin e nxënësve.

Bashkëpunimi: siguron bashkëpunimin mes komunitetit dhe institucionit arsimor lokal, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të prindërve dhe komunitetit në marrjen e vendimeve për arsimin e nxënësve.

3.2. Objektivat strategjike dhe masat

Të gjithë objektivat strategjike të Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut 2026-2030, janë në funksion të përmbushjes së vizionit dhe misionit për zhvillimin e arsimit në nivel komunal. Plani ka pesë objektiva strategjike, një për secilën fushë të intervenimit, siç është prezantuar në tabelën në vijim.

Tabela 6. Objektivat strategjike

Fushat e intervenimit	Objektivi strategjik
-----------------------	----------------------

1. Menaxhimi i arsimit dhe autonomia e shkollës	OS1. Menaxhim cilësor dhe efikas i arsimit në nivel komune dhe shkolle, bazuar në përgjegjësitë institucionale, autonomi, transparencë dhe llogaridhënie.
2. Infrastruktura dhe gjithëpërfshirja në IEA	OS2. Infrastruktura e përshtatshme dhe kulturë pune pozitive në çdo IEA, që mundësojnë përfshirje cilësore, performancë të mirë në edukim dhe arsim.
3. Sigurimi i cilësisë dhe zhvillimi profesional i edukatoreve dhe mësimeve	OS3. Përmirësim domethënës i funksionimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe zhvillim profesional të edukatoreve mësimeve me bazë në IEA.
4. Zbatimi i kurrikulës së re	OS4. Ngritja e cilësisë së edukatoreve, mësimeve dhe të nxënies përmes zbatimit të kurrikulës së re në mbështetje të parimeve të saj.
5. Arsim dhe aftësi profesionale	OS5. Digjitalizimi i arsimit bëhet me nevojat e kohës, ndërlidhje më e mirë e arsimit profesional me kërkesat e tregut të punës.

3.2.1. Menaxhimi i arsimit dhe autonomia e shkollës

Objektivi strategjik 1: Menaxhim cilësor dhe efikas të IEA, bazuar në përgjegjësitë institucionale, autonomi, transparencë dhe llogaridhënie.

Arsimi parauniversitar në Kosovë është i decentralizuar, me përgjegjësi të ndara për nivelin qendror, autoritetet komunale dhe IEA. Komunitet dhe IEA kanë autonomi të caktuar për edukim dhe arsim në nivel komune. Ndërtimi i një strukture organizative efikase për menaxhim të IEA në nivel komunal, funksionalizimi i organeve qeverisëse, menaxhmentit të mesëm të shkollave – aktiveve profesionale dhe ekipeve punuese në nivel të IEA në komunë, janë parakushte themelore për menaxhim cilësor dhe efikas të IEA.

Për arritjen e objektivit strategjik në këtë fushë, është masa e veprimit.

Masat e veprimit

Masa 1.1.: Rishikimi i strukturës organizative për menaxhim të IEA nga DAKRS dhe formimi i ekipit komunal për monitorimin e IEA në nivel komune

Rishikimi i strukturës organizative nënkupton rishikimin e shpërndarjes së detyrave dhe përgjegjësi brenda strukturës ekzistuese, plotësimin e kuadrit të personelt edukativo-

arsimor brenda kuadrit ligjor dhe mundësive buxhetore. Rishikimit të strukturës organizative do ti paraprijë një analizë e gjendjes dhe mundësive për të vendosur strukturë efikase që përmbush detyrat dhe përgjegjësitë komunale për edukim dhe arsim. Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin në fuqi, komuna do të ndërmarrë iniciativë të formojë ekipin komunal për monitorim të edukimit dhe arsimit në nivel komune. Ekipi komunal do të monitorojë edukimin dhe arsimin në nivel komune dhe do të ofrojë mbështetje shkollave për zbatimin e kurrikulës së re dhe funksionalizimin e mekanizmave për sigurim të cilësisë në nivel komune.

Masa 1.2. Ngritja e kapaciteteve për udhëheqje dhe menaxhim të IEA në nivel komune

Ndërmarrja e veprimeve në këtë fushë do të bëhet në bazë të një analize të nevojave për ngritje të kapaciteteve për personelin edukativo- arsimor, drejtorët, në fusha specifike të përgjegjësive profesionale, me theks të veçantë në udhëheqje të reformës kurrikulare, menaxhim të cilësisë në edukim dhe arsim, vlerësim, planifikim, mbikëqyrje dhe monitorim të IEA. Pastaj, në bazë të nevojave do të organizohen trajnime që mbështeten nga MASH dhe partnerët tjerë, por edhe trajnime që organizohen nga vet IEA dhe komuna. Gjithashtu, do të inkurajohet zhvillimi i konkurrencës përmes ofrimit të mundësive për përfshirjen e mësimeve në programet e trajnimit për udhëheqje në fushën edukativo-arsimore.

Masa 1.3. Funksionalizimi dhe fuqizimi i këshillave drejtues në IEA

Në kuadër të kësaj mase, fillimisht do të bëhet një analizë lidhur me funksionimin e KDIEA ekzistuese, rolin e përfaqësuesve të komunës në KDIEA si dhe praktikën e funksionimit në nivel të IEA. Në bazë të legjislacionit në fuqi, DAKRS ka përgjegjësi në emërimin e anëtarëve për KDIEA që përfaqësojnë DAKRS, në të gjitha raste ku nuk mund të emërohen dhe ku nuk kanë funksionuar. Përveç plotësimit të KDIEA me anëtarë që përfaqësojnë komunën, DAKRS do të kujdeset që Këshillave drejtues do t'u ofrohet mundësi trajnimi, përmes programeve që mbështeten nga MASH ose donatorët, por edhe do të monitorojë punën e tyre në IEA.

Masa 1.4. Funksionalizimi dhe fuqizimi i aktiveve profesionale në shkollë dhe në nivel komunal

Reforma kurrikulare kërkon qasje të punës ekipore të mësimeve në proceset e planifikimit dhe të zbatimit të kurrikulës së re, si dhe shkëmbim të vazhdueshëm të përvojës ndërmjet tyre. DAKRS do të kujdeset që të përkrahë IEA në fuqizimin e aktiveve(departamenteve) profesionale duke ofruar mundësi të trajnimit të udhëheqësve të aktiveve profesionale dhe duke nxitur shkollat në rishikimin e rregullorës së punës së aktiveve profesionale dhe të planeve të punës së tyre. Drejtorët e IEA do të angazhohen në përkrahjen e aktiveve profesionale që të zhvillojnë programe të punës, të organizojnë sesione konsultative, këshilluese dhe mentoruese në sferë të ndryshme profesionale. Në

anën tjetër, DAKRS në koordinim me drejtorët e IEA do të iniciojë themelimin e aktivave profesionale sipas modelit ku: së pari themelohen dhe funksionalizohen aktivat në IEA; pastaj, nga IEA formojnë rrjetin e aktivave profesionale të institucioneve; dhe në fund krijohen aktivat profesionale në nivel komunal.

Masa 1.5. Organizimi i shërbimeve profesionale dhe ekipeve të veçanta profesionale në nivel të IEA

DAKRS do të kujdeset që të respektojë bazën ligjore për themelimin dhe funksionalizimin e shërbimeve profesionale dhe ekipeve profesionale në nivel të IEA (si: Shërbimin pedagogjik dhe psikologjik në shkolla, Ekipi komunal për vlerësim profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta; Ekipi për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit (EPRBM), Ekipi i vetëvlerësimit, etj.). Në këtë drejtim, DAKRS fillimisht do të bëjë një analizë të gjendjes me pedagog dhe psikolog në shkolla, funksionimin e ekipeve profesionale. Pastaj, DAKRS do të funksionalizoj ekipet profesionale duke u emëruar anëtarët që kërkohen, si dhe duke u siguruar që edhe shkollat të funksionalizojnë ekipet e tyre. DAKRS në vazhdimësi do të bëjë monitorimin e punës së ekipeve profesionale.

Për të siguruar përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, DAKRS do të kujdeset që të realizoj një fushatë informimi dhe vetëdijesimi që do të kontribuoj në sensibilizim të prindërve, dhe të ofroj trajnime për mësimdhënës në hartimin e PIA.

3.2.2 Infrastruktura dhe gjithëpërfshirja në IEA

Objektivi strategjik 2: Infrastruktura e përshtatshëm dhe kulturë pune pozitive në çdo IEA, që mundësojnë përfshirje cilësore në edukim parashkollor dhe performancë të mirë të nxënësve.

Orientimi i komunës në këtë fushë të intervenimit do të jetë më shumë i fokusuar në mirëmbajtjen e objekteve ekzistuese, si dhe në ndërtimin/renovimin e fushave/terreneve sportive dhe këndeve për aktivitete rekreative, në rregullimin e rrethojave të shkollës si dhe në gjelbërimin e hapësirave shkollore.

Masat e veprimit

Masa 2.1. Rishikimi i kuadrit të rregulloreve të punës së IEA në nivel komune

Hapi i parë do të jetë formimi i grupit punues nga ana e drejtorit të DAKRS për rishikimin e rregullores për IEA në komunën e Junikut. Ky grup punues do të organizojë diskutime me shkollat rreth praktikave të funksionimit të rregulloreve të punës dhe mbi bazë e praktikave të mira dhe bazës ligjore për arsimin parauniversitar, do të rishikojë rregulloren për arsim në nivel komune. Rregullorja e rishikuar do të trajtojë në mënyrë të veçantë dimensionin e normave të punës së mësimdhënësve, pjesën që lidhet përtej orëve mësimore javore obligative. Pas finalizimit të punës nga grupi punues, do të organizohet diskutimi i draftit të rregullores së arsimit në nivel komunal

me palët e interesit dhe pas marrjes së sugjerimeve eventuale do të finalizohet dokumenti, i cili do të aprovohet nga kuvendi komunal. Pas aprovimit të rregullorës së re të arsimit të nivel komunal, e njëjta do të shpërndahe në të gjitha institucionet arsimore të komunës, të cilat duhet që të fillojnë më pas me rishikimin e rregulloreve të brendshme të tyre bazuar në rregulloren në nivel komunal.

Masa 2.2. Krijimi i mjediseve të veçanta për prindër dhe përfshirja e tyre në proceset e zhvillimit në IEA

DAKRS do të kujdeset që të përkrahë IEA që të angazhohen më aktivisht nëpërfshirjen e prindërve në proceset e zhvillimit të IEA . Për të arritur këtë DAKRS do të kërkojë nga të gjitha IEA që të hartojnë plane të veprimit përfshirjen e prindërve në proceset e zhvillimit të IEA, tëndajnë mjedise të veçanta për pritje dhe informim të prindërve, të organizojnë sesione konsultative, këshilluese me prindër. Këto plane duhet domosdo të kenë në fokus përfshirjen e prindërve në proceset e zhvillimit të shkollës, në përcaktimin e kurrikulave me zgjedhje për klasat përkatëse, etj.

Masa 2.3. Analiza e gjendjes në braktisjen e shkollës nga nxënësit dhe marrja e masave për evitimin e braktisjes.

Në kuadër të kësaj mase, DAKRS do të themelojë një grup pune për analizë të gjendjes në këtë aspekt. Grupi do të hartojë një metodologji të punës që mundëson bërjen e një analize të trendëve të braktisjes së shkollës në 10 vitet e fundit, me fokus analizë të faktorëve ndikues. Pastaj rezultatet do të përpunohen dhe do të hartohet një plan i veprimit me masa konkrete në këtë fushë.

Masa 2.4. Rregullimi i rrethojave të hapësirave të jashtme dhe hapësirave të gjelbërimit në IEA

Në kuadër të kësaj mase, fillimisht do të bëhet identifikimi i hapësirave në IP dhe Institucionin shkollor që kanë nevojë për rrethoja të hapësirave dhe të hapësira gjelbëruese, me qëllim rritjen e sigurisë në IEA dhe krijimin e hapësirave të gjelbërimit që sigurojnë mjedise relaksuese për të gjithë. Pastaj do të hartohen projektet për rregullim të rrethojave dhe të hapësirave gjelbëruese, të cilat do të ndërtohen pasi të sigurohen mjetet financiare nga granti qeveritar apo nga mjetet e komunës apo edhe të donatorëve. Kontribut të çmuar pritet të ofrohet nga grupet e nxënësve brenda shkollave/ekologët e rinj të cilët angazhohen për mirëmbajtjen e pjesëve të gjelbëruara.

Masa 2.5. Rregullimi dhe renovimi i fushave/terreneve sportive

Fokusi është në rregullimin dhe ndërtimin e terreneve sportive të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin e orëve të edukatës fizike dhe sportive, si dhe hapësirat e tilla do të shfrytëzohen edhe nga vet banorët e lagjeve/fshatrave në terminët ku nuk pengohet procesi mësimor. Hapi i parë do të jetë identifikimi i shkollave që kanë nevojë për fusha/terrene sportive për të cilat ekziston parcela ku do të ndërtohen ato. Pastaj do të hartohen projekte për fusha (terrene) sportive të cilat do të ndërtohen pasi të sigurohen fonde për investime kapitale nga granti qeveritar, mjetet e komunës apo donatorët.

3.2.3. Sigurimi i cilësisë dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve dhe edukatoreve

Objektivi strategjik 3: Përmirësim domethënës i funksionimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe edukatoreve me bazë në IEA

Sistemi i sigurimit të cilësisë në edukim dhe arsim dhe zhvillimi profesional i mësimitdhënësve dhe edukatoreve janë përgjegjësi e përbashkët e institucioneve arsimore në nivel qendror, në nivel lokal dhe në nivel shkolle. Përmeshja e pritëshmerive të përcaktuara me Kornizën për sigurimin e cilësisë së performancës së IEA, kërkon mekanizma funksional për sigurim të cilësisë në nivel komune dhe IEA kërkesa të reja të shoqërisë të cilat mund të përmeshen vetëm me ndërtim të mekanizmave për sigurim të cilësisë, veçanërisht atyre në nivel komune dhe IEA. Në anën tjetër, zhvillimi profesional i mësimitdhënësve, i bazuar në analizë të nevojave dhe i ofruar në mënyrë të vazhdueshme dhe me bazë në IEA, paraqet një ndër parakushtet më të rëndësishme për të siguruar cilësi të mësimitdhënies dhe të nxënies në shkollë. Këto aspekte adresohen në masat e vendosura në kuder të kësaj fushe të intervenimit.

Masat e veprimit

Masa 3.1. Sistemi dhe funksionalizimi i koordinatorëve të cilësisë

DAKRS është e përkushtuar në fuqizimin e pozitës së koordinatorit të cilësisë në nivel komune, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (Udhëzimi Administrativ 24/2016 për Sigurim të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar). DAKRS do të kujdeset që koordinatorët e cilësisë të kenë qasje në trajnime që mund të organizohen nga MASH apo palët tjera, të monitorojë punën e koordinatorëve të cilësisë në kryerjen e detyrave të tyre për koordinim të proceseve që sigurojnë cilësi të mësimitdhënies në shkollë.

Masa 3.2. Zhvillimi i kapaciteteve për vlerësimin e performancës së shkollës

Udhëzimi Administrativ Nr.4/2017 për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore, ka përcaktuar që çdo institucion arsimor në arsimin parauniversitar duhet të bëjë në baza vjetore vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës dhe së paku një herë në pesë vite inspektorati i arsimit të bëjë vlerësimin e jashtëm, gjithnjë me pikë referimi pritshmëritë për shkollë të përcaktuara me Kornizën e cilësisë së performancës së shkollës. Për këtë qëllim, DAKRS duhet fillimisht t'i informojë shkollat me të gjithë pakon e dokumenteve për performancë të shkollës, të ofrojë mbështetje në formimin dhe trajnimin e ekipeve shkollore për

vlerësim të brendshëm. Pastaj shkollat do të realizojnë vlerësimin e brendshëm sipas procedurave të sistemit të vlerësimit të performancës së shkollës. Në këtë proces, DAKRS do të kujdeset që të ofrojë mbështetjen e nevojshme për shkollat dhe për inspektoratin e arsimit i cili ka përgjegjësi për vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës.

Masa 3.3. Menaxhimi i planit zhvillimor të IEA

Bazuar në kërkesat e reja për planifikim zhvillimor të shkollave, në SAK 2022-2026 dhe në PZHAKJ 2026-2030, DAKRS do të mbështesë shkollat në procesin e planifikimit zhvillimor, me informata shtesë për ndërlidhjen e planeve zhvillimore me prioritetet e MASH-t dhe të Komunës së Junikut, trajnime dhe forma tjera të mbështetjes që sigurojnë plane të zbatueshme nga shkollat. DAKRS do të kujdeset që të respektojë afatet ligjore të lidhura me pranimin e PZHAKJ, analizën e tyre dhe përfshirjen e prioritetëve të shkollave që kanë kosto financiare në planifikimet e buxhetit të komunës. Gjithashtu, DAKRS do të kujdeset që të realizojë monitorimin e zbatimit të PZhAKJ.

Masa 3.4. Analiza e nevojave për zhvillim profesional të mësimitdhënësve

Për të ofruar zhvillim profesional të mësimitdhënësve në bazë të nevojave të tyre dhe në ndërlidhje me prioritetet e MASH-t dhe DAKRS-së, DAKRS do të formojë një grup pune për analizën e nevojave për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve të përbërë nga zyrtarë të DAKRS-së dhe ekspertë lokalë. Grupi punues do të mbledh të dhëna për nevojat për zhvillim profesional të mësimitdhënësve dhe mundësitë e realizimit të tyre. Bazuar në analizën e rezultateve për nevojat e mësimitdhënësve për zhvillim profesional, do të hartohen plane për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe do të bëhet ndarja e buxhetit për realizimin e tyre. DAKRS do të kujdeset që të përkrahë shkollat në hartimin e planeve individuale të zhvillimit profesional për secilin mësimitdhënës, si dhe me krijimin e planeve shkollore për zhvillim profesional me bazë në shkollë.

Masa 3.5. Organizimi i trajnimeve dhe formave të tjera të zhvillimit profesional në nivel të komunës dhe me bazë në shkollë

DAKRS do të delegojë tek një zyrtar i arsimit në nivel komune përgjegjësi për organizimin e trajnimeve në nivel komune dhe për bashkëpunim me shkollat në zbatimin e planeve të zhvillimit të mësimitdhënësve me bazë në shkollë. Pastaj, DAKRS në përputhje me përgjegjësitë ligjore dhe me përkrahje nga MASH, organizatat joqeveritare dhe donatorët, planifikon të sigurojë minimumin e orëve për zhvillim profesional të mësimitdhënësve në nivel komune. Organizimi i trajnimeve do të bëhet në nivel të komunës dhe në nivel të shkollës. Për këtë DAKRS do të kujdeset që të caktojë javët për zhvillim profesional të mësimitdhënësve në baza vjetore, si dhe do të kujdeset që në mënyrë të vazhdueshme të bëjë monitorimin e trajnimeve që organizohen në nivel komune dhe të aktiviteteve për zhvillim profesional me bazë në shkollë.

Masa 3.6. Krijimi i rrjeteve profesionale të mësimdhënësve

Krijimi i rrjeteve profesionale dhe organizimi i formave të ndryshme të shkëmbimit të përvojave në mes të mësimdhënësve është një nga prioritetet e DAKRS në Junik. Për këtë prioritet, DAKRS do të kujdeset që të hartoj një platformë të organizimit të rrjeteve profesionale të modelit “Komuniteti i të mësuarit së bashku” dhe të përkrahjes së shkollave për shkëmbimin e përvojave të mësimdhënësve brenda shkollës, aktiveve profesionale dhe rrjetit profesional. Për fuqizimin e rrjeteve profesionale të mësimdhënësve dhe thellimin e trajtesave profesionale me mësimdhënës, DAKRS planifikon që në baza vjetore të organizojë takime dhe punëtori të ndryshme në mes të mësimdhënësve, përmes të cilave synohet të rritet shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira të mësimdhënësve në punën me nxënës.

Masa 3.7. Monitorimi dhe mentorimi i vazhdueshëm i mësimdhënësve

Monitorimi i mësimdhënësve paraqet një ndër parakushtet më të rëndësishme për të siguruar mbikëqyrje dhe cilësi të mësimdhënies në shkolla. Në këtë drejtim, DAKRS do të mbështesë drejtorët e shkollave që të përgatisin/rishikojnë instrumentet e monitorimit dhe mentorimit të mësimdhënësve dhe t’i përdorin ato në praktikën e punës së tyre me mësimdhënës. Në nivel të shkollës, nga mësimdhënësit do të kërkohet të praktikojnë mentorimin kolegjial me qëllim përkrahjen kolegjiale dhe këshillimit, si dhe të monitorojnë orët e njëri-tjetrit për të mësuar nga përvojat e mira të njëri-tjetrit. Për promovimin e praktikave të mira të monitorimit dhe mentorimit të mësimdhënësve, DAKRS do të kujdeset që të organizojë punëtori dhe takime me drejtorë të shkollave, mësimdhënës dhe ekspertë të arsimit.

3.2.4. Zbatimi i kurrikulës së re

Objektivi Strategjik 4: Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve përmes zbatimit të kurrikulës së re në mbështetje të parimeve të saj.

Zbatimi i kurrikulës së re të bazuar në kompetenca kërkon riorganizim të brendshëm të punës së shkollës, udhëheqje të procesit në nivel shkolle, si dhe përkrahje të vazhdueshme nga DAKRS dhe mekanizmat për sigurim të cilësisë. Fazë tjetër e një rëndësie të veçantë është pjesa e monitorimit të vazhdueshëm të shkollave gjatë zbatimit të kurrikulës së re. Këtë pritet të mbulojnë masat e përcaktuara për këtë fushë të intervenimit.

Masat e veprimit

Masa 4.1. Ngritje e kapaciteteve në nivel komune dhe shkolle për zbatimin e kurrikulës së re

Zbatimi i kurrikulës së re kërkon ngritje të kapaciteteve të punonjësve arsimor në nivel komune, përfshirë zyrtarët komunal të arsimit, drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit që do të zbatojnë kurrikulën e re. DAKRS, planifikon që fillimisht të bëjë një analizë të trajnimeve të realizuara për zbatimin e kurrikulës dhe të nevojave për trajnime në këtë fushë, pastaj në bashkëpunim me shkollat do të përgatisë planin e trajnimeve për kurrikulë, të cilin do ta ndajë me të gjitha shkollat e komunës. Realizimi i planit planifikohet të bëhet në bashkëpunim me MASH-t dhe partnerët zhvillimorë do të ofrojë trajnime në programet për kurrikulë .

Masa 4.2. Riorganizimi i departamenteve/aktivave profesionale në shkollë

Konteksti i punës së shkollave në Komunën e Junikut, kërkon që shkollat të shfrytëzojnë autonominë e tyre në riorganizimin e aktiveve profesionale në frymën e kurrikulës së re. Për këtë qëllim do të hartohet një plan i punës për informim dhe diskutim të UA për departamentet/aktivat profesionale, do të përgatitet një skemë e mundshme sipas shkollave për organizim të aktivave profesionale e cila do të ndahet me të gjitha shkollat e komunës, si dhe do të monitorohet procesi i riorganizimit dhe funksionalizimit të aktivave profesionale nga zyrtarët komunal të arsimit.

Masa 4.3. Pajisja e shkollave me mjete të nevojshme didaktike e digjitale për zbatimin e kurrikulës së re

Zbatimi i suksesshëm i kurrikulës së re kërkon mjete dhe materiale të caktuara, të cilat mundësojnë që realizimi i saj të jetë i plotë dhe efikas. Komuna zotohet të krijojë buxhet të veçantë apo do të ndajë mjete financiare vjetore për sigurimin e materialeve shtesë mësimore për zbatimin e kurrikulës së re. Pajisja e shkollave me mjete elementare, didaktike e digjitale, do të bëhet në bazë të një analize të nevojave të shkollave për mjete të konkretizimit. Në bazë të nevojave të shkollave, një grup pune nga DAKRS dhe përfaqësues të shkollave, do të bëjnë listën prioritare për mjete të konkretizimit që do të sigurohen sipas specifikave të shkollave dhe

do të ndjekë procedurat për furnizimin e shkollave me mjete të nevojshme të konkretizimit për zbatimin e kurrikulës së re.

Masa 4.4. Pajisja e shkollave me mjete të TIK dhe rrjet të internetit

DAKRS do të krijoj një bazë të dhënash për pajisjet e TIK-ut që aktualisht i kanë shkollat, do të identifikojë nevojat e shkollave për pajisje të domosdoshme me mjete teknologjike dhe kompjuterë e laptop, tabela digjitale si dhe do të sigurojë ato në bazë të një plani trevjeçarë për pajisjen e shkollave me mjete të TIK-ut. Gjithashtu, DAKRS do të kujdeset që të gjitha shkollat e komunës së Junikut të kenë rrjet të internetit të qëndrueshëm dhe rrjete të brendshëm të tipit “ëireless” që mbulojnë pjesën më të madhe të hapësirave mësimore të shkollës dhe mundësi të shfrytëzimit në orë mësimore nga mësimdhënësit e të gjitha fushave kurrikulare. DAKRS do të filloj së zbatuari e-ditarin dhe digjatlizimin e dokumentacionit pedagogjik. Në këtë aspekt do të identifikohet dhe aplikohet platforma përkatëse dhe do të trajnohen mësimdhënësit për përdorim të saj. Gjithashtu, DAKRS do të bëjë planifikimin e buxhetit për mirëmbajtje të pajisjeve dhe të rrjetit, si dhe do të monitoroj përdorimin e pajisjeve digjitale dhe ndikimin e tyre në rritjen e suksesit të nxënësve. Bazuar në nevojat e shkollave, DAKRS do të mbështesë trajnimin e mësimdhënësve për përdorim të teknologjisë në mësimdhënie.

Masa 4.5. Monitorimi dhe përkrahja e vazhdueshme e shkollave në zbatimin e kurrikulës së re

Monitorimi i zbatimit të kurrikulës dhe përkrahja e shkollave në këtë proces, paraqet një ndër parakushtet më të rëndësishme për të zbatuar reformën kurrikulare në frymën e parimeve të saj. Në këtë drejtim, DAKRS në bashkëpunim me ekipin komunal për mbikëqyrje do të hartojë një skemë organizative të monitorimit dhe përkrahjes së shkollave, do të angazhojmë mësimdhënës trajnerë të fushave kurrikulare për organizim të sesioneve të këshillimit me mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave, do të ofroj udhëzues profesional për mësimdhënës, si dhe do të bashkëpunojë ngushtë me inspektoratin e arsimit në identifikimin e nevojave të mësimdhënësve dhe shkollave për përkrahje në zbatimin e kurrikulës së re.

Masa 4.6. Organizimi i vlerësimit të nxënësve për shkallë kurrikulare

Vlerësimi për shkallë kurrikulare është autonomi e shkollës, mirëpo bazuar në Kurrikulat Bërthamë për nivelet përkatëse të arsimit dhe në bazë të udhëzimit administrativ për vlerësimin e nxënësve sipas kurrikulës së re, shkollat marrin mbështetje nga DAKRS dhe MASH-i. Për këtë qëllim, DAKRS do të kujdeset që në bashkëpunim me MASH-i të organizojë një sesion konsultimi me drejtorët e shkollave për organizimin e vlerësimit për shkallë kurrikulare, pastaj do të përgatitet një qarkore për shkollat që orienton realizimin e aktiviteteve për vlerësimin për shkallë kurrikulare, përgatitjen e planeve nga shkollat për realizimin e vlerësimit për shkollë,

sipas kërkesave dhe nevojave të shkollave do të ofrojë mbështetje shtesë, si dhe do të bëj monitorimin e këtij procesi.

3.2.5. Arsimi dhe aftësimi profesional

Objektivi strategjik 5: Ndërlidhje më e mirë e arsimit profesional me kërkesat e tregut të punës.

Pavarësisht faktit në Komunën e Junikut nuk ka nje IAAP, por aktualisht ka vetëm një drejtim me një paralele të ndarë, Komuna e Junikut është përcaktuar që të ketë prioritet këtë fushë, për faktin se cilësia e arsimit dhe aftësimit profesional, si dhe harmonizimi i kërkesave të sistemit arsimor me tregun e punës duhet të ndikojnë në rritjen e vetëpunësimit dhe punësimit të qëndrueshëm të rinjve në tregun lokal, rajonal, mbrenda Kosovës apo më gjërë. Kjo ndodhë me mbështetjen e nxënësve në përcaktimin në drejtimet profesionale që ofrohen nga komunat e afërta, gjithashtu Objektiva dhe masat për zhvillimit do të jetë në pëputhje edhe me objektivat e Strategjisë për Arsim (SA 2022-2026).

Masat e veprimit

Masa 5.1. Analiza e nevojave të tregut të punës

DAKRS në bashkëpunim me bizneset analizojn nevojën për kuadër profesionël në dhe ne bashpunim me këshilltarin për orientim në karrier, nxënësit të orientohen në profilët profesionale sipas kërkesës së tregut.

Për të realizuar rishikimin e profileve të AAP, DAKRS do të kujdeset që të këshillohet dhe bashkëpunojë me bizneset lokale, si dhe institucionet e nivelit qendror që mbështesin këtë proces.

Masa 5.2. Realizimi i punës praktike dhe praktikës profesionale

Komuna e Junikut ne bashkëpunim me komunat më të afërta që zhvillojn procesin mësimor të IAAP, u mundësojn nxënësve të komunës së Junikut të regjistrohen dhe të zhvillojn praktiken profesionale duke ju dhënë mundësi në biznest e komunën e Junikut.

Për këtë qëllim, duhet identifikuar bizneset dhe mundësitë e tyre për të pranuar në praktikë nxënës të profileve të ndryshme. Përcaktimi i nxënësve për praktikë profesionale në biznese, si dhe përcjellja e punës gjatë praktikës profesionale, do të jetë detyrë e shkollës dhe aktivave profesionale. I gjithë ky proces, do të realizohet në bazë të planeve vjetore të miratuara nga organet profesionale , qeverisëse të shkollës dhe MASHTI.

Masa 5.3. Organizmi i aktiviteteve në shkolla për këshillim dhe orientim në karrierë

Për të mbështetur nxënësit për orientim në karrierë, DAKRS në bashkëpunim me IEA, SHMU, SHML do të përgatisë një platformë për këshillim dhe orientim në karrierë të rinjve dhe të rriturve, e cila do të jetë bazë për organizimin e aktiviteteve të këshillimit dhe orientimit në karrierë. Për realizim cilësor të organizimit të aktiviteteve të këshillimit dhe orientimit në karrierë, është planifikuar të trajnohet një grup i mësimdhënësve, këshilltari për karrierë në shkolla të cilët do të bashkëpunojë me mësimdhënës në këtë fushë dhe do të organizojë ligjërata, punëtori të veçanta, vizita në institucione, biznese dhe kompani si takime e sesione konsultimi dhe këshillimi me të rinj dhe të rritur.

3.3. Analiza e rrezikut për Planin Zhvillimor të Arsimit dhe masat parandaluese

Në këtë fazë të planifikimit, janë analizuar supozimet e identifikuara gjatë analizës së gjendjes si dhe janë vlerësuar rreziqet (*faktorët jashtë kontrollit të DAKRS dhe menaxhmentit të shkollave*), që mund të ndikojnë negativisht në arritjen objektivave të përcaktuar me këtë plan. Për të gjitha rreziqet e vlerësuara janë vendosur masa parandaluese shtesë për parandalimin ose minimizimin e rrezikut. Një analizë e tillë, është prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 7. Analiza e rrezikut për Planin Zhvillimor të Arsimit

OS1: Menaxhim cilësor dhe efikas i arsimit në nivel të DAKRS dhe shkollave, bazuar në përgjegjësitë institucionale, autonomi, transparencë dhe llogaridhënie.			
Rreziku	Gjasa 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe	Ndikimi 1- I vogël 2- Mesatar 3- I madh	Masat parandaluese
1.1.Mos aprovimi i strukturës organizative për menaxhim të arsimit në DAKRS dhe formimin e ekipit komunal për monitorimin e arsimit në nivel komune	1	2	- Ndjekja e procedurave ligjore për organizimin e strukturës dhe themelimin e ekipit komunal; - Informimi me detyrat dhe përgjegjësitë;

1.2.Politizimi i menaxhmentit të shkollave	1	3	▪ Kritere dhe procedura transparente për rekrutim të menaxhmentit në IEA; ▪ Informimi me kohë; ▪ Përfshirja e përfaqësuesve të KDIEA-ve në përzgjedhjen e drejtorëve/zëvendës drejtorëve;
1.3.Mosaprovimi i propozimit për rrjetin e ri të shkollave në nivel komune	1	2	▪ Ndjekja e procedurave ligjore për rrjetin e shkollave; ▪ Njoftimi për nevojat e organizimit të ri të rrjetit të shkollave për të siguruar edukim cilësor për të gjithë fëmijët;
OS2: Mjedis i përshtatshëm dhe kulturë pune pozitive në çdo institucion arsimor, që mundësojnë përfshirje cilësore në edukim parashkollor dhe performancë të mirë të nxënësve.			
Rreziku	Gjasa 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe	Ndikimi 1- I vogël 2- Mesatar 3-I madh	Masat parandaluese
2.1. Pamundësia për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në edukimin parashkollor 3-5 vjeç	1	3	• Fushata vetëdijësuese • Rritet bashkëpunimi me MASH, prindër dhe komunitet; Komuna siguron buxhet të veçantë për këtë sektor;
2.2. Mospërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollë	3	3	• Fushata vetëdijësuese Funksionalizimi i Ekipit për fëmijët me nevoja të veçanta

			sipas Udhëzimeve Administrative
2.3. Rënia e numrit të nxënësve në klasa dhe rritja e braktisjes së shkollimit	3	3	• Ngritja e bashkëpunimit me qendrat e regjistrimit të fëmijëve; • Koordinime më të shpeshta me drejtorë të IEA ku ka lëvizje të madhe të nxënësve; Organizimi i transportit të nxënësve
OS3: Përmirësim domethënës i funksionimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe zhvillim profesional të mësimeve me bazë në shkollë.			
Rreziku	Gjasa 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe	Ndikimi 1- I vogël 2- Mesatar 3- I madh	Masat parandaluese
3.1. Nuk janë siguruar pozita të koordinatoreve të cilësisë	1	2	▪ Respektimi i UA 24/2016 dhe kritereve në përzgjedhjen e koordinatoreve të cilësisë Informimi i shkollave për detyrat dhe përgjegjësitë e saj në sigurimin e cilësisë;
3.2. Moszbatimi i vlerësimit të jashtëm të performancës në të gjitha shkollat e komunës	2	2	▪ Monitorimi i vlerësimit të brendshëm të shkollës ▪ Përkrahja e ekipeve për vetëvlerësim Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit
3.3. Vonesa në zbatimin e sistemit të vlerësimit të performancës së mësimeve	2	3	▪ Monitorimi i mësimeve nga drejtorët e shkollave Analiza e raporteve të monitorimit

3.4. Mungesa e buxhetit për trajnime	3	3	Fuqizimi i trajnimeve për ZHPM me bazë në shkollë Informimi i mësimeve për njohjen e ZHPM me bazë në shkollë për sistemin e licencimit
--------------------------------------	---	---	---

OS4: Ngritja e cilësisë së mësimeve dhe të nxënësve përmes zbatimit të kurrikulës së re në mbështetje të parimeve të saj.

Rreziku	Gjasa 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe	Ndikimi 1- I vogël 2- Mesatar 3- I madh	Masat parandaluese
4.1 Mungesa e përkrahjes nga MASH për zbatimin e kurrikulës	2	3	Koordinime më të shpeshta me drejtorë të shkollave dhe koordinatore të kurrikulës
4.2 Mungesa e mjeteve financiare për pajisje të shkollave me mjete të TIK-ut	2	3	Rritja e bashkëpunimit me MASH dhe Institucione tjera që mbështesin furnizimin e shkollave me pajisje dhe mjete të TIK-ut;
4.3 Mirëmbajtja jo e qëndrueshme e pajisjeve të TIK-ut	3	3	Organizimi më i mirë i klubeve të teknikëve të rinj dhe koordinimi i tyre në nivel komunal

OS5: Ndërlidhje më e mirë e arsimit profesional me kërkesat e tregut të punës.

Rreziku	Gjasa 1- E vogël 2- Mesatare 3- E madhe	Ndikimi 1- I vogël 2- Mesatar 3- I madh	Masat parandaluese
5.1 Mungesa e interesimit të nxënësve për regjistrim në profilet e arsimit profesional	1	3	Fushatë vetëdijesimi Këshillimi/orientimi në karrierë
5.2 Mosrealizimi i praktikës	1	3	Kontakte të rregullta me bizneset dhe lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit

profesionale për AAP			Monitorimi i praktikës profesionale
----------------------	--	--	-------------------------------------

4. Plani i zbatimit dhe buxheti

Plani i zbatimit dhe buxheti, përfshijnë gjithë periudhën e zbatimit të Planit Zhvillimor të Arsimit janar 2026 – dhjetor 2030. Plani i detajuar i zbatimit dhe buxheti është paraqitur në Shtojcën 1 të këtij dokumenti.

Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Junikut 2026-2030, parashihet që për periudhën katërvjeçare të zbatimit të ketë një buxhet total prej **€ 1,005,400.00**. Në vijim është buxheti i detajuar për katër vite të këtij plani të veprimit, i ndarë sipas fushave dhe sipas viteve (i shprehur në Euro).

Tabela8. Përmbledhja e buxhetit të Planit Zhvillimor të Arsimit

Fushat e intervenimit	Buxheti sipas viteve ne euro				
	2027	2028	2029	2030	Gjithsejt
Menaxhimi i arsimit dhe autonomia e shkollës	34,000.00	23,000.00	18,000.00	18,000.00	93,000.00
Infrastruktura dhe gjithëpërfshirja në IEA	398,000.00	132,200.00	106,400.00	127,400.00	764,000.00
Sigurimi i cilësisë dhe zhvillimi profesional i mësimitdhënësve	20,000.00	18,000.00	20,000.00	20,000.00	78,000.00
Zbatimi i kurrikulës së re	16,600.00	16,600.00	16,600.00	16,600.00	66,400.00
Arsimi dhe aftësimi profesional	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00	4,000.00

Shtojca 1: Plani i zbatimit të Buxhetit 2026-2030

1. Menaxhimi i arsimit dhe autonomia në shkollë

OS1. Menaxhim cilësor dhe efikas i arsimit në nivel komune dhe shkolle i bazuar në integrim, transparencë dhe llogaridhënie

Masa 1.1: Rishikimi i strukturës organizative për menaxhim të arsimit në nivel komunal

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia	Institucioni/ organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Buxheti (€) ndër vite					
						2026	2027	2028	2029	2030	Shuma
1.1.1	Themelimi i grupit punues për rishikimin e strukturës organizative					/	/	/	/	/	/
1.1.2	Shqyrtimi dhe rishikimi i ndarjes së detyrave të zyrtarëve të arsimit në DKA					/	/	/	/	/	/
1.1.3	Rishikimi i strukturës organizative për menaxhim të arsimit në nivel komunal					/	/	/	/	/	/

Masa 1.2: Organizimi i trajnimeve për personelin e DAKRS dhe udhëheqës të shkollave

Kodi	Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Përgjegjësia	Institucioni/ organizata mbështetëse	Përshkrimi i kostos	Buxheti (€) ndër vite					
						2026	2027	2028	2029	2030	Shuma
1.2.1	Caktimi i zyrtarit arsimor për identifikimin e nevojave për zhvillim profesional	XI-2026	DAKRS			/	/	/	/	/	/

	të personelit të DAKRS dhe udhëheqësve të shkollave										
Mirëm. dhe riparim i automjeteve	-		-	-				3,321.50
Mirëmbajtja e ndërtesave								-
Mirëmbajtja e rrugëve lokale								7,400.00
Mirmb.e teknologjisë informatike								-
Mirëmbajtja e mobileve&pajisjeve			311.00			1,550.00		2,093.00
Mirmbajtja rutinore								-
Qiraja								-
Reklammat dhe konkurset								-
Botime dhe publikime								-
Kompensim i perfaqesimit brenda vendit								2,656.30
Vendim gjykate						39,250.65		46,370.98
TOTALI M & SH	901.03	-	12,081.64	6,361.73	-	72,938.97	584.94	149,059.00

SHPENZIMET ANALITIKE KOMUNALIVE, SUBVENCIONEVE DHE INVESTIMEVE KAPITALE

Përshkrimi	Z.Kryetarit	Administrata	Zh. Ekono.	Sh. Publike	K. Komunal	B.Financa	Urbanizem	ZLK
Shpenzimet e energjisë elektrike		2,155.05	43.77	28,544.21	-			
Shpenzimet e Ujët		246.49	33.74	78.11	-			
Shpenzimet e Mbeturinave	-			2,416.00	-	-	-	
Shpenzimet e Ngrohjes								
Shpenzimet Telefonike	62.86	257.30	64.95		-	28.65		
Pagesa Vendime gjyqsore		-	-	1,604.61	-	-	-	
TOTALI KOMUNALËVE	62.86	2,658.84	142.46	32,642.93	-	28.65	-	-
Subvencionet per etnitetet publike								
Subvencionet per etnitetet jopublike	2,800.00							
Pagesa Vendime gjyqsore	1,000.00							
TOTALI SUBVENCIONEVE	3,800.00	-	-	-	-	-	-	-
Ndërtesa Administrative				248,647.50				
Objekte Arsimore								
Objektet kuturore								
Objektet shendetesore			9,408.40					
Auto Rrugëve								
Rrugët Lokale			2,000.00					
Trotuaret								
Kanalizimi								
Ujësjiellësi								
Furniz.Rrymë								
Paisje speciale mjeksore								
Pajisje tjera								
Mirmbajtja investive								
automjete transporti (autoambulanca)								
Transaksione Kapitale - enti. Publ.								
Pag.neni 39.2 LMFPF								
Vendim gjykate			8,519.20	18,606.72			10,000.00	
TOTALI I INVESTIMEVE	-	-	19,927.60	267,254.22	-	-	10,000.00	
TOTALI I PËRGJITHSHËM	73,633.92	79,054.20	61,946.01	366,281.56	81,406.29	54,299.78	56,607.99	5,724.28

Përshkrimi	Ad. Arsim	Ars. Parafillor	Ars. fillor	A. i mesem	Ad. Shendet.	QKMF	Sh. Sociale	Totali periodik 2026
Shpenzimet e energjisë elektrike			2,144.38	714.41		2,303.66	231.25	36,136.73
Shpenzimet e Ujët			584.26	113.12	-	123.87	110.14	1,289.73
Shpenzimet e Mbeturinave			700.00	588.00	-	336.00		4,040.00
Shpenzimet e Ngrohjes								-
Shpenzimet Telefonike			181.86	109.50	-	47.97	125.94	879.03
Pagesa Vendime gjyqsore								1,604.61
TOTALI KOMUNALËVE	-	-	3,610.50	1,525.03	-	2,811.50	467.33	43,950.10
Subvencionet per etnitetet publike								-
Subvencionet per etnitetet jopublike								2,800.00
Pagesa Vendime gjyqsore								1,000.00
TOTALI SUBVENCIONEVE	-	-	-	-	-	-	-	3,800.00
Ndërtesa Administrative								248,647.50
Objekte Arsimore								-
Objektet kuturore								-
Objektet shendetesore								9,408.40
Auto Rrugëve								-
Rrugët Lokale								2,000.00
Trotuaret								-
Kanalizimi								-
Ujësjiellësi								-
Furniz.Rrymë								-
Paisje speciale mjeksore								-
Pajisje tjera								-
Mirmbajtja investive								-
automjete transporti (autoambulanca)								-
Transaksione Kapitale - enti. Publ.								-
Pag.neni 39.2 LMFPF								-
Vendim gjykate						3,967.19		41,093.11
TOTALI I INVESTIMEVE	-	-	-	-	-	3,967.19	-	301,149.01
TOTALI I PËRGJITHSHËM	30,778.80	11,469.89	294,224.31	109,726.17	14,911.85	283,303.67	10,284.62	1,533,653.34

Shënime shpjeguese:

Në totalin e pagave të shpenzuara në vlerë prej **1,035,695.23€** janë nga granti i përgjithshëm, për pagesën e pagave të punëtorëve në listën e pagave, Mëditjet e komiteteve dhe shtesat e veçanta.

Kategoria e Mallrave dhe shërbimeve të shpenzuara në vlerë prej **149,059.00€** nga granti i përgjithshëm janë 144,260.38€, nga te hyrat vetanake te vitit 2026 janë 4,798.62€ .

Në këtë shume janë të përfshira **45,970.98€** pagesa nga vendimet gjyqësore përmbarimore nga Kontrata kolektive e Arsimit.

Kategoria e Komunalive të shpenzuara në vlerë prej **43,950.10€** nga granti i përgjithshëm janë 32,331.05€, nga te hyrat e bartura te vitit 2025 janë 11,619.05€ .

Në këtë shume janë të përfshira **1,604.61€** pagesa nga vendimet gjyqësore përmbarimore nga Kontrata kolektive e Arsimit.

Kategoria e Subvencioneve të shpenzuara në vlerë prej **3,800.00€** të gjitha janë nga granti i përgjithshëm.

Në këtë shume janë të përfshira **1,000.00€** pagesa nga vendimet gjyqësore përmbarimore nga Kontrata kolektive e Arsimit.

Kategoria e Investimeve Kapitale të shpenzuara në vlerë prej **301,149.01€** nga granti i përgjithshëm janë 43,772.91€, nga te hyrat vetanake te vitit 2026 janë 6,728.60€, nga te hyrat e bartura te vitit 2025 janë 2,000.00€ dhe nga Donacionet janë 248,647.50


Në këtë shume janë të përfshira **41,093.11€** pagesa nga vendimet gjyqësore përmbarimore nga Kontrata kolektive e Arsimit.

Totali i pagesave nga vendimet gjyqësore përmbarimore për shlyerjen e obligimeve nga Kontrata kolektive e Arsimit në këtë periudhë janë **89,668.70€**

Shpenzimet sipas Drejtorive dhe progresi me periudhën e njëjtë të viteve paraprake

Shpenzimet Periodike sipas Drejtorive 2023-2026								
	Drejtoritë	2023	2024	2025	2026	Alokimet TM2 2026	Progr. / alokim	Progr. me 2025
1	Zyra e Kryetarit	44,168.51	52,889.77	60,328.60	73,633.92	91,001.64	80.9%	122.1%
2	Kuvendi Komunal	63,837.39	68,608.19	73,095.74	81,406.29	84,191.89	96.7%	111.4%
3	Administratë	88,356.60	63,028.16	68,180.95	79,054.20	97,632.06	81.0%	115.9%
4	Buxhet dhe Financa	27,866.56	36,498.16	37,532.15	54,299.78	58,476.22	92.9%	144.7%
5	Zhvillimi Ekonomik	31,743.97	37,075.35	119,387.72	61,946.01	126,650.20	48.9%	51.9%
6	Sh.publike	52,531.91	50,183.59	115,982.27	366,281.56	523,760.27	69.9%	315.8%
7	Planifikimi urban	170,956.81	39,765.19	129,797.40	56,607.99	81,472.82	69.5%	43.6%
8	ZKK	2,226.25	3,997.62	4,378.08	5,724.28	5,724.28	100.0%	130.7%
9	Shëndetsia	158,047.71	203,319.69	237,785.08	308,500.14	350,180.21	88.1%	129.7%
12	Arsimi	346,508.33	342,972.79	325,408.84	446,199.17	523,825.74	85.2%	137.1%
Totali Buxhetor		986,244.04	898,338.51	1,171,876.83	1,533,653.34	1,942,915.33	78.9%	130.9%

GRAFIKONI I SHPENZIMEVE TE DREJTORIVE SI DHE PJESMARRJA NE SHPENZIMIN TOTAL



Në kuadër të Shëndetësisë janë të përfshira: Drejtoria e Shëndetësisë (Administrata), QKMF dhe Shërbimet Sociale.

Në kuadër të Arsimit janë të përfshira: Drejtoria e Arsimit (Administrata), Arsimi parashkollor, Arsimi fillor dhe Arsimi i mesëm.

❖ Progresi i shpenzimeve kapitale sipas projekteve për vitin 2026

Emri i projektit	Kodi i projektit në Thesar	Buxheti 2026	Alokimet TM2/ 2026	Shpenzimet aktuale I - VI / 2026	Struktura në %
	1	2	3	4	5
Bashkefinancim I projekteve	46030	128,909.31	66,251.80	10,472.95	15.81
Kanalizimi I ujrave te zeza lokacioni Qender , Gaxherr i ulet	56315	10,000.00	-	-	#DIV/0!
Rregullimi I infrastruktures se oborrit te SHFMU E. Hoxha Faza II	57157	10,000.00	-	-	#DIV/0!
Ndertimi I Kanaleve te ujitjes Qender, Qok, Miroc, Gacafer	56284	33,556.00	-	-	#DIV/0!
Ndertimi I rrjetit te ndriqimit publik ne rruget lokale junik	55010	-	-	-	#DIV/0!
Ndertimi I Ashensorit per persona me aftesi te kufizuara ne QKMF	57158	5,000.00	-	-	#DIV/0!
Ekzekutimi I vendimeve gjyqesore (Neni 40 LMFPP)	00040	42,454.65	42,454.65	40,028.56	94.29
Rekonstruimi I Rruges "Shkelzen Gacaferi " Faza I	56323	2,000.00	2,000.00	2,000.00	100.00
Permiresimi I objekteve te burimeve te efikasitetit te energjise	92237	370,643.80	370,643.80	248,647.50	67.09
Permiresim I qas.kujde.zhvill. Gjate femijerise	94618	356.50	356.50	-	-
Participim I projekteve	88351	260.98	260.98	-	-
Ngjitja e performances	92052	1,834.87	1,834.87	-	-
Totali		605,016.11	483,802.60	301,149.01	62.25

* Në Projektin bashkëfinancim i projekteve në vlerë prej 10,472.95€ janë të përfshira: 9,408.40€ projekti Ndërtimi i Ashensorit për persona me aftësi të kufizuara ne QKMF ne bashkëfinancim me AQH. 1,064.55€ janë ekzekutuar nga vendimet gjyqësore përmbartimore për shlyerjen e obligimeve nga Kontrata kolektive e Arsimit

Ne kuadër te Investimeve kapitale Ministria e Financave bazuar ne Ligjin e buxhetit 2026 e ka krijuar një kod të ri të projektit me nr. 00040 me titull Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore (Neni 40 LMFPP) në shumë totale prej 42,454.65€ këto mjete janë transferuar nga projektet si vijon: 20,000.00€ nga projekti "Ndërtimi i rrjetit te ndriqimit publik ne rruget lokale Junik", 7,000.00€ nga Projekti "Ndërtimi i Kanaleve te ujitjes Qendër, Qok, Miroc, Gacafer, Berishe, 7 Shtatori", 10,000.00€ nga Projekti "Kanalizimi i ujërave te zeza lokacioni Qendër , Gaxherr i ulet, Pepsh, Berishe, Kallavaj", 5,000.00€ nga Projekti Ndërtimi i Ashensorit për persona me aftësi te kufizuara ne QKMF" 454.65€ nga Projekti "Bashkëfinancimi i Projekteve". Shpenzim ne këtë kod për këtë periudhe janë 40,028.56€ te cilat janë ekzekutuar nga vendimet gjyqësore përmbartimore për shlyerjen e obligimeve nga Kontrata kolektive e Arsimit

Mjetet e alokuara për Investime kapitale janë 483,802.60€ nga këto burime:

- Grandi 46,199.00€ + Te hyrat vetanake 34,087.49€ + Të hyrat e bartura 30,419.96€ dhe 373,096.15€ nga donacionet.

Realizimi i buxhetit për investime kapitale në total është 301,149.01€, prej tyre (43,772.91€ nga Grandi + 6,728.60€ nga të hyrat vetanake + 2,000.00€ nga të hyrat e bartura dhe 248,647.50€ nga Donacionet).

Progresi i realizimit te investimeve Kapitale karshi mjeteve të alokuara për periudhën Janar – Qershor të vitit 2026 është 62.25% .

PASQYRA E OBLIGIMEVE TË PA PAGUARA JANAR– QERSHOR 2026

Programet Buxhetore	M&SH	Komunali	Subvencione	Kapitale	Gjithsej	Borgji momental	Pagesa deri me 00/00/26
	21,572.02	11,177.59	-	-	32,749.61		
					-		-
					-		-
					-		-
GJITHSEJ	21,572.02	11,177.59	-	-	32,749.61	-	-

Të arkëtueshmet

		2026
Kodi ekonomik	Përshkrimi	€ '000
40110	Tatim ne prone	328,505.87
50408	Qiraja nga objektet publike	3,300.00
Gjithsej		331,805.87

❖ REKAPITULLIMI I INFORMATËS FINANCIARE

Kjo informatë periodike Janar – Qershor / 2026 ka për qëllim informimin detal dhe objektiv për të gjithë treguesit financiar, qofshin pozitive apo negative.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që rezultatet pozitive të menaxhimit të këtij buxheti ti forcojmë dhe ti rrisim më tutje, ndërsa treguesit negativë ti eliminojmë gjatë periudhave në vijim. E tërë kjo me qëllim që të jemi sa më të suksesshëm në realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për qëllimet e përcaktuara me planet dinamike të veprimit sipas ligjit mbi Buxhetin.

❖ PLANIFIKIMI BUXHETOR JANAR - QERSHOR 2026

Buxheti fillestar i aprovuar nga Kuvendi Komunal në vlerë **2,538,612.00€** ka pasur ndryshime – rritje në periudhën Janar - Qershor 2026 për: **373,113.65€**, nga mjetet e pranuar nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2025, Bartja e te hyrave të pashpenzuara të vitit 2025 të bartura për shpenzim në vitin 2026 në shumë prej **50,419.96€**. Do të thotë buxheti total për vitin 2026 ka vlerën: **2,962.145.61€**.

❖ SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE JANAR - QERSHOR 2026

- **Shpenzimet nga Grandi qeveritar:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë 1,480,294.23€, janë shpenzuar 1,259,859.57€ që do të thotë **85.11%** të mjeteve të alokuara.
 - **Shpenzimet nga të hyrat vetanake:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë 39,087.49€, janë shpenzuar 11,527.22 € që do të thotë **29.49%** te mjeteve të alokuara.
 - **Shpenzimet nga Mjetet e bartura të viti paraprak:** Mjetet e alokuara nga ky burim janë 50,419.96€, janë shpenzuar 13,619.05 € që do të thotë **27.01%** te mjeteve të alokuara.
 - **Shpenzimet nga Donacionet dhe Participimet:** Nga mjetet e pranuar në vlerë 373,113.65€ janë shpenzuar 248,647.50€ ose **66.64%** të mjeteve të alokuara – pranuar.
- Ne përgjithësi në këtë periudhë Janar - Qershor 2026 vlen të përmendet efikasiteti i lartë në menaxhimin e buxhetit (pagesa) **78.94%** e mjeteve të alokuara buxhetore, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025 kemi shpenzime me të larta prej **30.87%**.

❖ TË HYRAT BUXHETORE PERIODIKE JANAR - QERSHOR 2026

- **Të Hyrat Vetanake:** Komuna ka realizuar të hyra vetanake në periudhën Janar - Qershor 2026, me donacione 462,621.10€ ose **23.81%** të alokimeve prej 1,942,915.33€.
- **Pengesat që kanë ndikuar në rezultate edhe më të mëdha janë:**
 1. Grandi Qeveritar jo i mjaftueshëm për realizimin e aktiviteteve të parapara nga Komuna dhe kufizimet në planifikimin e shpenzimeve operative.
 2. Obligimet nga Kontrata kolektive e arsimit

Duke pasur parasysh indikatorët e lartë cekur Komuna e Junikut, në Periudhën Janar – Qershor 2026 ka arritur rezultate të mira të cilat u bënë të ditura më lartë.

ZKF
Arten Hamza

Drejtori Buxhet e Financa
Ardita Hoxha

Kryetari i Komunës
Ruzhdi Shehu



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 2-155/5060
një. Org. 2
Nr. i freg. 38
Data 13 / 07 / 2026



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Datë/ Datum/ Date:	13.07.2026
Për/ Za/ To:	z. Leonard Llojuni - Kryesues i Kuvendit Komunal
CC:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës së Junikut
Nga/ Od/ From:	z. Besart Tofaj - Nënkryetar i Komunës së Junikut
Tema/ Subjekti/ Subject:	Kërkesë

I nderuar,

Bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal Nr. 02-180/2271 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale 2026-2030, si dhe në Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 01-92 për themelimin e Grupit Punues për hartimin e këtij plani.

Në cilësinë e kryesuesit të Grupit Punues, ju sjellim draftin e "Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale 2026-2030", me qëllim të shqyrtimit dhe procedimit për lexim të parë në Kuvendin Komunal.

Me respekt,



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna Junik – Opština Junik – Municipality of Junik

PLANI PËR MENAXHIMIN E TOKAVE RURALE 2026 - 2030
PËR KOMUNËN E JUNIKUT

Junik, 2026

Përmbajtja.....	2
Lista e Shkurtesave.....	3
Lista e Figurave.....	4
Lista e Tabelave.....	4
Grupi Punues.....	5
I. Hyrje.....	6
II. Legjislacioni në fuqi i lidhur me menaxhimin e tokës.....	7
III. Objektivat e përgjithshme dhe specifike.....	9
III.1 Objektivat e përgjithshme të Planit për Menaxhimin e Tokës.....	9
III.2 Objektivat specifike të planit.....	9
IV. Metodologjia e shfrytëzuar në përgatitjen e planit.....	10
V. Profili i Komunës.....	12
V.1 Pozita gjeografike dhe organizimi administrative.....	12
V.2 Karakteristikat natyrore.....	13
V.3 Tipet e tokave.....	13
V.4 Kategorizimi i tokës.....	15
V.5 Popullsia dhe vendbanimet.....	16
V.6 Zhvillimi ekonomik.....	17
V.6.1 Bizneset.....	17
V.6.2 Zona industriale.....	18
V.6.3 Sektori minier.....	18
V.7 Infrastruktura.....	18
V.8 Transporti dhe infrastruktura rrugore.....	19
V.9 Shëndetësia dhe mirëqenia sociale.....	20
V.10 Trashëgimia kulturore.....	21
V.11 Turizmi.....	22
VI. Indikatorët mjedisorë.....	23
VI.1 Ndikimi i ndryshimeve klimatike.....	24
VI.2 Ujësjellësi dhe kanalizimi.....	25
VII. Profili i Bujqësisë.....	25
VII.1. Të dhënat për bujqësinë.....	25
VII.2 Gjendja e tokës.....	27
VII.2.1 Boniteti.....	27
VII.2.2 Sipërfaqet nën ujë.....	28

VII.2.3 Plehrat.....	28
VIII. Pylltaria.....	29
VIII.1 Gjendja e pyjeve	29
VIII.2 Problemet kryesore.....	30
VIII.3 Masat për mbrojtje.....	30
VIII.4 Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	30
IX. Analiza SWOT.....	31
X. Të gjeturat dhe prioritetet për menaxhimin e tokave rurale.....	32
XI. Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës.....	33
XII. Plani i veprimit.....	35

Lista e Shkurtesave

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
 BE - Bashkimi Evropian
 FAO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi
 MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
 MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
 MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
 MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 OJQ - Organizatë Joqeveritare / Organizata Joqeveritare
 PZHK - Plani Zhvillimor Komunal
 QKMF - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
 QPS - Qendra për Punë Sociale

Lista e Figurave

Figura nr 1: Pozita gjeografike e komunës së Junikut në Hartën e Kosovës

Figura nr 2. Numri i bizneseve në vitin 2026

Figura nr 3. Harta pedologjike e Komunës së Junikut 1

Figura nr 3. Harta pedologjike e Komunës së Junikut 2

Lista e Tabelave

Tabela nr 01 Ligjet tjera, qëllimi dhe fushëveprimi i tyre

Tabela nr 02 Lista e dokumenteve të përdorura për hartim të planit

Tabela nr 03 Aktivitetet e grupit punues

Tabela nr 04 Tipet e tokave kryesore në komunën e Junikut

Tabela nr 05 Kategorizimi i tokës bujqësore të kulturës arë në Komunën e Junikut

Tabela nr 06 Lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme, MKRS 2025

Tabela nr 07 Analiza e rreziqeve

Tabela nr 08 Analiza e masave për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike

Grupi Punues

Grupi punues për hartimin e Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale 2026 - 2030 është themeluar me Vendimin nr. 01/92 të Kryetarit të Komunës, z. Ruzhdi Shehu.

Grupi punues ka këtë përbërje:

Besart Tofaj – Nënkryetar i Komunës, kryesues

Tafë Tofaj – Udhëheqës i Sektorit për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar

Florentina Qestaj – Zyrtare për Bujqësi, anëtare

Leonita Jasiqi – Zyrtare për Integritet Europian

Zenun Shala – Drejtor për Urbanizëm, Kadashtë dhe Mjedis, anëtar

Demokrat Ganiqaj – Drejtor për Shërbime Publike, Inspektion, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar

I. Hyrje

Toka është një nga burimet natyrore më të rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë dhe për funksionimin e ekosistemeve. Ajo paraqet shtresën sipërfaqësore të kores së Tokës, e formuar gjatë proceseve të gjata natyrore nën ndikimin e faktorëve klimatikë, biologjikë dhe gjeologjikë. Përbërja e saj përfshin grimca minerale, ujë, ajër dhe lëndë organike, të cilat së bashku krijojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin e vegjetacionit dhe organizmave të ndryshëm.

Karakteristikat fizike dhe kimike të tokës varen nga materiali amë mbi të cilin është formuar, kushtet klimatike, relievi dhe mënyra e shfrytëzimit nga njeriu. Në strukturën vertikale të saj dallohen tri shtresa kryesore. Shtresa sipërfaqësore (Horizonti A) është më e pasura me lëndë organike dhe aktivitet biologjik; Horizonti B shërben si zonë grumbullimi e mineraleve dhe elementeve të transportuara nga shtresat e sipërme, ndërsa Horizonti C përbëhet kryesisht nga materiali bazë i formuar nga shpërbërja e shkëmbinjve.

Roli i tokës nuk kufizohet vetëm në prodhimin bujqësor. Ajo ka funksione të rëndësishme ekologjike duke mundësuar filtrimin dhe ruajtjen e ujit, qarkullimin e elementeve ushqyese, ruajtjen e biodiversitetit dhe stabilizimin e proceseve natyrore në mjedis. Për këtë arsye, toka konsiderohet një pasuri strategjike për zhvillimin ekonomik dhe social të çdo territori.

Me rritjen e nevojave për zhvillim ekonomik dhe urban, toka përdoret gjithnjë e më shumë për ndërtimin e vendbanimeve, objekteve ekonomike, infrastrukturës rrugore dhe aktiviteteve të tjera. Megjithatë, zgjerimi i pakontrolluar i zonave të ndërtimit, industrializimi dhe praktikat jo të qëndrueshme të përdorimit të tokës kanë ndikuar në zvogëlimin e sipërfaqeve produktive dhe në degradimin gradual të fondit tokësor.

Në Republikën e Kosovës, ndër sfidat kryesore që ndikojnë në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e tokës janë erozioni, rrëshqitjet e dheut, ulja e përmbajtjes së lëndës organike, ndotja nga aktivitete të ndryshme ekonomike, degradimi fizik dhe kimik si dhe ndryshimi i destinimit të tokave bujqësore për qëllime të tjera zhvillimore.

Edhe Komuna e Junikut përballë me sfida të ngjashme. Në disa zona vërehen presione të vazhdueshme mbi tokën bujqësore si rezultat i zgjerimit të ndërtimeve, shfrytëzimit jo racional të resurseve natyrore, proceseve erozive dhe ndikimeve që lidhen me ndryshimet klimatike. Këta faktorë ndikojnë në uljen e pjellorisë së tokës dhe në zvogëlimin e kapaciteteve prodhuese të saj.

Humbja graduale e tokës së punueshme dhe rënia e cilësisë së saj paraqesin rrezik për zhvillimin e sektorit bujqësor, sigurinë ushqimore dhe mirëqenien ekonomike të popullsisë lokale. Për këtë arsye, mbrojtja e fondit tokësor dhe promovimi i praktikave të

qëndrueshme të menaxhimit të tokës duhet të jenë pjesë e prioritetëve zhvillimore të komunës.

Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës kërkon planifikim afatgjatë, monitorim të vazhdueshëm të gjendjes së saj dhe zbatim të masave mbrojtëse që sigurojnë ruajtjen e produktivitetit dhe vlerave mjedisore. Vetëm përmes një qasjeje të integruar mund të garantohet shfrytëzimi racional i këtij burimi të rëndësishëm natyror dhe ruajtja e tij për brezat e ardhshëm.

II. Legjislacioni në fuqi i lidhur me menaxhimin e tokës

Baza ligjore për hartimin e Planit për Menaxhimin e Tokës Rurale 2026 – 2030 mbështetet në legjislacionin dhe dokumentet strategjike të Republikës së Kosovës që rregullojnë mbrojtjen, përdorimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tokës.

Gjatë hartimit të planit janë marrë parasysh ligjet dhe aktet nënligjore që lidhen me tokën bujqësore, planifikimin hapësinor, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin rural, pylltarinë, ujërat dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Këto dokumente sigurojnë bazën ligjore për ruajtjen e fondit tokësor dhe shfrytëzimin e tij në mënyrë të qëndrueshme.

Ky plan është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe prioritetet zhvillimore të Komunës së Junikut. Në vijim paraqiten aktet kryesore ligjore dhe dokumentet strategjike që ndërlidhen me menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës.

Ligjet/ Udhëzimet administrative/ Rregulloret	Qëllimi dhe fushëveprimi
Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale	Përcakton statusin juridik të komunave, kompetencat vetanake, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, si dhe përgjegjësitë e tyre në planifikimin lokal, zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e tokës dhe ofrimin e shërbimeve publike. Ky ligj përbën bazën ligjore për hartimin dhe zbatimin e Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale në nivel komunal.
Ligji Nr. 08/L-137 për Pyjet	Ky ligj i definon pyjet e Kosovës si resurse kombëtare, andaj ka për qëllim që ato të udhëhiqen në atë mënyrë që të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme.
Ligji Nr. 02/L-26 për tokën bujqësore	Toka bujqësore si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm, ka mbrojtje të veçantë dhe duhet të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore dhe nuk

	mund të përdoret për qëllime tjera përveç në rastet e përcaktuara më këtë ligj dhe me dispozitat e tjera të nxjerrura në bazë të tij.
Ligji Nr. 02/L-9 për ujëtimin e tokave bujqësore	Ky Ligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore për themelimin dhe funksionimin e subjekteve që afrojnë shërbime dhe shfrytëzuesve të shërbimeve dhe organizimin e mirëfilltë të tyre në mënyrë që të krijohen kushtet optimale për ujëtimin e tokës bujqësore në Kosovë dhe mbrojtjen e saj nga ujërat e tepërta me qëllim të shtimit të rendimenteve të prodhimeve bujqësore.
Ligji Nr. 08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Ky ligj përcakton objektivat, masat dhe programin e politikave të bujqësisë dhe të zhvillimit rural në bazë të Planit për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor.
Ligji Nr. 04/L-040 për Rregullimin e Tokës	Ligji rregullon konsolidimin, rregullimin dhe rirregullimin e parcelave të tokës me qëllim të përmirësimit të strukturës pronësore, shfrytëzimit më racional të tokës, zhvillimit të bujqësisë dhe realizimit të projekteve me interes publik.

Tabela nr 1 Ligjet tjera, qëllimi dhe fushëveprimi i tyre

Përveç legjislacionit të përmendur më sipër, gjatë hartimit të këtij plani janë marrë në konsideratë edhe dokumentet planifikuese dhe strategjike të Komunës së Junikut, të cilat përcaktojnë orientimet zhvillimore dhe prioritetet sektoriale të komunës.

Me poshtë paraqiten dokumentet kryesore planifikuese dhe strategjike të cilat kanë shërbyer si bazë për përcaktimin e objektivave, masave dhe aktiviteteve të Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale 2026 - 2030.

Dokumenti	Qëllimi dhe fushëveprimi
Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Junikut 2025-2033	Është bazë për zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Junikut, dhe synon ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe balancimin e zhvillimeve hapësimore. Përmes këtij plani koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike.
Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Junikut 2026 - 2033	Paraqet synimet strategjike zhvillimore socioekonomike me impakt afat-mesëm në zhvillimin ekonomik lokal të Komunës së Junikut. Në mënyrë të veçantë qëllimi i këtij dokumenti është i fokusuar në përmirësimin dhe ruajtjen e mjedisit.

Statuti i Komunës së Junikut	Rregullon organizimin e brendshëm të komunës dhe përcakton përgjegjësitë vetanake të organeve komunale.
Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"	Përcakton organizimin hapësinor, zonimin, masat mbrojtëse dhe mënyrën e përdorimit të qëndrueshëm të territorit të Parkut Kombëtar, duke krijuar bazë për harmonizimin e zhvillimit lokal me ruajtjen e burimeve natyrore.
Programi për Bujqësinë Digjitale 2025 – 2028	Përcakton orientimet për digjitalizimin e sektorit bujqësor përmes përdorimit të sistemeve GIS, monitorimit të parcelave, menaxhimit të të dhënave dhe zhvillimit të shërbimeve digjitale, me qëllim përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit të tokës bujqësore.

Tabela nr 2 Lista e dokumenteve të përdoruara për hartim të planit

Plani për Menaxhimin e Tokave Rurale 2026 – 2030 është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe dokumentet strategjike të Komunës së Junikut. Objektivat, masat dhe aktivitetet e planit kontribuojnë në mbrojtjen e tokës bujqësore, menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, zhvillimin rural, përmirësimin e infrastrukturës bujqësore, mbrojtjen e biodiversitetit dhe përdorimin racional të burimeve natyrore, në harmoni me Ligjin për Tokën Bujqësore, Ligjin për Pyjet, Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ligjin për Rregullimin e Tokës, Ligjin për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", Planin Zhvillimor Komunal 2025–2033, Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033 dhe Programin për Bujqësinë Digjitale 2025–2028.

III. Objektivat e përgjithshme dhe specifike

3.1 Objektivat e përgjithshme të Planit për Menaxhimin e Tokës

Qëllimi kryesor i Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale në Komunën e Junikut është të sigurojë mbrojtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokave rurale, përmes zbatimit të masave dhe aktiviteteve që kontribuojnë në ruajtjen e tokës bujqësore, përmirësimin e infrastrukturës rurale, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe rritjen e produktivitetit të saj. Plani synon gjithashtu të forcojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve lokale dhe qendrore, si dhe të krijojë bazën për planifikim, monitorim dhe vendimmarrje të qëndrueshme në menaxhimin e tokave rurale.

3.2 Objektivat specifike të planit

- Të vlerësohet gjendja aktuale e tokave rurale dhe ndikimi i aktiviteteve zhvillimore në cilësinë, përdorimin dhe produktivitetin e tyre;

- Të identifkohen dhe analizohen problemet dhe faktorët kryesorë që ndikojnë në degradimin, ndotjen, erozionin dhe menaxhimin e tokës në territorin e Komunës së Junikut;
- Të mbrohet toka bujqësore nga ndërrimi i destinimit, ndërtimet e pakontrolluara dhe degradimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet komunale të planifikimit hapësinor;
- Të identifkohen parcelat e fragmentuara, lokat e pashfrytëzuara dhe rrugët fushore të uzurpuara, si dhe të vlerësohet nevoja për rregullim dhe konsolidim të tokës në funksion të shfrytëzimit më racional të saj;
- Të përmirësohet infrastruktura rurale mbështetëse për bujqësinë, me theks në rehabilitimin e kanaleve të kullimit, zgjerimin e sipërfaqeve nën ujti dhe përmirësimin e qasjes në parcela bujqësore;
- Të mbrohet toka nga erozioni, ndotja dhe degradimi në zonat bujqësore, pyjore dhe kullosore, përmes masave parandaluese, rehabilituese dhe praktikave të menaxhimit të qëndrueshëm;
- Të planifikohen masa, aktivitete dhe projekte konkrete për zbatimin e prioriteteve të identifikuar, duke përcaktuar afatet kohore, institucionet përgjegjëse dhe burimet e mundshme të financimit;
- Të krijohet mekanizëm i monitorimit dhe raportimit për zbatimin e planit, në bashkëpunim me drejtoritë komunale dhe institucionet përkatëse, përmes indikatorëve të matshëm të performancës;
- Të promovohet përdorimi i teknologjive digjitale dhe sistemeve GIS për evidentimin, monitorimin dhe menaxhimin e tokave rurale;
- Të forcohet bashkëpunimi ndër-institucional me institucionet qendrore, Agjencinë Pyjore të Kosovës, Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", MBPZHR-në dhe organizatat partnere për zbatimin e masave të planit.

IV. Metodologjia e shfrytëzuar në përgatitjen e planit

Për hartimin e Planit për Menaxhimin e Tokës Rurale 2026 – 2030 është përdorur një qasje e integruar, e bazuar në analizën e gjendjes ekzistuese, identifikimin e sfidave dhe prioriteteve kryesore, si dhe në konsultimet me strukturat relevante komunale.

Metodologjia e përdorur për hartimin e planit është bazuar në:

- Identifikimin e faktorëve dhe presioneve kryesore që ndikojnë në gjendjen dhe menaxhimin e tokave rurale në territorin e Komunës së Junikut;
- Analizën e të dhënave ekzistuese dhe dokumenteve relevante strategjike, planifikuese dhe sektoriale;
- Vlerësimin e gjendjes aktuale të tokës dhe ndikimit të aktiviteteve zhvillimore në cilësinë dhe përdorimin e saj;

- Identifikimin dhe prioritetimin e problemeve kryesore që kërkojnë ndërhyrje gjatë periudhës planifikuese;
- Përcaktimin e objektivave, masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tokës;
- Hartimin e planit të veprimit dhe përcaktimin e afateve kohore, institucioneve përgjegjëse dhe burimeve të mundshme të financimit;
- Propozimin e mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit përmes indikatorëve përkatës të performancës.

Procesi i hartimit të këtij dokumenti ka përfshirë bashkëpunimin ndërmjet drejtorive komunale dhe akterëve relevantë lokalë, me qëllim sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në trajtimin e çështjeve që lidhen me menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës rurale në Komunën e Junikut.

Për hartimin e planit janë organizuar tre takime kryesore:

Aktiviteti	Data
Takimi 1 - Analiza mbi modelin për hartimin e Planit	07.05.2026
Takimi 2 - Planifikimi i aktiviteteve, SWOT analiza.	03.07.2026
Vizitë në Institutin Bujqësor	08.07.2026
Takimi 3 - Implementimi, monitorimi dhe vlerësimi final i planit	Do të realizohet

Tabela nr.3 Aktivitetet e grupit punues

Para fillimit të procesit të hartimit të këtij plani janë shqyrtuar dokumentet ligjore, strategjike dhe planifikuese relevante në nivel qendror dhe lokal. Në këtë kuadër është analizuar legjislacioni që rregullon menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës, si dhe dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Junikut që lidhen me zhvillimin hapësinor, mjedisor dhe rural.

Gjithashtu, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna dhe informata relevante nga burime të ndryshme institucionale, të cilat kanë shërbyer si bazë për vlerësimin e gjendjes aktuale, identifikimin e sfidave dhe prioritetëve, si dhe për planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Planit për Menaxhimin e Tokës Rurale 2026 – 2030.

Gjatë hartimit të këtij plani janë marrë në konsideratë edhe orientimet e Programit për Bujqësinë Digjitale 2025-2028 të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me theks në përdorimin e sistemeve të informacionit gjeografik (GIS), monitorimin e parcelave bujqësore, digjitalizimin e të dhënave dhe përmirësimin e procesit të planifikimit, monitorimit dhe menaxhimit të tokave rurale. Këto orientime janë marrë parasysh si pjesë e qasjes bashkëkohore për menaxhimin e burimeve tokësore dhe forcimin e kapaciteteve institucionale në nivel lokal.

Po ashtu, gjatë hartimit të planit janë analizuar dokumentet strategjike komunale, dokumentet sektoriale dhe legjislacioni në fuqi, me qëllim sigurimin e harmonizimit të

plotë të këtij dokumenti me politikat kombëtare dhe lokale për zhvillimin rural, mbrojtjen e tokës dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

V. Profili i Komunës

Ky kapitull paraqet një pasqyrë të karakteristikave kryesore të Komunës së Junikut, duke përfshirë pozitën gjeografike, resurset natyrore, strukturën demografike, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën dhe karakteristikat mjedisore. Këto elemente krijojnë bazën për vlerësimin e gjendjes aktuale të tokave rurale dhe për përcaktimin e masave për menaxhimin e tyre të qëndrueshëm.

5.1 Pozita gjeografike dhe organizimi administrative

Pozita gjeografike e Junikut është e veçantë, pasi ndodhet në rajonin jugperëndimor të vendit, afër kufirit me dy shtete: Shqipërinë dhe Malin e Zi, duke krijuar mundësi për zhvillim ndërkufitar dhe bashkëpunim me komunat fqinje dhe shtetin shqiptar.

Ajo ka një sipërfaqe prej rreth 77.77 km² dhe shtrihet në gjerësi gjeografike 42°22' dhe gjatësi gjeografike 20°26', duke përfshirë një territor malor dhe rural, i cili është i pasur me burime natyrore të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë, pylltarisë dhe turizmit malor.



Figura nr 1: Pozita gjeografike e komunës së Junikut në Hartën e Kosovës

Komuna e Junikut ka lidhje të drejtpërdrejta me komunat fqinje, të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të rajonit. Komunat fqinje janë Komuna e Deçanit dhe Komuna e Gjakovës.

Maja më e lartë në Republikën e Kosovës është Gjeravica, me 2,656 m lartësi mbidetare.

Gjithashtu, në Komunën e Junikut gjenden Lumi Erenik dhe Lumi i Qetë. Lumi Erenik buron në Bjeshkët e Junikut dhe kalon përmes fshatrave Gjocaj dhe Jasiq, pas së cilës vazhdon rrjedhën e tij dhe derdhet në Drinin e Bardhë.

5.2 Karakteristikat natyrore

Komuna e Junikut karakterizohet nga klimë kontinentale me disa tipare mesdhetare, e cila krijon kushte të favorshme për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Sipas Planit Zhvillimor Komunal, mesatarja e temperaturës është 21°C në verë dhe -11°C në dimër, ndërsa sasia mesatare e reshjeve është afër 670 mm, prej të cilave rreth 330 mm bien gjatë sezonit të vegjetacionit (prill-shtator).

5.3 Tipet e tokave

Territori i Komunës së Junikut karakterizohet nga një larmi tipesh të tokës, të formuara si rezultat i relievit, përbërjes gjeologjike, kushteve klimatike dhe proceseve pedogjenetike. Kjo larmi krijon potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë dhe aktiviteteve të tjera ekonomike. Sipas Planit Zhvillimor Komunal (2024–2032), nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës rreth 4,439 ha (57.08%) janë tokë bujqësore, ndërsa mbi 3,029 ha (38.95%) janë pyje. Gjithashtu, livadhet dhe kullotat zënë rreth 2,000 ha, duke përfshirë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e blegtorisë dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të kullosave. Në zonat fushore dominojnë tokat më të thella dhe më pjellore, të përshtatshme për prodhim intensiv bujqësor, ndërsa në zonat kodrinore dhe malore mbizotërojnë toka më të cekëta, të përshtatshme kryesisht për pylltari dhe kullota. Bazuar në Hartën Pedologjike të Kosovës (Instituti "Jaroslav Černi", 1974), në territorin e Komunës së Junikut identifikohen këto tipe kryesore të tokës




Figura nr 2. Harta pedologjike e Komunės sē Junikut 1




Figura nr 3. Harta pedologjike e Komunės sē Junikut 2

Pavarësisht potencialit prodhues të një pjese të tokave bujqësore, ato përballen me procese të vazhdueshme degradimi, si erozioni, humbja graduale e pjellorisë, fragmentimi i parcelave, ndryshimi i destinimit të tokës bujqësore dhe praktikat jo adekuate të kultivimit. Zbatimi i masave meliorative, përmirësimi i sistemeve të ujitjes dhe kullimit, mbrojtja nga erozioni, si dhe promovimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore do të kontribuojnë në ruajtjen dhe rritjen e produktivitetit të tokës.

Klasifikimi i tokave bujqësore bazohet në karakteristikat fizike dhe kimike të tokës, relievin dhe kushtet klimatike. Në vlerësimin e bonitetit merren parasysh tipi i tokës, tekstura, thellësia efektive, kullimi, pjerrtësia e terrenit, lartësia mbidetare dhe reshjet mesatare vjetore. Metodologjia e klasifikimit është përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2012 për klasifikimin e përshtatshmërisë së tokës bujqësore.

Në bazë të analizës së tipologjisë dhe bonitetit të tokave, prioritetet e këtij Plani orientohen drejt mbrojtjes së tokës bujqësore, parandalimit të degradimit, përmirësimit të produktivitetit dhe promovimit të menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve tokësore në Komunën e Junikut.

5.4 Kategorizimi i tokës

Sipas Planit Zhvillimor Komunal të Junikut (PZHK 2025-2033), në faqen 97, përkatësisht në Tabelën 18 - "Kategorizimi i tokës bujqësore të kulturës arë", jepen të dhëna për kategorizimin e tokës bujqësore sipas klasave I-VII.

Këto të dhëna i referohen vetëm tokës bujqësore të kulturës arë, me sipërfaqe totale prej 653 ha, dhe jo gjithë territorit të komunës.

Kategoria	Sipërfaqja (ha)
Kategoria I	32
Kategoria II	116
Kategoria III	181
Kategoria IV	40
Kategoria V	265
Kategoria VI	14
Kategoria VII	5
Gjithsej	653

Tabela nr 3 Kategoritë e tokës bujqësore

Kategorizimi i tokës shërben si bazë për planifikimin e përdorimit të tokës, orientimin e investimeve në bujqësi dhe mbrojtjen e tokave me potencial më të lartë prodhues.

5.5 Popullsia dhe vendbanimet

Zhvillimi demografik paraqet një element të rëndësishëm për planifikimin dhe zhvillimin e përgjithshëm të Komunës së Junikut, pasi ndikon drejtpërdrejt në organizimin e shërbimeve publike, planifikimin hapësior dhe orientimin e politikave zhvillimore. Komuna e Junikut karakterizohet nga një strukturë demografike relativisht e vogël dhe homogjene, ku shumicën dërrmuese të popullsisë e përbëjnë shqiptarët.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2024, Komuna e Junikut ka 3,943 banorë, prej të cilëve 1,968 janë meshkuj dhe 1,957 femra. Popullsia është e përqendruar kryesisht në vendbanimin e Junikut me 3,925 banorë, ndërsa në Gjocaj janë regjistruar 18 banorë, kurse Jasiqi nuk figuron me banorë rezidentë në regjistrimin e fundit. Në të njëjtën periudhë, në komunë janë regjistruar 895 ekonomi familjare.

Krahasuar me regjistrimin e vitit 2011, kur Komuna e Junikut kishte 6,084 banorë, të dhënat e vitit 2024 tregojnë një rënie të ndjeshme të numrit të popullsisë. Ky ndryshim lidhet me lëvizjen e popullsisë drejt qendrave urbane dhe jashtë vendit, fenomen që ka ndikuar në zvogëlimin e popullsisë rezidente dhe në dobësimin e aktivitetit në zonat rurale.

Struktura sipas grupmoshave tregon se popullsia e komunës ka një moshë mesatare prej 38.6 vjeç. Grupmoshat më të përfaqësuara janë ato të moshës aktive, veçanërisht grupet 45-49 vjeç (334 banorë), 15-19 vjeç (311 banorë), 20-24 vjeç (300 banorë) dhe 50-55 vjeç (302 banorë). Kjo strukturë tregon se komuna ende ka një bazë të konsiderueshme të popullsisë në moshë pune, por njëkohësisht përballlet me sfida që lidhen me rënien e popullsisë dhe plakjen graduale demografike.

Sa i përket përbërjes etnike, Komuna e Junikut ka një strukturë pothuajse homogjene, ku 3,938 banorë janë shqiptarë, ndërsa vetëm një numër shumë i vogël i takon komuniteteve të tjera. Lidhe përbërja sipas besimit tregon dominim të popullsisë me përkatësi islame, me 3,842 banorë, ndërsa një numër i vogël i përket kategorive të tjera ose kanë zgjedhur të mos deklarohen.

Në aspektin arsimor, të dhënat tregojnë se në Komunën e Junikut 813 persona të grupmoshës 5-29 vjeç janë duke vijuar shkollimin, prej tyre në arsimin fillor, të mesëm dhe universitar. Kjo paraqet një tregues të rëndësishëm për strukturën e re të popullsisë dhe për nevojën e planifikimit të politikave zhvillimore në fushën e arsimit, punësimit dhe rinisë.

Sa i përket lëvizjes natyrore të popullsisë, gjatë vitit 2024 janë regjistruar lindje dhe vdekje, të cilat reflektojnë trendet aktuale demografike të komunës. Në përgjithësi, Komuna e Junikut paraqitet si një komunë e vogël me strukturë demografike të qëndrueshme, por me rënie të numrit të popullsisë krahasuar me periudhat e mëhershme, çka kërkon vëmendje në planifikimin e zhvillimit ekonomik, social dhe hapësior të saj.

Rënia e numrit të popullsisë dhe migrimi nga zonat rurale paraqesin sfida edhe për shfrytëzimin e tokës bujqësore dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në komunë.

5.6 Zhvillimi ekonomik

Ekonomia lokale e Junikut karakterizohet nga një numër i kufizuar i bizneseve aktive, ku dominon sektori i shërbimeve dhe tregtisë së vogël.

Aktivitetet prodhuese janë të pakta, megjithatë, Komuna e Junikut ka potencial për zhvillimin e industrisë së lehtë, përpunimit të produkteve bujqësore, turizmit rural dhe agroturizmit, të cilët mund të kontribuojnë në rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik lokal.

5.6.1 Bizneset

Sipas të dhënave nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës në vitin 2026 kemi 115 biznese aktive në Komunë e Junikut, më poshtë gjeni numrin e bizneseve sipas sektorëve.



Figura nr 4. Numri i bizneseve në vitin 2026

5.6.2 Zona industriale

Zona industriale në Komunën e Junikut trajtohet në Planin Zhvillimor Komunal si një nga orientimet për zhvillimin ekonomik në zonën urbane. Krijimi dhe funksionalizimi i kësaj zone synon përqendrimin e aktiviteteve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese në një hapësirë të përshtatshme, me qëllim të nxitjes së investimeve, krijimit të vendeve të reja të punës dhe forcimit të bazës ekonomike të komunës. Zhvillimi i zonës industriale lidhet ngushtë me përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse dhe me krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillimin e bizneseve lokale.

5.6.3 Sektori minierar

Sipas Planit Zhvillimor Komunal të Junikut, sektori minierar trajtohet në kuadër të shfrytëzimit të tokës, ku në hartën e gjendjes ekzistuese evidentohet kategoria "Zonë-minierë dhe Gurorë". Kjo tregon praninë e hapësirave me potencial ose përdorim për aktivitete nxjerrëse, të cilat duhet të menaxhohen në përputhje me kriteret mjedisore dhe planifikuese të Komunës.

5.7 Infrastruktura

Në vitet pas luftës, Komuna e Junikut ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të forcuar bazën e saj ekonomike. Janë arritur përparime të dukshme në zhvillimin e rrjetit rrugor, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, duke lehtësuar qarkullimin dhe lidhjen ndërmjet vendbanimeve.

Gjithashtu, janë realizuar investime të rëndësishme në ndërtimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, duke përmirësuar ndjeshëm kushtet e jetesës për qytetarët. Në sektorin e arsimit, është punuar në zgjerimin e kapaciteteve shkollore dhe në pajisjen e tyre me inventar modern, duke krijuar kushte më të mira për nxënësit dhe stafin arsimor.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe përmirësimit të hapësirave publike dhe mjedisit, përfshirë rregullimin e parqeve, ndërtimin e fushave sportive, trotuareve dhe parkingjeve, si dhe zgjerimin e ndriçimit publik në të gjithë territorin e komunës. Këto investime kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së jetesës dhe në krijimin e një ambienti më të përshtatshëm për qytetarët.

Një nga prioritetet kryesorë mbetet krijimi i kushteve të favorshme për tërheqjen e investimeve dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Në këtë drejtim, bashkëpunimi ndërmjet nivelit lokal dhe institucioneve qendrore është thelbësor, duke synuar që investimet private dhe ato të huaja të jenë shtytës kryesorë të rritjes ekonomike.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve, Komuna e Junikut synon të krijojë një mjedis më tërheqës për investitorët përmes zhvillimit të zonave ekonomike dhe përmirësimit të infrastrukturës mbështetëse. Këto iniciativa përfshijnë edhe përgatitjen e analizave dhe

studimeve të nevojshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe efikas.

5.8 Transporti dhe infrastruktura rrugore

Transporti dhe komunikacioni paraqesin një komponent të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe social të Komunës së Junikut, pasi ndikojnë drejtpërdrejt në lëvizjen e qytetarëve, qasjen në shërbime dhe lidhjen e komunës me qendrat e tjera urbane. Komuna e Junikut karakterizohet kryesisht nga transporti rrugor, ndërsa qasja në territorin e saj realizohet përmes rrugëve regjionale dhe komunale që e lidhin me komunat përreth dhe me pikat kufitare.

Qasja në Junik sigurohet përmes disa akseve kryesore rrugore, përfshirë lidhjen me rrugën regjionale Pejë-Gjakovë në gjatësi prej 5.5 km, lidhjen me Gjakovën dhe Shqipërinë nëpër Ponoshec në gjatësi prej 2.3 km, si dhe lidhjet me Gjakovën nëpër Dobrosh, Nivokaz, Pacaj dhe Hereq. Po ashtu, komuna lidhet me Deçanin përmes rrugës regjionale nëpër Voksh dhe rrugës komunale nëpër Prelep dhe Drenoc. Sipas të dhënave komunale, të gjitha këto lidhje rrugore janë në gjendje të mirë dhe i shërbejnë nevojave aktuale të transportit.

Gjatësia e përgjithshme e rrugëve të asfaltuara në territorin e Komunës së Junikut është rreth 26.1 km, prej të cilave 7.5 km janë rrugë regjionale dhe 18.6 km rrugë komunale. Në raport me sipërfaqen e komunës prej 77.77 km², kjo paraqet rreth 0.34 km rrugë të asfaltuar për çdo km² të territorit komunal. Krahas rrjetit të asfaltuar, në komunë ekzistojnë edhe rreth 15 km rrugë fushore me sipërfaqe dheu ose zhavorri, të cilat shfrytëzohen kryesisht në mënyrë sezonale.

Rrjeti rrugor i komunës ka rëndësi të veçantë për lidhjen e vendbanimeve me qendrën komunale, për qasjen në tokat bujqësore, zonat rurale dhe hapësirat me potencial zhvillimor. Në veçanti, infrastruktura rrugore është me rëndësi për menaxhimin e tokave rurale, pasi mundëson qasje më të lehtë në sipërfaqet bujqësore, kullosat, zonat pyjore dhe parcelat prodhuese, duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e aktiviteve bujqësore dhe ekonomike në territorin e komunës. Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës rrugore dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese mbeten të rëndësishme për zhvillimin ekonomik, bujqësor dhe turistik të Komunës së Junikut.

Rrugët fushore paraqesin pjesë të rëndësishme të infrastrukturës rurale dhe mirëmbajtja e tyre ndikon drejtpërdrejt në qasjen e fermerëve në parcelat bujqësore.

5.9 Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

Kujdesi shëndetësor në Komunën e Junikut organizohet dhe ofrohet përmes sektorit publik dhe privat shëndetësor, ndërsa komuna ka përgjegjësi për ofrimin e kujdesit parësor shëndetësor publik dhe monitorimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e saj.

Kujdesi parësor shëndetësor në Komunën e Junikut ofrohet përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), e cila paraqet institucionin kryesor shëndetësor në komunë dhe ofron shërbime bazë shëndetësore për qytetarët, në përputhje me konceptin e mjekësisë familjare dhe sistemin shëndetësor të Republikës së Kosovës. QKMF funksionon si pika e parë e kontaktit të pacientëve me sistemin shëndetësor dhe luan rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse, cilësore dhe të bazuara në nevojat e popullatës.

Në Komunën e Junikut funksionon një objekt shëndetësor publik – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, gjendja e së cilës vlerësohet si shumë e mirë, si rezultat i investimeve dhe ndërhyrjeve të realizuara gjatë viteve të fundit në përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjen me aparaturë mjekësore moderne. Gjatë vitit 2025, në QKMF janë ofruar gjithsej 41,346 shërbime shëndetësore, çka reflekton rritje të kërkesës për shërbime, por edhe ngritje të kapaciteteve institucionale dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Në fushën e mirëqenies sociale, shërbimet sociale dhe asistencë sociale në Komunën e Junikut ofrohen përmes Qendrës për Punë Sociale (QPS). Në kuadër të saj funksionojnë shërbimet profesionale sociale dhe mekanizmat e mbështetjes për kategoritë në nevojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. QPS ofron mbështetje dhe mbrojtje sociale për individët dhe familjet në nevojë, për fëmijët pa përkujdesje prindërore, si dhe për kategori të tjera të ndjeshme sociale.

Sipas të dhënave për vitin 2025, nga skema e ndihmës sociale në Komunën e Junikut kanë përfituar gjithsej 1,505 anëtarë të familjeve, përkatësisht 469 familje, ndërsa mesatarja mujore ka qenë rreth 125 anëtarë dhe 39 familje. Shuma vjetore e mjeteve financiare të shpërndara për këtë skemë ka qenë 54,708.00 €.

Po ashtu, sipas të dhënave të siguruara nga institucionet përkatëse, në vitin 2026 në Komunën e Junikut janë evidentuar gjithsej 1,161 përfitues nga skema të ndryshme pensionale dhe sociale, përfshirë:

- 543 përfitues të pensioneve bazike të moshës;
- 422 përfitues të pensioneve për veteranët e luftës;
- 58 përfitues të pensioneve kontributpaguese të moshës;
- 100 përfitues të pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës;
- 38 përfitues të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara.

Gjatë vitit 2025, Qendra për Punë Sociale në Komunën e Junikut ka trajtuar gjithsej 278 raste, duke ofruar mbështetje sociale dhe shërbime profesionale në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e saj ligjore.

Në përgjithësi, sektori i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në Komunën e Junikut paraqet një komponent të rëndësishëm të zhvillimit social dhe të cilësisë së jetesës së qytetarëve. Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës shëndetësore, rritja e qasjes në shërbime dhe forcimi i mekanizmave të mbrojtjes sociale mbeten ndër prioritetet kryesore të komunës edhe në periudhën e ardhshme.

5.10 Trashëgimia kulturore

Komuna e Junikut posedon vlera të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe historike, të cilat përbëjnë pjesë të identitetit lokal dhe paraqesin potencial për zhvillimin e turizmit kulturor dhe rural. Kjo trashëgimi përfshin objekte me rëndësi historike, kulturore dhe fetare, si dhe elemente të trashëgimisë shpirtërore që janë ruajtur ndër breza.

Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore kanë rëndësi të veçantë për zhvillimin e qëndrueshëm të komunës dhe për forcimin e identitetit lokal. Në territorin e komunës janë evidentuar objekte dhe lokalitete me vlera kulturore dhe historike, të cilat trajtohen dhe mbrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet përkatëse të trashëgimisë kulturore.

Të dhënat mbi objektet dhe lokalitetet e trashëgimisë kulturore në Komunën e Junikut janë paraqitur në tabelën përkatëse, bazuar në evidencat e institucioneve kompetente për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Emri i objektit	Lokalitet	Kategoria e mbrojtjes
Lokalitet arkeologjik - Keshjtella e Junikut	Junik	Periudha Mesjetare

Peisazhet Kulturore		
Gjeravica	Junik	
Liqejt e Gjeravices	Junik	
Moronica (park me pisha)	Junik	
Kroni i Priftit	Junik	

Emri i objektit	Lokalitet	Kategoria e mbrojtjes
Kulla e Sadik Shehut	Junik	Shek. XIX
Kulla e Brahim Hoxhes	Junik	Shek. XVIII
Kulla e Jah Ymerit	Junik	Shek. XIX
Kulla e Tafe Hoxhes	Junik	Shek. XIX

Kulla e Ram Zyber Krasniqit	Junik	Shek. XIX
eqja e madhe amc e Tarikatit Alije - Halvetije ne Junik	Junik	Shek.XX
Tyrbja e "Dades Hate"	Junik	Shek. XIX
Xhamia e Qokut	Junik	1580
Kulla e Rruste Zeqirit	Junik	Shek. XIX
Tyrbja e Sheh Osman it	Junik	Shek. XIX
Kulla e Osmon Lollumit	Junik	Shek. XIX
Shkolla fillore "Edmon Hoxha"	Junik	Shek.XX
Kroni i Hoxhajve	Junik	
Kulla e Kukajve	Junik	Shek. XIX
Kulla e Nur Shales	Junik	Shek. XIX
Mulliri i Sallajve	Junik	Shek. XIX
Tyrbja e Derevish Hajdarit	Junik	Shek. XX
Tyrbja e Dervish Sadikut	Junik	Shek.XX
Kulla e Halit Hoxhes	Junik	Shek. XIX
Kulla e Sadik Rruces	Junik	Shek. XIX
Kulla e Zenel Hoxhes	Junik	Shek. XIX

Tabëla nr 5 Lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme, MKRS 2025

5.11 Turizmi

Turizmi në Komunën e Junikut paraqet një sektor me potencial të rëndësishëm zhvillimor, i mbështetur kryesisht në pasuritë natyrore, peizazhin malor dhe trashëgiminë kulturore të komunës. Edhe pse ky sektor ende nuk është zhvilluar në nivelin e dëshiruar, Juniku posedon resurse të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit malor, rural, kulturor, ekologjik dhe ndërkufitar.

Potenciali turistik i komunës mbështetet në pasuritë natyrore dhe kulturore, ku veçohen Bjeshkët e Junikut, Gryka e Junikut, Moronica, Grova e Lirenikut, Burimi i Lumit Lirenik, Liqenet e Gjeravicës, Kanioni i Junikut, Livadhi i Madh, si dhe lokalitetet e trashëgimisë kulturore. Këto zona krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin e ecjes malore, alpinizmit, kampimit, agroturizmit, sporteve malore, turizmit familjar, rekreativ dhe promovimit të produkteve tradicionale vendore.

Përveç vlerave natyrore dhe kulturore, zhvillimi i turizmit lidhet ngushtë edhe me zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë rurale. Agroturizmi, promovimi i produkteve lokale, bletaria, pemtaria dhe gastronomia tradicionale paraqesin potencial të rëndësishëm për krijimin e ofertës turistike dhe diversifikimin e të ardhurave të komunitetit lokal.

Megjithatë, zhvillimi i turizmit në komunë vazhdon të përballet me sfida të caktuara, sidomos me çështjet ligjore që lidhen me statusin e pazgjidhur të bujtinave apo staneve në zonat malore, kapacitetet ende të kufizuara të akomodimit, si dhe nevojën për investime të mëtejshme në infrastrukturën turistike dhe shërbimet mbështetëse. Aktualisht, në Komunën e Junikut funksionojnë vetëm dy biznese që ofrojnë shërbime akomodimi për turistët.

Duke pasur parasysh potencialin natyror dhe kulturor që posedon, turizmi mbetet një ndër sektorët me mundësi të mëdha për zhvillim ekonomik lokal, krijimin e vendeve të reja të punës dhe promovimin e Junikut si destinacion turistik në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Zhvillimi i turizmit rural dhe malor lidhet ngushtë me menaxhimin e qëndrueshëm të tokave, kullosave, pyjeve dhe hapësirave natyrore, të cilat përbëjnë bazën kryesore të ofertës turistike të komunës.

Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës, mbrojtja e peizazhit natyror dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore përbëjnë parakushtet kryesore për zhvillimin afatgjatë të turizmit në Komunën e Junikut, duke mundësuar shfrytëzimin racional të burimeve natyrore dhe rritjen e atraktivitetit të saj si destinacion turistik.

VI. Indikatorët mjedisorë

Sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), ndotja e mjedisit në Komunën e Junikut lidhet kryesisht me qarkullimin e automjeteve, emetimin e pluhurit, menaxhimin jo të plotë të mbeturinave dhe shkarkimin e ujërave të zeza në mjedis dhe në rrjedhat ujore. Këta faktorë ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e tokës, ujit dhe ajrit, duke krijuar presion mbi burimet natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

PZHK e identifikon si prioritet zvogëlimin e ndotjes së lumenjve dhe tokës nga mbeturinat, përmirësimin e sistemit të kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të zeza, si dhe forcimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Një ndër sfidat kryesore mbetet degradimi i tokës dhe rreziku nga erozioni, veçanërisht në zonat me pjerrësi të theksuar, në sipërfaqet pyjore të dëmtuara dhe përgjatë shtretërve të lumenjve. Sipas PZHK-së, Lumi Erenik paraqet rrezik të vazhdueshëm për vërshime gjatë periudhave me reshje intensive dhe shkrirje të borës. Ndërhyrjet e pakontrolluara në shtretërit e lumenjve, përfshirë nxjerrjen e materialeve inerte, ndikojnë në ndryshimin e rrjedhës natyrore të ujërave dhe rrisin rrezikun nga erozioni dhe përmytjet. Mbrojtja e tokës rurale është e lidhur ngushtë me mbrojtjen e ujërave, pyjeve dhe biodiversitetit, prandaj masat mjedisore duhet të zbatohen në mënyrë të integruar.

6.1 Ndikimi i ndryshimeve klimatike

Ndryshimet klimatike paraqesin një sfidë gjithnjë e më të madhe për menaxhimin e qëndrueshëm të tokave rurale në Komunën e Junikut. Rritja e temperaturave, periudhat më të gjata të thatësisë dhe reshjet intensive ndikojnë në uljen e lagështisë së tokës, shtimin e proceseve erozive dhe rritjen e rrezikut për degradimin e sipërfaqeve bujqësore.

Këto ndryshime ndikojnë gjithashtu në produktivitetin bujqësor, rrisin nevojën për sisteme më efikase të ujitjes dhe kërkojnë zbatimin e praktikave të qëndrueshme për ruajtjen e pjellorisë së tokës. Për këtë arsye, planifikimi dhe zbatimi i masave parandaluese dhe përshtatëse janë të domosdoshme për ruajtjen e potencialit prodhues të tokës dhe për rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit bujqësor ndaj ndryshimeve klimatike.

Njëkohësisht, mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale, ruajtja e livadheve dhe kullotave, mbrojtja e tokës bujqësore nga ndryshimi i destinimit, si dhe ruajtja e peizazhit natyror dhe biodiversitetit përbëjnë prioritet të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Junikut. Në këtë drejtim, menaxhimi i qëndrueshëm i tokës, pyjeve dhe burimeve ujore duhet të shoqërohet me monitorim të vazhdueshëm të gjendjes së mjedisit dhe koordinim ndërmjet institucioneve përgjegjëse, me qëllim identifikimin në kohë të problemeve dhe ndërmarrjen e masave parandaluese.

Rreziku	Ndikimi	Prioriteti
Frozioni	i lartë	i lartë
Vërshimet	mesatar	i lartë
Ndërrimi i destinimit të tokës	i lartë	i lartë
Prerjet ilegale	i lartë	i lartë
Zjarret	mesatar	i lartë
Ndotja e lumenjve	i lartë	i lartë
Ujërat e zeza	i lartë	i lartë

Tabela nr 6 Analiza e rreziqeve

Masat për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike

Masa	Qëllimi
Zgjerimi i sipërfaqeve nën ujilje	Zvogëlimi i ndikimit të thatësisë
Ripyllëzimi	Mbrojtja nga erozioni
Rehabilitimi i shtretërve të lumenjve	Zvogëlimi i rrezikut nga vërshimet
Mbrojtja e tokës bujqësore	Ruajtja e pjellorisë së tokës
Sistemet pikë-pikë	Kursimi i ujit

Tabela nr 7 Analiza e masave për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike

6.2 Ujësjellësi dhe kanalizimi

Furnizimi me ujë në Komunën e Junikut mbështetet në burime të pastra ujore dhe në rrjetin ekzistues të ujësjellësit, i cili vlerësohet të jetë në gjendje mesatarisht të mirë. Sipas të dhënave komunale, rreth 97% e banorëve furnizohen me ujë të pijshëm përmes sistemit të ujësjellësit. Rrjeti përfshin rreth 15 km gypa në gjendje të mirë dhe afërsisht 1.4 km në gjendje më të dobët, çka tregon nevojën për investime të mëtejshme në rehabilitimin dhe modernizimin e disa segmenteve të tij.

Në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj, furnizimi me ujë nuk realizohet përmes një sistemi të organizuar të ujësjellësit, por sigurohet nga burime natyrore me rrjedhje të lirë. Për këtë arsye, zgjerimi dhe modernizimi i infrastrukturës së ujësjellësit mbetet një ndër objektivat kryesore për të garantuar furnizim të sigurt dhe cilësor për të gjithë banorët e komunës.

Sa i përket kanalizimit, rrjeti i ujërave të zeza mbulon pjesën më të madhe të territorit të banuar dhe vlerësohet të jetë në gjendje relativisht të mirë. Megjithatë, në disa lagje të Junikut, si dhe në vendbanimet Gjocaj dhe Jasiq, rrjeti i kanalizimit ende mungon, prandaj ujërat e zeza shkarkohen drejtpërdrejt në mjedis. Kjo paraqet sfidë të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik.

Në këtë drejtim, mbetet prioritet zgjerimi i rrjetit të kanalizimit, përmirësimi i menaxhimit të ujërave të zeza dhe realizimi i investimeve në infrastrukturë, me qëllim mbrojtjen e burimeve ujore, ruajtjen e cilësisë së mjedisit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në të gjithë territorin e Komunës së Junikut.

VII. Profili i Bujqësisë

Bujqësia dhe zhvillimi rural përbëjnë një nga sektorët me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të Komunës së Junikut, duke u mbështetur në resurset tokësore, kushtet natyrore të favorshme dhe traditën e gjatë të prodhimit bujqësor.

7.1 Të dhënat për bujqësinë

Bujqësia dhe zhvillimi rural përbëjnë një nga sektorët me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të Komunës së Junikut, duke u mbështetur në resurset tokësore, kushtet natyrore të favorshme dhe traditën e gjatë të prodhimit bujqësor. Nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7,776.9931 ha, rreth 4,439 ha ose 57.08% përbëjnë tokë bujqësore, çka e bën këtë sektor një nga bazat kryesore të zhvillimit rural në komunë.

Brenda sipërfaqes bujqësore, livadhet dhe kullotat zënë rreth 2,000 ha, përkatësisht 45.05% të tokës bujqësore, ndërsa pyjet shtrihen në mbi 3,029 ha ose 38.95% të territorit

të komunës. Kjo strukturë e përdorimit të tokës krijon kushte të favorshme jo vetëm për prodhimtarinë bimore, por edhe për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë dhe aktiviteteve të tjera të lidhura me ekonominë rurale.

Sipas Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Junikut 2025-2033, zhvillimi i sektorit bujqësor mbështetet në mbrojtjen e tokës bujqësore, rritjen e prodhimtarisë, fuqizimin e fermerëve dhe zhvillimin e agroindustrisë. Prioritet i veçantë i kushtohet kultivimit të drithërave, pemëtarisë, perimtarisë, bletarisë dhe bimëve mjekësore, si dhe krijimit të kushteve për përpunimin dhe plasimin e produkteve vendore me vlerë të shtuar.

Ndër kulturat më të zhvilluara bujqësore në Komunën e Junikut janë gruri, misri, fasulja dhe thekra, ndërsa në sektorin e perimtarisë kultivohen kryesisht specat, domatet, lakrat dhe qepët. Në fushën e pemëtarisë kultivohen në masë mesatare molla, dardha, vishnja, boronica, mjedra dhe dredhëza, ndërsa vitet e fundit vërehet një tendencë e zgjerimit të sipërfaqeve me pemishte, e lidhur edhe me rritjen e kapaciteteve të ujitjes.

Përveç pemëve tradicionale, Komuna e Junikut ka potencial të konsiderueshëm edhe për kultivimin dhe grumbullimin e frutave pyjore, veçanërisht boronicës dhe gështenjës, si dhe të bimëve mjekësore dhe aromatike, të cilat paraqesin mundësi të rëndësishme për diversifikimin e ekonomisë rurale dhe rritjen e të ardhurave të fermerëve.

Të dhënat për vitin 2025 tregojnë se në komunë janë aktivë 18 fermerë në sektorin e bletarisë, me gjithsej 802 koshere me bletë. Po ashtu, 18 fermerë merren me blegtori, me mbi 150 krerë lopë qumështore, ndërsa 4 fermerë merren me mbarështimin e deleve, me rreth 900 krerë gjithsej. Këto të dhëna dëshmojnë se krahas prodhimtarisë bimore, blegtoria dhe bletaria përbëjnë segmente të rëndësishme të ekonomisë bujqësore lokale.

Në prodhimtarinë e kulturave lavërtare, gjatë vitit 2025 janë evidentuar 32 fermerë që merren me kultivimin e grurit, me sipërfaqe prej 82.16 ha, si dhe 37 fermerë që merren me kultivimin e misrit, me sipërfaqe prej 100.36 ha. Këto të dhëna pasqyrojnë praninë aktive të prodhimit bujqësor në komunë dhe rëndësinë që vazhdojnë të kenë kulturat bazë në strukturën prodhuese të fermave.

Sa i përket ujitjes, në Komunën e Junikut aktualisht janë 960 ha tokë punuese nën sistemin e ujitjes, çka paraqet një kapacitet të rëndësishëm për rritjen e produktivitetit bujqësor dhe zgjerimin e kulturave me vlerë më të lartë ekonomike, sidomos në pemëtarinë dhe perimtarinë. Përmirësimi dhe zgjerimi i mëtejshëm i infrastrukturës së ujitjes mbetet një ndër prioritetet kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit.

Praktikat e qëndrueshme bujqësore përfshijnë:

- rotacionin e kulturave;
- plehërimin organik;
- mbrojtjen e tokës;
- ujitjen pikë-pikë;
- analizat agro-kimike;

- reduktimin e pesticideve.

Zhvillimi i bujqësisë moderne kërkon përdorimin e teknologjive digjitale për menaxhimin e fermave dhe tokës bujqësore. Sistemet GIS, identifikimi digjital i parcelave, monitorimi i kulturave bujqësore dhe aplikacionet për menaxhimin e ujitjes mund të kontribuojnë në përdorimin më efikas të tokës, rritjen e produktivitetit dhe përmirësimin e planifikimit komunal. Në periudhën e zbatimit të këtij plani synohet promovimi gradual i këtyre teknologjive në bashkëpunim me MBPZHK-në dhe partnerët zhvillimorë.

7.2 Gjendja e tokës

Gjendja e tokës në Komunën e Junikut vlerësohet si përgjithësisht e favorshme për zhvillimin e bujqësisë, falë kushteve natyrore, klimës dhe përbërjes së saj pedologjike. Sipas të dhënave të PZHK-së dhe Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033, komuna disponon rreth 4,439 ha tokë bujqësore, që përfaqëson rreth 57.08% të sipërfaqes së përgjithshme. Krahas potencialit prodhues, toka përballlet me sfida si fragmentimi i parcelave, erozioni, ndryshimi i destinimit të tokës bujqësore dhe nevoja për zgjerimin e sistemeve të ujitjes. Për këtë arsye, ruajtja e cilësisë së tokës dhe menaxhimi i qëndrueshëm i saj paraqesin prioritet për zhvillimin rural të komunës. Monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së tokës dhe zbatimi i masave parandaluese mbeten elemente kyçe për ruajtjen e potencialit prodhues.

7.2.1 Boniteti

Sa i përket bonitetit të tokës bujqësore, toka e kulturës arë në komunë, me sipërfaqe totale prej 653 ha, është e klasifikuar në shtatë kategori. Sipas këtij klasifikimi, 22 ha i takojnë kategorisë I, 116 ha kategorisë II, 181 ha kategorisë III, 40 ha kategorisë IV, 265 ha kategorisë V, 14 ha kategorisë VI dhe 5 ha kategorisë VII. Kjo strukturë tregon se një pjesë e rëndësishme e tokës arë ka potencial të mirë prodhues, por kërkon menaxhim të kujdesshëm dhe masa të vazhdueshme mbrojtëse për ruajtjen e pjellorisë dhe parandalimin e degradimit.

Në aspektin ekonomik, sektori i bujqësisë ka peshë edhe në strukturën e bizneseve lokale. Nga 115 biznese aktive në Komunën e Junikut gjatë vitit 2026, gjithsej 15 biznese ushtrojnë aktivitet në fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit. Kjo tregon se, krahas rolit tradicional të bujqësisë në jetën rurale, ky sektor paraqet edhe potencial për zhvillim të mtejshëm ekonomik dhe rritje të vlerës së shtuar në nivel lokal.

Në përgjithësi, profili bujqësor i Komunës së Junikut karakterizohet nga një bazë e gjerë tokësore, prani e prodhimtarisë bimore dhe blegtorale, si dhe nga potencial për zgjerimin e pemëtarisë, bletarisë dhe sistemeve të ujitjes. Për këtë arsye, menaxhimi i qëndrueshëm

i tokës bujqësore, mbrojtja e saj nga degradimi, rritja e investimeve në ujitje dhe mbështetja e fermerëve mbeten elemente kyçe për zhvillimin rural dhe për fuqizimin e sektorit bujqësor në Komunën e Junikut.

7.2.2 Sipërfaqet nën ujitje

Ujitja e kulturave bujqësore paraqet një faktor me rëndësi të veçantë për rritjen e prodhimtarisë bujqësore, përmirësimin e rendimenteve dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e kulturave me vlerë më të lartë ekonomike, sidomos në pemëtari dhe perimtari. Në kushtet e ndryshimeve klimatike, periudhave të thata dhe nevojës për prodhim më të qëndrueshëm, sistemi i ujitjes mbetet një ndër elementet kyçe për zhvillimin e sektorit bujqësor në Komunën e Junikut.

Sipas të dhënave të Strategjisë Komunalet për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 - 2033, në Komunën e Junikut aktualisht janë 960 ha tokë punuese nën sistemin e ujitjes. Kjo sipërfaqe paraqet një potencial të rëndësishëm për rritjen e produktivitetit bujqësor dhe për zgjerimin e prodhimit në sektorët ku ujitja ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe sasinë e prodhimit.

Zgjerimi dhe përmirësimi i kapaciteteve të ujitjes mbetet një nevojë e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë në komunë, veçanërisht për rritjen e sipërfaqeve me pemishte, perime dhe kultura të tjera intensive. Në këtë drejtim, investimet në infrastrukturën ujëtare, menaxhimin racional të burimeve ujore dhe përfshirjen e sa më shumë sipërfaqeve prodhuese në sistemet e ujitjes janë të rëndësishme për shfrytëzimin më efikas të tokës bujqësore dhe për rritjen e të ardhurave të fermerëve.

7.2.3 Plehrat

Në Komunën e Junikut, në prodhimtarinë bujqësore përdoren si plehrat organike, ashtu edhe plehrat minerale, varësisht nga lloji i kulturës, gjendja e tokës dhe nevojat e fermerëve. Nga plehrat organike përdoret kryesisht plehu i stallës, i cili vazhdon të ketë rëndësi të veçantë në ruajtjen e pjellorisë së tokës dhe përmirësimin e strukturës së saj.

Përveç plehërimit organik, fermerët përdorin edhe plehra minerale, sidomos për plehërimin themelor dhe për riplehërim gjatë ciklit të prodhimit. Përdorimi i plehrave minerale bëhet në varësi të kulturave bujqësore dhe praktikave të kultivimit, ndërsa aplikimi i tyre duhet të bazohet në nevojat reale të tokës dhe të kulturave, me qëllim të ruajtjes së pjellorisë, shmangies së degradimit të tokës dhe mbrojtjes së mjedisit.

Në këtë drejtim, promovimi i praktikave të qëndrueshme të plehërimit, kombinimi i plehrave organike me ato minerale dhe orientimi i fermerëve drejt përdorimit racional të inputeve bujqësore mbeten të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë dhe për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore në Komunën e Junikut.

Aplikimi i plehrave duhet të bazohet në analizat agro-kimike të tokës dhe në rekomandimet profesionale, me qëllim ruajtjen e pjellorisë së saj, uljen e ndotjes dhe përdorimin racional të inputeve bujqësore.

VIII. Pylltaria

Pylltaria paraqet një nga sektorët me rëndësi të veçantë për zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Junikut. Përveç rolit në sigurimin e burimeve natyrore, pyjet kanë funksion të rëndësishëm në mbrojtjen e tokës, ruajtjen e burimeve ujore, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ruajtjen e biodiversitetit. Ato kontribuojnë gjithashtu në zhvillimin e ekonomisë rurale përmes blegtorisë, bletarisë, turizmit malor dhe aktiviteteve rekreative.

8.1 Gjendja e pyjeve

Pylltaria përbën një nga burimet më të rëndësishme natyrore të Komunës së Junikut dhe luan rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin rural dhe ruajtjen e biodiversitetit. Sipas Strategjisë Komunale për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033, pyjet shtrihen në një sipërfaqe prej mbi 3,029 ha, që përfaqëson rreth 38.95% të sipërfaqes së përgjithshme të komunës.

Bazuar në Planin Zhvillimor Komunal (PZIK), sipërfaqet pyjore janë të përqendruara kryesisht në pjesët kodrinore dhe malore të komunës, ku, përveç funksionit ekonomik, ato kanë rëndësi të madhe për mbrojtjen e tokës nga erozioni, ruajtjen e burimeve ujore, stabilizimin e terrenit dhe mbrojtjen e biodiversitetit. Pyjet ndikojnë gjithashtu në përmirësimin e cilësisë së ajrit, ruajtjen e peizazhit natyror dhe krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e turizmit malor, blegtorisë dhe bletarisë.

Menaxhimi i qëndrueshëm i fondit pyjor, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-137 për Pyjet, mbetet një nga prioritetet kryesore të komunës, me synim ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes së pyjeve për brezat e ardhshëm.

Përveç funksioneve mbrojtëse dhe ekologjike, pyjet paraqesin potencial edhe për zhvillimin e industrisë së drurit, grumbullimin e produkteve pyjore jo drusore dhe zhvillimin e bletarisë. Ilulumtimi i këtij potenciali dhe menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore mbetet objektiva afatgjata për zhvillimin ekonomik të komunës.

Aktualisht nuk ekziston një studim i plotë mbi gjendjen fitosanitare të pyjeve në Komunën e Junikut. Duke pasur parasysh rëndësinë e fondit pyjor dhe praninë e Parkut të Pishave dhe Moronicës, nevojitet evidentimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve që mund të ndikojnë në shëndetin e pyjeve. Për këtë arsye, plani parashih realizimin e një studimi fitosanitar dhe monitorimin periodik të gjendjes së pyjeve.

8.2 Problemet kryesore

Pavarësisht potencialit të konsiderueshëm pyjor, pyjet e Komunës së Junikut përballen me një sërë sfidash që ndikojnë në gjendjen dhe funksionet e tyre ekologjike dhe ekonomike. Problemet kryesore janë:

- prerjet ilegale dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i masës drusore;
- rreziku nga zjarret pyjore, veçanërisht gjatë periudhave të thata;
- degradimi i pyjeve dhe shtimi i proceseve erozive në zona të caktuara;
- dëmtimi i habitateve natyrore dhe humbja e biodiversitetit;
- ndikimi i ndryshimeve klimatike në shëndetin dhe ripërtëritjen e pyjeve.

8.3 Masat për mbrojtje

Për të siguruar menaxhim të qëndrueshëm të fondit pyjor dhe ruajtjen e funksioneve të tij ekologjike, parashihen këto masa:

- ripyllëzimi dhe rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara;
- monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së pyjeve dhe parandalimi i prerjeve ilegale;
- forcimi i masave për parandalimin dhe luftimin e zjarreve pyjore;
- mbrojtja e habitateve natyrore dhe ruajtja e biodiversitetit;
- promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve pyjore;
- edukimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për rëndësinë e pyjeve;
- bashkëpunimi me Agjencinë Pyjore të Kosovës, Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", organizatat vendore dhe partnerët ndërkombëtarë për zbatimin e projekteve në fushën e pylltarisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

8.4 Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve

Një pjesë e territorit të Komunës së Junikut shtrihet brenda Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", i cili paraqet zonë me vlera të larta natyrore, peizazhore dhe të biodiversitetit. Menaxhimi i tokave rurale në këto zona duhet të realizohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e natyrës dhe Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar, duke harmonizuar mbrojtjen e ekosistemeve me zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, blegtorisë tradicionale dhe aktiviteteve rurale.

Menaxhimi i fondeve pyjore duhet të realizohet sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, duke siguruar shfrytëzim racional të resurseve pyjore, ruajtjen e

biodiversitetit, mbrojtjen nga prerjet ilegale dhe zjarret, rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara dhe monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së pyjeve.

Bashkëpunimi me Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe administratën e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është i domosdoshëm për realizimin e këtyre objektivave.

IX. Analiza SWOT

Analiza SWOT paraqet një instrument të rëndësishëm për identifikimin e përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve që lidhen me menaxhimin e tokave rurale në Komunën e Junikut. Kjo analizë ndihmon në vlerësimin e gjendjes aktuale të resurseve tokësore, të kapaciteteve zhvillimore të komunës dhe të faktorëve të jashtëm që ndikojnë në shfrytëzimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tokës rurale.

Përparësitë	Dobësitë
- Sipërfaqe e konsiderueshme e tokës bujqësore (rreth 4,439 ha) dhe prani e livadheve, kullotave dhe pyjeve me potencial zhvillimor. - Kushte të favorshme natyrore dhe agroklimatike për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, pemëtarisë dhe bletarisë. - Traditë në prodhimin bujqësor dhe në shfrytëzimin e tokave rurale. - Prani e sipërfaqeve të mëdha me livadhe dhe kullosa, të favorshme për zhvillimin e blegtorisë. - Potencial i konsiderueshëm për pemëtarë, perimtarë, bletarë dhe kultivim të bimëve mjekësore. - Sipërfaqe pyjore dhe peizazh natyror që mbështesin ekonominë rurale, turizmin dhe mbrojtjen e tokës nga erozioni. - Ekzistenca e sipërfaqeve nën ujë dhe mundësia për zgjerimin e mëtejshëm të kapaciteteve ujëtare. - Pozitë e favorshme gjeografike dhe lidhje me tregjet rajonale për plasimin e produkteve bujqësore.	- L'fragmentimi i parcelave bujqësore dhe shfrytëzimi jo gjithmonë racional i tokës. - Mungesë ose pamjaftueshmëri e infrastrukturës ujëtare në disa zona bujqësore. - Kapacitete të kufizuara për përpunim, grumbullim dhe standardizim të produkteve bujqësore. - Përdorim jo i mjaftueshëm i teknikave bashkëkohore në prodhimtari dhe menaxhim të tokës. - Mungesë e investimeve të mjaftueshme në kullim, mbrojtje të tokës dhe përmirësim të infrastrukturës rurale. - Degradim i pjesshëm i tokës si pasojë e erozionit, ndërhyrjeve të pakontrolluara dhe ndryshimit të përdorimit të tokës. - Migrimi i popullsisë nga zonat rurale dhe mungesa e interesimit të rinjve për bujqësi. - Mungesë e organizimit më të fuqishëm të fermerëve në kooperativa ose forma të tjera bashkëpunimi. - Mungesa e sistemit të vazhdueshëm të monitorimit të gjendjes së tokës. - Mungesa e analizave agro-kimike të tokës.

Rreziqet	Mundësitë
- Humbja graduale e tokës bujqësore si pasojë e ndërtimeve, fragmentimit dhe ndryshimit të destinimit. - Ndryshimet klimatike, thatësiat, reshjet intensive dhe rritja e rrezikut nga erozioni dhe vërshimet. - Luhatjet e çmimeve në treg, kostot e larta të inputeve bujqësore dhe pasiguria e tregut. - Plakja e popullsisë rurale dhe zvogëlimi i fuqisë punëtore në bujqësi. - Ndotja e tokës dhe ujërave nga menaxhimi jo i duhur i mbeturinave dhe ujërave të zeza. - Degradimi i pyjeve, prerjet e pakontrolluara dhe humbja e funksioneve mbrojtëse të tyre. - Emigrimi i vazhdueshëm i të rinjve dhe mungesa e trashëgimisë aktive në fermat familjare. - Konkurrenca nga produktet e importuara dhe vështirësitë për standardizim dhe certifikim të prodhimit. - Përhapja e sëmundjeve dhe dëmtuesve në pyje.	- Mbështetja nga programet e Ministrisë së Bujqësisë, subvencionet dhe grantet për fermerë. - Fondet e donatorëve dhe programet e BE-së për zhvillim rural, ujtje, pemëtimi, blegtori dhe agroturizëm. - Zgjerimi i sipërfaqeve me pemishte, perime dhe kultura me vlerë më të lartë ekonomike. - Zhvillimi i agroturizmit dhe turizmit rural në lidhje me bjeshkët, kullosat, bujtinat dhe produktet lokale. - Përmirësimi i sistemeve të ujitjes dhe shfrytëzimi më efikas i tokës bujqësore. - Rritja e interesimit për produkte vendore, organike dhe produkte me origjinë lokale. - Mundësia e organizimit të fermerëve në shoqata, kooperativa dhe zinxhirë lokalë të vlerës. - Zhvillimi i përpunimit lokal të produkteve bujqësore dhe rritja e vlerës së shtuar. - Digjitalizimi i evidencës së tokave bujqësore dhe përdorimi i GIS për planifikim dhe monitorim. - Bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet kërkimore.

Analiza SWOT tregon se Komuna e Junikut posedon potencial të konsiderueshëm në tokën bujqësore, pylltari dhe turizëm rural, megjithatë sfidat kryesore mbeten fragmentimi i pronave, degradimi i tokës, mungesa e sistemeve të ujitjes dhe migrimi i popullsisë rurale. Për këtë arsye, prioritetet e planit janë orientuar drejt mbrojtjes së tokës, përmirësimit të infrastrukturës rurale dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

X. Të gjeturat dhe prioritetet për menaxhimin e tokave rurale

Bazuar në analizën e gjendjes në terren, diskutimet me grupin punues dhe shqyrtimin e sfidave që lidhen me menaxhimin e tokave rurale në Komunën e Junikut, janë identifikuar disa çështje prioritare që kërkojnë trajtim të veçantë në kuadër të Planit të Menaxhimit të Tokave. Këto prioritetë lidhen kryesisht me ruajtjen e funksionalitetit të infrastrukturës rurale, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe përmirësimin e menaxhimit mjedisor në zonat rurale.

Ndër çështjet kryesore të evidentuara janë:

- degradimi ose humbja e funksionit të kanaleve kulluese dhe ujore në disa zona rurale;
- nevoja për identifikimin dhe hapjen e rrugëve fushore dhe rrugëve publike të uzurpuara, me qëllim të sigurimit të qasjes në parcelat bujqësore;
- identifikimi dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave, të cilat paraqesin rrezik për tokën bujqësore, mjedisin dhe shëndetin publik;
- nevoja për masa konkrete për mbrojtjen e tokës nga degradimi, erozioni, ndotja dhe ndryshimi i pakontrolluar i përdorimit të saj.

XI. Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës

Për menaxhimin e qëndrueshëm të tokave rurale, përfshirë tokat bujqësore, kullosat dhe sipërfaqet pyjore, janë identifikuar një sërë praktikash dhe masash që mund të kontribuojnë në ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së tokës, rritjen e produktivitetit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore.

Këto masa përfshijnë:

- rritjen e përdorimit të lëndës organike në tokë, përmes plehërimit organik, plehërimit të gjelbër dhe kultivimit të kulturave leguminoze;
- aplikimin racional të plehrave dhe inputeve bujqësore, në përputhje me praktikën e mira bujqësore;
- përdorimin e metodave konservuese të punimit të tokës, si lëvrimi minimal dhe mbjellja direkte, me qëllim të ruajtjes së strukturës së tokës;
- mbulimin e tokës me kultura mbuluuese ose me mbetje bimore, për të reduktuar erozionin dhe humbjen e lagështisë;
- zbatimin e rotacionit bimor ndërmjet kulturave të ndryshme, sidomos ndërmjet drithërave dhe leguminozeve;
- promovimin e prodhimit organik dhe përdorimin e inputeve të lejuara për bujqësi organike;
- menaxhimin e qëndrueshëm të kullosave përmes kullotjes së kontrolluar dhe rotative;
- zbatimin e masave kundër erozionit, përfshirë punimin konturor të tokës, mbjelljen në terrene me pjerrësi sipas izohipsave dhe krijimin e brezave mbrojtës;
- zhvillimin e praktikave të agropylltarisë dhe ruajtjen e brezave drunorë në zonat bujqësore;
- përmirësimin e drenazhimit të tokave në zonat ku paraqitet tepëricë e ujit;
- identifikimin dhe evidentimin e tokave djerrinë me qëllim të vënies së tyre në funksion përmes dhënies me qira ose shfrytëzimit nga fermerët e interesuar;

- menaxhimin më të mirë të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe zgjerimin e sistemeve efikase të ujitjes;
- mbrojtjen e tokës nga erozioni lumor dhe nga shfrytëzimi i pakontrolluar i materialeve inerte;
- rregullimin dhe shtrimin e rrugëve fushore ekzistuese, si dhe hapjen e rrugëve të reja sipas nevojave të sektorit bujqësor;
- identifikimin kadastral të rrugëve fushore të uzurpuara dhe kthimin e tyre në funksion publik;
- menaxhimin e mbeturinave inerte dhe të mbetjeve të tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në degradimin e tokës bujqësore.

Të gjitha këto masa dhe praktika duhet të analizohen në mënyrë më të detajuar dhe, sipas prioriteteve të komunës, të përkthehen në projekte konkrete investuese dhe masa institucionale. Këto projekte mund të planifikohen për financim nga buxheti komunal, nga programet qendrore mbështetëse, si dhe nga donatorë dhe partnerë të tjerë zhvillimorë. Zbatimi i tyre do të kontribuojë drejtpërdrejt në mbrojtjen, përmirësimin dhe menaxhimin më të qëndrueshëm të tokave rurale në Komunën e Junikut.

XII. Plani i veprimit (2026 - 2027 - 2028)

Plani i veprimit për zbatimin e Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale 2026 - 2030 për Komunën e Junikut

Objektivi	Aktiviteti	Viti	Buxheti (€)	Burimi i financimit	Institucioni përgjegjës	Ndikimi i pritshëm
Menaxhimi i tokës bujqësore	Rehabilitimi i kanaleve ekzistuese të ujitjes	2026- 2027- 2028	60,000 2026 20,000 2027 20,000 2028 20,000	Komuna, Donacione, MBPZHR	DZHE	Përmirësohet kullimi i tokës dhe zvogëlohen vërshimet
	Ndërtimi i kanaleve të reja të ujitjes në zonat me potencial bujqësor	2026	2026 41,000	Komuna, Donacione, MBPZHR	DZHE	Përmirësohet infrastruktura për ujitje
Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	Studimi fitosanitar i pyjeve në Parkun e Pishave dhe Moronicë	2027- 2028	30,000 2027 10,000 2028 20,000	Komuna, Donacione, MBPZHR	DZHE	Evidentohen sëmundjet dhe masat për trajtimin e tyre
	Ripyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara	2027- 2028	40,000 2027 20,000 2028 20,000	Komuna, Donacione, MBPZHR	DZHE	Përmirësohet fondi pyjor
	Pastrimi i mbeturinave në zonat pyjore dhe turistike	2026- 2027- 2028	15,000 2026 5,000 2027 5,000 2028 5,000	Komuna, Donacione	DSHP	Përmirësohet gjendja mjedisore
Mbrojtja e tokës nga	Identifikimi i zonave me	2027- 2028	16,000 2027 8,000 2028 8,000	Komuna, Donacione	DSHP	Prioritizohen ndërhyrjet

erozioni dhe vërshimet	rrezik nga erozioni					
	Pastrimi dhe rehabilitimi i shtrretërve të lumenjve	2027-2028	150,000 2027 60,000 2028 90,000	Komuna, Donacione	DSHP	Përmirësohet rrjedha e ujërave
Menaxhimi i rrugëve fushore	Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore	2027-2028	20,000 2027 10,000 2028 10,000	Komuna, Donacione, MBPZHR	DZHE	Lehtësohet qarkullimi i fermerëve
Menaxhimi i mbeturinave	Eliminimi i deponive ilegale ilegale në zonat rurale	2027-2028	10,000 2027 5,000 2028 5,000	Komuna, Donacione	DSHP	Ulet ndotja e tokës
Edukimi dhe monitorimi	Trajnime për fermerët mbi praktikat e mira bujqësore dhe menaxhimin e tokës	2026-2027-2028	24,000 2026 8,000 2027 8,000 2028 8,000	Komuna, Donacione, MBPZHR	DZHE	Përmirësohet menaxhimi i tokës
	Hartimi i raportit vjetor për zbatimin e Planit	2026-2027-2028	3,000 2026 1,000 2027 1,000 2028 1,000	Komuna, Donacione	DZHE	Monitorim dhe vlerësim i zbatimit të planit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	13.07.2026
PËR/ZA/TO:	z.Leonard Llojuni - Kryesues i Kuvendit Komunal
CC:	z.Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	znj.Leonora Shehu - Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Informatë mbi raportin e performancës së administratës së Komunës së Junikut periudhën janar-qershor 2026

Të nderuar,

Duke u bazuar në planin e punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026, përmes të cilit në muajin korrik parashihet "Informatë mbi raportin e performancës së administratës së Komunës së Junikut për periudhën janar - qershor 2026", drejtorja për Administratë të Përgjithshme, ju informon si më poshtë:

Në Drejtorinë e Administratës, në periudhën kohore janar-qershor 2026, në tre sektorët: Sektorin për Administratë të Përgjithshme, Sektorin për Gjendje Civile dhe Sektorin Pritës, Protokoll dhe Arkivë, ka pasur mbarëvajtje të mirë të punës, punë kjo e realizuar në përputhje me Statutin e Komunës, Planin e Punës, ligjet, rregulloret, udhëzimet dhe vendimet në fuqi.

Administrata gjatë kësaj periudhe ka bërë përpjekje për transparencë dhe llogaridhënie, që të jetë sa më funksionale që shërbimet ndaj qytetarëve dhe palëve të jenë sa më efikase dhe të kënaqshme.

Në Sektorin e Gjendjes Civile për këtë periudhë kohore janë lëshuar në total 2715 dokumente, 1775 për përdorim të brendshëm dhe 940 dokumente për përdorim të jashtëm, janë kryer 34 shërbime tjera si Aktivdekje, verifikime, kërkesa për fitim të shtetësisë etj.

Sektori Pritës-Protokoll ka qenë funksional dhe mjaft efikas në realizimin e lëndëve si të përfunduara, ku lëndët sipas kërkesave të qytetarëve janë vendosur me kohë dhe brenda afateve ligjore. Në total kërkesat e parashtruara duke përfshirë të gjitha drejtoritë janë 4531 kërkesa.

Pas rekomandimit të drejtorisë së Administratës, Kryetari i Komunë ka marrë vendim që në muajt korrik dhe gusht 2026, Qendra për Shërbim me qytetarë të jetë funksionale 8 orë, të punojë edhe gjatë kohës së pauzës, që qytetarët të mund të marrin shërbime. Zgjatja e orarit është bërë duke u bazuar në fluksin më të madh të qytetarëve dhe që t'u ofrohet shërbim bashkatdhetarëve.

Zyra për Arkivimin e lëndëve ka ruajtur të gjitha lëndët në mënyrë elektronike duke përdorur Sistemin për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve SMAFD. Zyra e Arkivës ka qënë mjaft funksionale, ku për këtë periudhë kohore, kemi pasur gjithsej 3288 lëndë të arkivuara me 3272 dokumente të bashkëngjitura.

Aktiviteti	Janar-Qershor 2026
Dokumente të Gjendjes Civile (gjithsej)	2,715
Për përdorim të brendshëm	1,775
Për përdorim të jashtëm	940
Shërbime të tjera	34
Kërkesa të pranuar në Protokoll	4,531
Lëndë të arkivuara	3,288
Dokumente të bashkëngjitura	3,272

SHERBIME TË TJERA: RAPORTI VJETOR I SEKTORIT TË GJENDJES CIVILE 2026

	LLOJI I DOKUMENTIT	Total
1	AKTVENDIME PËR KORIGJIM TE STATUSIT DHE EVIDENCES CIVIL NE RL RM DHE RV.	17
2	KERKESA PER FITIMIN E SHITESISE SE KOSOVES	12
3	KERKESAT E REALIZUARA PER FITIM TE SHITESISE SE KOSOVES	5
	GJITHSEJT	34

Kemi inicuar me kohë procedurat e nevojshme të prokurimit për të siguruar mbarëvajtjen e punës dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Këto procedura kanë për qëllim rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që administrata komunale ofron për qytetarët.

Në këtë kuadër, janë ndërmarrë hapat për furnizimin me material higjienik, sigurimin e libër-lidhjeve për gjendjen civile, si dhe furnizimin me material zyrtar, duke garantuar që administrata komunale të funksionojë në mënyrë të rregullt dhe transparente.

Me respekt!



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna Junik – Opština Junik – Municipality of Junik

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2026 - 2033 PËR KOMUNËN E JUNIKUT

Përmbajtja	
<u>Lista e Shkurtesave</u>	3
<u>Lista e Figurave</u>	4
<u>Lista e Tabelave</u>	4
<u>Komisioni Hartues</u>	5
<u>Fjalë Hyrëse nga Kryetari i Komunës</u>	6
I. <u>Përmbledhja Ekzekutive</u>	7
II. <u>Hyrja</u>	8
III. <u>Metodologjia</u>	9
IV. <u>Misioni</u>	10
V. <u>Vizioni</u>	11
VI. <u>Sfondi</u>	12
<u>6.1 Analiza e gjendjes aktuale</u>	13
<u>6.2 Analiza ekonomike lokale</u>	14
<u>6.2.1 Tregu i punës dhe papunësia</u>	14
<u>6.2.2 Subvencionet bujqësore</u>	15
<u>6.2.3 Struktura e bizneseve</u>	16
<u>6.2.4 Investimet kapitale</u>	18
<u>6.2.5 Mërgata</u>	19
<u>6.2.6 Përfundim i analizës ekonomike</u>	19
<u>6.3 Demografia e Komunës</u>	19
<u>6.4 Shtrirja gjeografike</u>	22
<u>6.5 Administrata</u>	23
<u>6.6 Arsimi</u>	25
<u>6.7 Infrastruktura dhe shërbimet publike</u>	25
<u>6.8 Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale</u>	29
<u>6.9 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural</u>	29
<u>6.10 Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore</u>	30
<u>6.11 Përkufizimi i problemit</u>	31

6.12	<u>Krahasimi me komunat tjera</u>	31
6.13	<u>SWOT analiza</u>	32
6.14	<u>Përmbledhja e sfidave</u>	33
VII.	<u>Objektivat</u>	34
7.1	<u>Objektiva e përgjithshme 1: Arsimi</u>	34
7.2	<u>Objektiva e përgjithshme 2: Infrastruktura</u>	35
7.3	<u>Objektiva e përgjithshme 3: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale</u>	36
7.4	<u>Objektiva e përgjithshme 4: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural</u>	37
7.5	<u>Objektiva e Përgjithshme 5: Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore</u>	38
VIII.	<u>Monitorimi dhe Raportimi</u>	40
IX.	<u>Vlerësimi i ndikimit buxhetor</u>	41
X.	<u>Plani i Veprimit</u>	42

Lista e Shkurtesave

SZHEL - Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal
 PNZHEL - Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal
 PZHK - Plani Zhvillimor Komunal
 AZHR - Agjencia për Zhvillim Rajonal
 ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
 MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
 QKMF - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
 KRU - Kompania Rajonale e Ujësjetësimit
 EF - Ekonomitë Familjare
 ARBK - Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
 MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
 BE - Bashkimi Evropian
 KAB - Korniza Afatmesme Buxhetore

Lista e Figurave

Figura 01. Pozita e Komunës së Junikut në hartën e Kosovës

Figura 02. Popullsia e punësuar dhe të papunësuar

Figura 03. Numri i bizneseve në vitin 2026

Figura 04. Numri i bizneseve të reja në vitin 2025

Figura 05. Numri i bizneseve të shuara në vitin 2025

Figura 06. Harta administrative e Komunës së Junikut

Figura 07. Organogrami i Komunës së Junikut

Lista e Tabelave

Tabela 01. Struktura e përgjithshme e bizneseve në Komunë e Junikut

Tabela 02. Popullsia e Junikut ndërvite.

Tabela 03. Popullsia në Komunën e Junikut sipas regjistrimit në vitin 2011

Tabela 04. Ekonomitë Familjare në Komunë e Junikut sipas regjistrimit në vitin 2011

Tabela 05. Popullsia në Komunën e Junikut sipas regjistrimit në vitin 2024

Tabela 06. Ekonomitë Familjare në Komunë e Junikut sipas regjistrimit në vitin 2024

Tabela 07. Grupmoshat në Komunë e Junikut sipas regjistrimit në vitin 2024

Tabela 08. Përbërja etnike e popullsisë në Komunë e Junikut në vitin 2024

Tabela 09. Përbërja sipas besimit e popullsisë në Komunë e Junikut në vitin 2024

Tabela 10. Popullsia në Komunë e Junikut nga 5 deri 29 vjeç që aktualisht vijon shkollimin sipas nivelit

Tabela 11. Numri i lindjeve në Komunë e Junikut sipas regjistrimit civil

Tabela 12. Numri i vdekjeve në Komunë e Junikut sipas regjistrimit civil

Tabela 13. Transporti publik me linjat, nr e nisjeve, distanca dhe koha e udhëtimit

Tabela 14. Analiza SWOT

Tabela 15. Vlerësimi i ndikimit buxhetor

Komisioni hartues

Komisioni për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033 është themeluar me Vendimin nr. 01/91 të Kryetarit të Komunës, z. Ruzhdi Shehu.

Komisioni ka këtë përbërje:

- Besart Tofaj – Nënkyetar i Komunës, kryesues
- Xhavit Velijaj – Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
- Zenun Shala – Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, anëtar
- Demokrat Ganiqaj – Drejtor për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
- Fatos Shala – Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtar
- Florentina Qestaj – Zyrtare për Bujqësi, anëtare
- Tafë Tofaj – Udhëheqës i Sektorit për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar
- Sindije Idrizi Maloku – Zyrtare e Lartë Ligjore, anëtare
- Fluriye Shehu – Zyrtare e Lartë për Kadastër, anëtare

Fjala Hyrëse nga Kryetari i Komunës

Të nderuar qytetarë të Komunës së Junikut!

Kemi kënaqësinë t'ju prezantoj Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026 – 2033, dokumentin kryesor që përcakton vizionin, prioritetet dhe drejtimet e zhvillimit të komunës sonë për vitet në vijim.

Kjo strategji është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës të analizës, planifikimit dhe konsultimit me institucionet, bizneset, shoqërinë civile dhe qytetarët. Ajo pasqyron përkushtimin tonë për të ndërtuar një Junik më të zhvilluar, më konkurrues dhe me mundësi më të mira për të gjithë.

Prioritetet tona janë përmirësimi i cilësisë së arsimit, avancimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale, zhvillimi i bujqësisë moderne, investimet në infrastrukturë, promovimi i turizmit malor dhe kulturor, si dhe krijimi i kushteve më të favorshme për zhvillimin e biznesit dhe punësimit.

Përmes kësaj strategjie synojmë që deri në vitin 2033 Juniku të ketë një ekonomi lokale më të fuqishme, turizëm më të zhvilluar, bujqësi më konkurruese, infrastrukturë moderne dhe një standard më të lartë jetese për qytetarët tanë. Arritja e këtyre objektivave kërkon bashkëpunimin e të gjitha institucioneve, sektorit privat, mërgatës dhe komunitetit në tërësi.

Jam i bindur se, me angazhim të përbashkët dhe me shfrytëzimin e potencialeve që posedon Juniku, do të arrijmë të ndërtojmë një të ardhme më të mirë dhe më prosperuese për gjeneratat e sotme dhe ato që vijnë.

Faleminderit për besimin dhe mbështetjen tuaj.

Ruzhdi Shehu, Kryetar

Komuna Junik

I. Përmbledhja Ekzekutive

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026 – 2033 e Komunës së Junikut paraqet dokumentin kryesor orientues për zhvillimin ekonomik dhe social të komunës, me fokus në krijimin e një ekonomie lokale konkurruese, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Strategjia synon të fuqizojë potencialet ekzistuese ekonomike, të adresojë sfidat zhvillimore dhe të krijojë kushte më të favorshme për investime, rritje të punësimit dhe përmirësim të cilësisë së jetës së qytetarëve. Dokumenti është hartuar mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale ekonomike dhe sociale të komunës, duke identifikuar sektorët me potencial më të madh zhvillimor dhe ndërhyrjet prioritare për periudhën strategjike 2026 – 2033.

Procesi i hartimit të strategjisë është bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse, duke përfshirë institucionet komunale, komunitetin e biznesit, organizatat e shoqërisë civile, sektorin akademik, partnerët institucionalë dhe qytetarët. Strategjia përcakton drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik lokal përmes promovimit të sipërmarrjes, përmirësimit të klimës së biznesit, zhvillimit të kapitalit njerëzor, avancimit të infrastrukturës dhe promovimit të sektorëve me potencial si turizmi, agrobiznesi dhe teknologjia informative dhe komunikimi (TIK). Zbatimi i saj synon të krijojë një zhvillim të balancuar territorial dhe mundësi të barabarta për të gjitha komunitetet që jetojnë dhe veprojnë në Komunën e Junikut.

Në kuadër të kësaj strategjie, Komuna e Junikut synon realizimin e këtyre objektivave të përgjithshme:

- *Përmirësimi i cilësisë së arsimit.*
- *Përmirësimi dhe zhvillimi i përgjithshëm i infrastrukturës edhe shërbimeve publike.*
- *Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe rritja e mirëqenies sociale.*
- *Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural përmes rritjes së prodhimit dhe mbështetjes së fermerëve.*
- *Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore.*

Rekomandimet kryesore të dakorduara për adresimin e problemeve ekzistuese fokusohen në përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes, rritjen e investimeve publike dhe private, zhvillimin e kapaciteteve profesionale të fuqisë punëtore dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve lokale dhe sektorit privat. Po ashtu, është identifikuar si prioritet nevoja për përmirësimin e infrastrukturës teknike dhe publike, krijimin e kushteve më të mira për sipërmarrje dhe inovacion, si dhe promovimin e potencialeve turistike dhe bujqësore të komunës.

II. Hyrja

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026 – 2033 për Komunën e Junikut paraqet një plan të strukturuar që synon forcimin e ekonomisë lokale dhe krijimin e kushteve më të mira për komunitetet që jetojnë dhe veprojnë në këtë komunë.

Hartimi i strategjisë ka përfshirë një mobilizim të gjerë të burimeve njerëzore dhe institucionale: Zyrën e Kryetarit të Komunës, komunitetin e biznesit, sektorin privat, organizatat joqeveritare, mediat, institucionet akademike dhe Qeverinë e Kosovës. Qëllimi kryesor është ndërmarraja e veprimeve konkrete për zhvillimin ekonomik lokal dhe sigurimi i financimit të nevojshëm për zbatimin e saj.

Strategjia është ndërtuar mbi disa shtylla kryesore:

- Analiza e gjendjes aktuale: Vlerësimi i pikave të forta dhe të dobëta të ekonomisë lokale, si dhe identifikimi i mundësive dhe rreziqeve që ndikojnë në zhvillim.
- Përcaktimi i objektivave: Vendosja e synimeve të qarta dhe të realizueshme, si rritja e punësimit dhe tërheqja e investimeve.
- Fushat prioritare të zhvillimit: Fokusimi në sektorë me potencial të lartë si bizneset inovative, arsimit, infrastruktura, shëndetësia, turizmi, teknologjia informative dhe komunikimi (TIK), si dhe agrobiznesi.
- Promovimi dhe marketingu: Theksimi i avantazheve konkurruese të komunës përmes marketingut të territorit dhe promovimit të produkteve e shërbimeve vendore.
- Monitorimi dhe vlerësimi: Ndjekja e progresit dhe përshtatja e strategjisë sipas ndryshimeve në mjedisin ekonomik.

Fokusi kryesor i kësaj strategjie është fuqizimi i potencialit ekonomik lokal, adresimi i dobësive ekzistuese, rritja e kapitalit njerëzor për qeverisje efikase, sigurimi i arsimit cilësor, infrastruktura moderne, mjedisi i pastër, shëndetësia dhe mirëqenia sociale, si dhe krijimi i një ambienti të përshtatshëm për zhvillimin e biznesit.

III. Metodologjia

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Junikut paraqet një kornizë të re orientuese për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunës në periudhën 2026 – 2033. Ky dokument synon të identifikojë sfidat dhe potencialet kryesore zhvillimore, duke vendosur objektiva konkrete që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe në avancimin e aktiviteteve ekonomike për të gjitha komunitetet që jetojnë dhe veprojnë në këtë zonë.

Procesi i hartimit të kësaj strategjie është inicuar me vendim të Kryetarit të Komunës, duke krijuar bazën institucionale për një qasje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka udhëhequr këtë proces në koordinim të ngushtë me një grup të gjerë akterësh, me qëllim ndërtimin e një dokumenti realist dhe të zbatueshëm që reflekton nevojat aktuale dhe perspektivat e ardhshme.

Në përgatitjen e strategjisë janë marrë në konsideratë dokumente dhe politika relevante në nivel lokal dhe qendror, përfshirë programet kombëtare për zhvillim ekonomik, strategjitë e mëparshme komunale dhe dokumentet planifikuese në proces miratimi. Kjo ka siguruar një harmonizim të objektivave lokale me prioritetet më të gjera zhvillimore.

Një rol të rëndësishëm në këtë proces ka luajtur Komisioni hartues, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve komunale, sektorit akademik, biznesit, organizatave të shoqërisë civile, institucioneve të punësimit dhe aftësimin profesional, si dhe partnerëve ndërkombëtarë dhe ekspertëve të pavarur. Përfshirja e gjerë e këtyre akterëve ka mundësuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe transparente në hartimin e strategjisë. Gjatë gjithë procesit janë organizuar takime konsultative dhe janë mbledhur komente e rekomandime nga palët e interesit, veçanërisht nga komuniteti i biznesit, të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në përmbajtjen dhe cilësinë e dokumentit përfundimtar. Strategjia përfshin përcaktimin e vizionit dhe misionit zhvillimor të komunës, objektivat strategjike, si dhe një plan të detajuar veprimi që mundëson zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e progresit në mënyrë të vazhdueshme.

Objektivat strategjike të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026 – 2033 janë hartuar në përputhje me Programin Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030, Planin Zhvillimor Komunal dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), duke reflektuar prioritetet zhvillimore të Komunës së Junikut.

Synimi themelor i këtij dokumenti është rritja e kapaciteteve ekonomike të Komunës së Junikut përmes krijimit të një mjedisi më të favorshëm për investime, zhvillim të biznesit dhe punësim. Në të njëjtën kohë, strategjia synon të garantojë zhvillim të balancuar dhe përfshirës për të gjitha komunitetet, duke u mbështetur në bashkëpunim të vazhdueshëm dhe dialog me qytetarët dhe akterët relevantë.

IV. Misioni

Misioni i Komunës së Junikut në kuadër të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal është të krijojë një mjedis të qëndrueshëm dhe konkurrues për zhvillim ekonomik. Ky mision fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës, nxitjen e investimeve dhe zhvillimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore, me qëllim avancimin e sektorëve kryesorë të ekonomisë lokale.

Komuna angazhohet të mbështesë bizneset ekzistuese dhe të inkurajojë ndërmarrjet e reja, duke krijuar mundësi më të mira për punësim dhe zhvillim profesional. Po ashtu, synohet të tërhiqen investime të reja dhe të përmirësohet cilësia e jetës për të gjithë qytetarët.

Përmes këtij misioni, Komuna e Junikut aspiron të ndërtojë një ambient të favorshëm për rritje ekonomike dhe mirëqenie sociale, duke shfrytëzuar në mënyrë efikase resurset lokale, duke nxitur inovacionin dhe sipërmarrjen, si dhe duke garantuar kushte të mira për jetesë dhe punë për të gjitha komunitetet.

V. Vizioni

Vizioni për Komunën e Junikut (PZHK)

“Juniku, Park etnografik, vend i traditës, që ruan, zhvillon dhe promovon vlerat e tij njerëzore, kulturore, historike dhe natyrore; me arsimim cilësor dhe mirëqenie sociale; me turizëm, bujqësi (agroindustri) dhe infrastrukturë të zhvilluar; mjedis të pastër, të qëndrueshëm dhe të sigurtë për të gjithë”.

Ky vizion pasqyron aspiratën afatgjatë të Komunës së Junikut për t’u shndërruar në një qendër të zhvillimit të qëndrueshëm lokal, e cila mbështetet në potencialet e saj natyrore, njerëzore dhe ekonomike. Në fokus është krijimi i një ekonomie të diversifikuar dhe konkurruese, e aftë të gjenerojë vende të reja pune, të rrisë të ardhurat lokale dhe të përmirësojë standardin e jetesës së qytetarëve.

Komuna synon të krijojë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e biznesit dhe tërheqjen e investimeve vendore dhe të huaja, përmes përmirësimit të infrastrukturës, lehtësimit të procedurave administrative dhe mbështetjes së ndërmarrjeve ekzistuese, si dhe nxitjes së krijimit të ndërmarrjeve të reja. Vëmendje e veçantë do t’i kushtohet promovimit të sipërmarrjes, inovacionit dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor, veçanërisht të të rinjve dhe grave, me qëllim krijimin e një fuqie punëtore të përgatitur dhe konkurruese në tregun e punës.

Një komponent i rëndësishëm i këtij vizioni është zhvillimi i sektorëve me potencial të lartë ekonomik, si turizmi malor dhe kulturor, agrobiznesi, teknologjia informative dhe e komunikimit, prodhimi vendor dhe shërbimet mbështetëse. Duke shfrytëzuar resurset natyrore, pozitën e favorshme gjeografike dhe trashëgiminë e pasur historike e kulturore, Juniku synon të afirmohet si një destinacion atraktiv për investime, turizëm dhe zhvillim ekonomik rajonal.

Në të njëjtën kohë, vizioni i Komunës së Junikut përfshin krijimin e një mjedisi të pastër, të sigurt dhe funksional për jetesë, përmes investimeve në infrastrukturë moderne, ofrimit të shërbimeve publike cilësore, mbrojtjes së mjedisit dhe planifikimit të qëndrueshëm hapësinor. Përmirësimi i arsimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe përfshirjes së komuniteteve mbetet pjesë thelbësore e këtij zhvillimi.

Përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve lokale, sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile, mërgatës dhe partnerëve zhvillimorë, Komuna e Junikut synon të ndërtojë një model të zhvillimit lokal që garanton stabilitet ekonomik, përfshirje sociale dhe ruajtjen e identitetit kulturor, duke krijuar një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët.

VI. Sfondi

Sfondi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026 – 2033 për Komunën e Junikut përbën një element thelbësor të procesit të hartimit, pasi ofron kontekstin e përgjithshëm dhe bazën analitike mbi të cilën ndërtohen prioritetet dhe ndërhyrjet strategjike. Ky kapitull synon të paraqesë në mënyrë të qartë gjendjen aktuale, sfidat dhe mundësitë zhvillimore, duke krijuar një bazë të fortë për vendimmarrje të qëndrueshme dhe efektive.

Përmes këtij seksioni sigurohet një kuptim i plotë i realitetit ekonomik dhe social të komunës, duke shërbyer si udhërrëfyes për përcaktimin e objektivave konkrete dhe masave zhvillimore. Një analizë e detajuar e këtyre elementeve mundëson që strategjia të jetë realiste, e zbatueshme dhe e harmonizuar me nevojat lokale.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026 – 2033 është e harmonizuar me politikat dhe dokumentet relevante në nivel kombëtar, përfshirë Programin Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030, duke siguruar një qasje të integruar dhe koherente në planifikimin zhvillimor. Ky dokument do të shërbejë si një udhërrëfyes afatmesëm për zhvillimin ekonomik të Komunës së Junikut, duke synuar rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe forcimin e kapaciteteve ekonomike lokale.

Fushat kryesore të ndërhyrjes janë përcaktuar në përputhje me prioritetet institucionale dhe udhëzimet nga niveli qendror, duke përfshirë:

- Arsimin: ngritja e cilësisë dhe përmirësimi i kapaciteteve edukative
- Infrastrukturën: përmirësimi i kushteve të jetesës përmes investimeve në rrugë, kanalizim dhe ndriçim publik
- Shëndetësinë dhe mirëqenien sociale: avancimi i shërbimeve dhe mbrojtja e shëndetit publik
- Bujqësinë dhe zhvillimin rural: mbështetja e prodhimit bujqësor, fermave dhe mbrojtja e mjedisit
- Turizmin dhe trashëgiminë kulturore: zhvillimi i potencialit turistik dhe promovimi i vlerave lokale

Në tërësi, sfondi i strategjisë paraqet një analizë të thelluar të të gjithë faktorëve relevantë, duke krijuar një pasqyrë të qartë mbi gjendjen aktuale dhe drejtimin që duhet ndjekur për realizimin e objektivave të zhvillimit ekonomik lokal në Komunën e Junikut.

6.1 Analiza e gjendjes aktuale

Në vitet pas luftës, Komuna e Junikut ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të forcuar bazën e saj ekonomike. Janë arritur përparime të dukshme në zhvillimin e rrjetit rrugor, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, duke lehtësuar qarkullimin dhe lidhjen ndërmjet vendbanimeve.

Gjithashtu, janë realizuar investime të rëndësishme në ndërtimin dhe zgjerimin e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, duke përmirësuar ndjeshëm kushtet e jetesës për qytetarët. Në sektorin e arsimit, është punuar në zgjerimin e kapaciteteve shkollore dhe në pajisjen e tyre me inventar modern, duke krijuar kushte më të mira për nxënësit dhe stafin arsimor.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe përmirësimit të hapësirave publike dhe mjedisit, përfshirë rregullimin e parqeve, ndërtimin e fushave sportive, trotuareve dhe parkingjeve, si dhe zgjerimin e ndriçimit publik në të gjithë territorin e komunës. Këto investime kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së jetesës dhe në krijimin e një ambienti më të përshtatshëm për qytetarët.

Një nga prioritetet kryesore mbetet krijimi i kushteve të favorshme për tërheqjen e investimeve dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Në këtë drejtim, bashkëpunimi ndërmjet nivelit lokal dhe institucioneve qendrore është thelbësor, duke synuar që investimet private dhe ato të huaja të jenë shtytës kryesorë të rritjes ekonomike.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve, Komuna e Junikut synon të krijojë një mjedis më tërheqës për investitorët përmes zhvillimit të zonës ekonomike dhe përmirësimit të infrastrukturës mbështetëse. Këto iniciativa përfshijnë edhe përgatitjen e analizave dhe studimeve të nevojshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe efikas.



Figura 01. Pozita e Komunës së Junikut në hartën e Kosovës

6.2 Analiza ekonomike lokale

Analiza ekonomike e Komunës së Junikut paraqet një pasqyrë të përgjithshme të strukturës së tregut të punës, aktiviteteve ekonomike, investimeve kapitale, mbështetjes së sektorit të bujqësisë dhe ndikimit të mërgatës në zhvillimin e ekonomisë lokale. Kjo analizë bazohet në të dhëna zyrtare nga institucionet relevante dhe shërben si bazë për përcaktimin e prioriteteve zhvillimore të komunës për periudhën 2026 – 2033.

Aktualisht, ekonomia e Komunës së Junikut përballet me mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar në disa sektorë, ndërsa qasja në fondet publike dhe programet mbështetëse vazhdon të karakterizohet nga procedura të ndërlikuara administrative, të cilat vështirësojnë shfrytëzimin e tyre nga bizneset dhe fermerët.

6.2.1 Tregu i punës dhe papunësia

Tregu i punës në Komunën e Junikut karakterizohet me nivel të kufizuar të punësimit në sektorin privat dhe varësi të konsiderueshme nga sektori publik dhe aktivitetet bujqësore familjare. Struktura e punësimit në Kosovë dhe rajon tregon se pjesa më e madhe e fuqisë punëtore është e angazhuar në sektorin e shërbimeve, ndërsa niveli i papunësisë mbetet sfidë zhvillimore.

Sipas të dhënave të vlerësimit të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, emigrimi vazhdon të ketë ndikim të konsiderueshëm në ndryshimet demografike dhe fuqinë punëtore në Kosovë, duke ndikuar veçanërisht komunat me potencial të kufizuar ekonomik dhe mundësi të reduktuara punësimi, dhe se papunësia mbetet në nivel të lartë, veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë.

Sipas të dhënave të vlerësimit të popullsisë për vitin 2024, Komuna e Junikut ka pasur një popullsi të vlerësuar prej 3,940 banorësh më 31 dhjetor 2024. Gjatë atij viti, janë regjistruar 45 raste të imigrimit ndërkombëtar dhe 90 raste të emigrimit ndërkombëtar, duke rezultuar me një bilanc negativ prej -45 banorësh në migrimin ndërkombëtar. Në aspektin e migrimit të brendshëm (kombëtar), janë regjistruar 22 raste të imigrimit dhe 21 raste të emigrimit, duke rezultuar me një bilanc pozitiv minimal prej +1 banori. Në përgjithësi, bilanci total i migrimit në Komunën e Junikut për vitin 2024 është negativ (-44), çka tregon se numri i personave që janë larguar nga komuna ka qenë më i madh sesa numri i atyre që janë vendosur në të.

Si rezultat, popullsia e vlerësuar në fund të vitit 2024 ka arritur në 3,895 banorë.

Shkalla e papunësisë në vitin 2024 në Kosovë ishte 10.08.

Indikatorët kryesorë të tregut të punës 2024 / 2023

Indikatorët kryesorë të tregut të punës (NË MIJËRA)	2024			2023		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Fuqia punëtore (persona aktive) (15-64 vjeç)	325425	139142	464567	333019	144331	477350
Persona joaktive (15-64 vjeç)	211849	398288	610137	243270	451143	694413
Të punësuar (15-64 vjeç)	300353	114140	414493	307509	117990	425499
Të papunësuar (15-64 vjeç)	25072	25002	50074	25510	26340	51850
Të rinj të papunë (15-24 vjeç)	6780	5377	12157	6051	4945	10996
Të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET)	40869	40366	81235	48369	47824	96193
Punësimi i paqëndrueshëm (15-64 vjeç)	51699	8431	60130	55570	9671	65241
Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)						
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (15-64 vjeç)	60.6	25.9	43.2	57.8	24.2	40.7
Shkalla e joaktivitetit (15-64 vjeç)	39.4	74.1	56.8	42.2	75.8	59.3
Raporti punësimi ndaj popullsisë (shkalla e punësimit) (15-64 vjeç)	55.9	21.2	38.6	53.4	19.8	36.3
Shkalla e papunësisë (15-64 vjeç)	7.7	18.0	10.8	7.7	18.2	10.9
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	16.7	24.7	19.5	14.4	22.8	17.3
Pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullsinë e re (15-24 vjeç)	30.6	32.2	31.4	32.9	33.9	33.4
Pjesëmarrja e punësimit të paqëndrueshëm në punësimin e përgjithshëm (15-64 vjeç)	17.2	7.4	14.5	18.1	8.2	15.3

Figura 02 . Popullsia e e punësuar dhe të papunësuar në Kosovë në vitin 2023 - 2024

Struktura e përgjithshme e punësimit në Kosovë e paraqet sektorin e shërbimeve në nivel dominues, industrinë në nivel mesatar dhe bujqësinë në nivel të ulët.

Paga mesatare neto në Kosovë gjatë vitit 2024, sipas Agjencisë së statistikave të Kosovës është 552 € neto, në sektorin publik 668 € neto, në sektorin privat 513 € neto, dhe në ndërmarrjet Publike 685 € neto.

6.2.2 Subvencionet bujqësore

Sektori i bujqësisë përbën një nga shtyllat kryesore të ekonomisë lokale në Junik. Një pjesë e konsiderueshme e familjeve janë të angazhuara në aktivitete bujqësore dhe blegtorale.

Mbështetja për fermerët realizohet përmes programeve të subvencionimit nga Komuna e Junikut, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e Kosovës, Organizata të huaja, të cilat përfshijnë:

- pagesa direkte për kultura bujqësore
- subvencione për blegtorinë
- mbështetje për bletarinë
- grante për investime në ferma

Këto masa kanë ndikuar në ruajtjen e aktivitetit bujqësor, megjithatë nevojitet rritje e investimeve në mekanizim bujqësor si dhe përpunim të produkteve.

6.2.3 Struktura e bizneseve

Ekonomia lokale e Junikut karakterizohet nga një numër i kufizuar i bizneseve aktive, ku dominon sektori i shërbimeve dhe tregtisë së vogël.

Aktivitetet prodhuese janë të pakta dhe me kapacitet të ulët.

Sipas të dhënave nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës në vitin 2026 kemi 115 biznese aktive në Komunë e Junikut, më poshtë gjeni numrin e bizneseve sipas sektorëve.



Figura 03. Numri i bizneseve në vitin 2026 (Qershor)

Gjithsej janë 115 biznese aktive. Përqindjet sipas sektorëve janë:

- Ndërtimtaria – 20.9%
- Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave – 20.0%
- Hoteleria dhe akomodimi – 15.7%
- Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi – 13.0%
- Aktivitetet shërbyese dhe të përkrahjes – 8.7%
- Industria përpunuese – 7.8%
- Aktivitetet tjera shërbyese – 5.2%
- Transporti dhe magazinimi – 3.5%
- Informimi dhe komunikimi – 2.6%
- Aktivitetet e shëndetit njerezor dhe të punës sociale – 2.6%

Sipas të dhënave nga ARBK në vitin 2025 kemi 18 biznese të regjistruara në Komunën e Junikut.



Figura 04. Numri i bizneseve të reja në vitin 2025

Sipas grafikut, përqindja e bizneseve sipas sektorëve është:

- Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave – 33.3%
- Ndërtimtaria – 11.1%
- Aktivitetet shërbyese dhe të përkrahjes – 11.1%
- Aktivitetet tjera shërbyese – 11.1%
- Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi – 5.6%
- Industria përpunuese – 5.6%
- Hoteleria dhe akomodimi – 5.6%
- Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike – 5.6%
- Arsimi – 5.6%
- Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe të punës sociale – 5.6%

Sipas të dhënave nga ARBK në vitin 2025 kemi 1 biznes të shuar në Komunën e Junikut.



Figura 05. Numri i bizneseve të shuara në vitin 2025

6.2.4 Investimet kapitale

Investimet publike në Komunën e Junikut kanë kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës bazë duke përfshirë rrugët lokale dhe regionale, sistemin e ujësjellësit, kanalizimit, ujitjes, ndriçimin publik, objektet arsimore, shëndetësore dhe administrativ.

Buxheti komunal dhe investimet kapitale janë të financuara nga:

- të hyrat vetanake komunale
- grantet qeveritare
- Donatorë KFOR, EU, ambasadat dhe organizata të huaja
- granti i përformancës komunale

Buxheti 2026 dhe projeksionet për vitet 2027, 2028 dhe 2029

Burimet e te hyrave	Buxheti 2026	2027	2028	2029
		Projeksionet		
Gjithsej grantet ndërqeveritare	2,343,311	2,345,879	2,276,299	2,388,486
Gjithsej të hyrat vetanake të komunës	195,301	193,595	197,403	202,589
Të hyrat nga shërbimet kadastrale	13,500	10,134	10,278	10,546
Të hyrat nga urbanizmi	10,000	10,000	10,500	11,000
Të hyrat nga administrata	6,300	6,000	6,200	6,400
Të hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	10,500	0.00	0.00	0.00
Të hyrat nga tatimi në pronë	102,727	110,175	111,277	111,833
Të hyrat nga tatimi në tokë	26,724	32,336	32,498	32,660
Regjistrimi i Automjeteve	9,500	9,100	9,300	10,000
Të hyrat nga shëndetësia	6,000	6,100	6,200	6,300
Të hyrat nga shërbimet e inspektimit	5,000	3,100	3,300	3,500
Të hyrat tjera	5,050	6,650	7,850	10,350
Totali	2,538,612	2,539,474	2,473,702	2,591,075

Tabela 01. Buxheti 2026 dhe projeksionet për vitet 2027, 2028 dhe 2029

Në përgjithësi, investimet kapitale përbëjnë një pjesë të rëndësishme të zhvillimit lokal, por mbeten të kufizuara në raport me nevojat reale të komunës.

6.2.5 Mërgata

Mërgata paraqet një faktor të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Komunës së Junikut përmes remitencave dhe investimeve në sektorë të ndryshëm ekonomikë. Një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të Junikut jetojnë dhe veprojnë kryesisht në Gjermani, Zvicër, Austri, Francë, Belgjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe etj.

Kontributi i mërgatës reflektohet në investime në objekte banesore dhe afariste, mbështetje të bizneseve familjare, zhvillimin e kapaciteteve turistike dhe rritjen e konsumit lokal, veçanërisht gjatë sezonit veror. Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, remitencat gjatë vitit 2025 kanë arritur vlerën prej rreth 1.4 miliardë euro, duke mbetur një burim i rëndësishëm i të ardhurave për ekonominë familjare dhe zhvillimin ekonomik në vend.

Përveç remitencave, Mërgata paraqet potencial të rëndësishëm investues në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe agropërpunimit, gastronomisë, energjisë së ripërtëritshme dhe shërbimeve digjitale. Komuna e Junikut synon të forcojë bashkëpunimin me diasporën përmes promovimit të mundësive investuese, mbështetjes së iniciativave zhvillimore dhe përfshirjes së saj në projektet strategjike të zhvillimit lokal.

6.2.6 Përfundim i analizës ekonomike

Ekonomia e Komunës së Junikut karakterizohet nga një strukturë e brishtë, e bazuar kryesisht në bujqësi dhe shërbime të vogla, me nivel të kufizuar të industrisë dhe investimeve private. Megjithatë, ekziston potencial i konsiderueshëm për zhvillim në sektorët e turizmit, agrobiznesit dhe shërbimeve, i cili mund të shfrytëzohet përmes politikave të synuara zhvillimore dhe përmirësimit të klimës së investimeve.

6.3 Demografia e Komunës

Komuna e Junikut karakterizohet me një strukturë demografike relativisht të vogël dhe homogjene, ku shumicën absolute të popullsisë e përbëjnë shqiptarët. Për shkak të pozitës gjeografike dhe madhësisë së saj territoriale, Juniku nuk ka pasur një përzierje të madhe etnike në krahasim me disa komuna të tjera të Kosovës.

Popullsia në Komunën e Junikut nga viti 1948 deri në vitin 1991

Viti	1948	1953	1961	1971	1981	1991
Vendbanimi						
Junik	2391	2439	3024	3445	4553	5490
Jasiq	231	376	190	251	295	306
Gjocaj	210	180	138	161	215	306

Gjithsej	2832	2986	3352	3857	5063	6102
Ekonomitë familjare						
Junik	378	385	462	460	541	690
Jasiq	27	56	24	29	30	33
Gjocaj	34	24	18	25	24	40

Tabela 02. Popullsia e Junikut ndërvite.

Pas luftës në Kosovë, ashtu si në shumë zona të tjera, është vërejtur një lëvizje e popullsisë drejt qendrave urbane dhe jashtë vendit, e cila ka ndikuar në ndryshime demografike dhe në zvogëlim të aktivitetit në zonat rurale. Megjithatë, Juniku ka ruajtur një pjesë të konsiderueshme të popullsisë rezidente dhe lidhjen e fortë me vendbanimet tradicionale.

Popullsia në Komunën e Junikut sipas regjistrimit në vitin 2011

Vendbanimi	Meshkuj	Femra	Nr i Banorve
Junik	2979	3074	6053
Jasiq	0	0	0
Gjocaj	16	15	31
Gjithsejt	2995	3089	6084

Tabela 03. Popullsia në Komunën e Junikut në vitin 2011

Ekonomitë Familjare në Komunë e Junikut sipas regjistrimit në vitin 2011

Ekonomitë Familjare	766
---------------------	-----

Tabela 04. Ekonomitë familjare në Komunën e Junikut në vitin 2011

Numri i popullsisë rezidente në Kosovë të regjistruar në vitin 2024 është 1 602 515, prej tyre 50.2% janë meshkuj dhe 49.8% femra, mosha mesatare e popullsisë është 34.84 vjeç, ndërsa dendësia e popullsisë në 1 km² është 146.9 banorë.

Popullsia në Komunën e Junikut sipas regjistrimit në vitin 2024

Vendbanimi	Meshkuj	Femra	Nr i Banorve
Junik	1977	1966	3925
Jasiq	0	0	0
Gjocaj	9	9	18
Gjithsej	1968	1957	3943

Tabela 05. Popullsia në Komunën e Junikut në vitin 2024

Të dhënat konfirmojnë një rënie prej rreth 35% krahasuar me vitin 2011, ku Juniku numëronte 6,084 banorë.

Ekonomitë Familjare në Komunë e Junikut sipas regjistrimit në vitin 2024

Ekonomitë Familjare	895
---------------------	-----

Tabela 06. Ekonomitë familjare në Komunën e Junikut në vitin 2024

Grupmoshat në Komunë e Junikut sipas regjistrimit në vitin 2024

<u>0-4</u>	<u>5-9</u>	<u>10-14</u>	<u>15-19</u>	<u>20-24</u>	<u>25-29</u>	<u>30-34</u>	<u>35-39</u>	<u>40-44</u>	<u>45-49</u>
178	207	292	311	300	250	238	221	276	334
<u>50-55</u>	<u>56-59</u>	<u>60-64</u>	<u>65-69</u>	<u>70-74</u>	<u>75-79</u>	<u>80-84</u>	<u>85+</u>		
302	282	217	192	142	89	70	42		

Tabela 07. Grupmoshat në Komunën e Junikut në vitin 2024

Mosha mesatare e popullsisë në Komunën e Junikut në vitin 2024 është 38.6 vjeç.

Përbërja etike e popullsisë në Komunë e Junikut sipas regjistrimit në vitin 2024

Shqiptar	Serb	Boshnjak	Preferon të mos përgjigjet	Gjithsej
3938	1	1	3	3943

Tabela 08. Përbërja etnike në Komunën e Junikut në vitin 2024

Përbërja sipas besimit e popullsisë në Komunë e Junikut sipas regjistrimit në vitin 2024

Islam	Katolik	Të tjerë	Asnjë besim fetar	Preferon të mos përgjigjet	Gjithsej
3842	1	10	2	88	3943

Tabela 09. Përbërja e popullsisë sipas besimit në Komunën e Junikut në vitin 2024

Popullsia në Komunë e Junikut nga 5 deri 29 vjeç që aktualisht vijon shkollimin

Parashkollor	Shkolla fillore (1-5)	E mesme e ulë (6-9)	E mesme e lartë (10-13)	Niveli Bachelor	Niveli Master	Gjithsej
10	233	244	164	139	23	813

Tabela 10. Popullsia në Komunën e Junikut që vijon shkollimin nga mosha 5 – 29 vjeç

Numri i lindjeve në Komunë e Junikut sipas regjistrimit civil

Lindjet 2024	
E rregullt	
Brenda Vendit	Jashtë vendit
0	23
Me vonesë	
Brenda Vendit	Jashtë vendit
0	33

Tabela 11. Numri i lindjeve në Komunën e Junikut në vitin 2024

Numri i vdekjeve në Komunë e Junikut sipas regjistrimit civil

Vdekjet 2024	
E rregullt	
Brenda Vendit	Jashtë vendit
16	4
Me vonesë	
Brenda Vendit	Jashtë vendit
17	10

Tabela 12. Numri i vdekjeve në Komunën e Junikut në vitin 2024

Komuna e Junikut në regjistrimin e vitit 2024 paraqitet si një komunë e vogël, me strukturë të qëndrueshme demografike dhe potencial zhvillimor në sektorët ruralë dhe turistikë.

6.4 Shtrirja gjeografike

Pozita gjeografike e Junikut është e veçantë, pasi ndodhet në rajonin jugperëndimor të vendit, afër kufirit me dy shtete: Shqipërinë dhe Malin e Zi, duke krijuar mundësi për zhvillim ndërkufitar dhe bashkëpunim me komunat fqinje dhe shtetin shqiptar.

Ajo ka një sipërfaqe prej rreth 77.77 km² dhe shtrihet në gjerësi gjeografike prej 42°22' dhe gjatësi gjeografike prej 20°26', duke përfshirë një territor malor dhe rural, i cili është i pasur me resurse natyrore të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë, pylltarisë dhe turizmit malor.

Komuna e Junikut ka lidhje të drejtpërdrejta me komunat fqinje, të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të rajonit. Komunat fqinje janë Komuna e Deçanit në perëndim dhe Komuna e Gjakovës në jugperëndim.

Maja më e lartë në Republikën e Kosovës është Gjeravica, me 2656 metra lartësi mbidetare.

Në Komunën e Junikut gjenden Liqeni i Madh me sipërfaqe rreth 20,294 m², Liqeni i Vogel rreth 2,692 m², Liqeni i Tropojës rreth 3,331 m² dhe Liqeni i Zemrës me sipërfaqe rreth 14928.4 m².

Gjithashtu, në Komunën e Junikut gjenden Lumi Erenik dhe Lumi i Qetë. Lumi Erenik buron në Bjeshkët e Junikut dhe kalon përmes dy fshatrave, Gjocaj dhe Jasiq, pas së cilës vazhdon rrjedhën dhe derdhet në Drinin e Bardhë.




Figura 06. Harta administrative e Komunës së Junikut

Komuna e Junikut është pjesë e Rajonit të Pejës.

6.5 Administrata

Komuna e Junikut funksionon si njësi bazë e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, duke ushtruar kompetencat e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi. Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohen përmes Statutit të Komunës, i cili përbën aktin më të lartë juridik në nivel lokal. Statuti përcakton strukturën organizative, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të institucioneve komunale, me qëllim sigurimin e një administrimi efikas, transparent dhe në shërbim të qytetarëve.

Organet kryesore të komunës janë: Kuvendi i Komunës, si organi më i lartë vendimmarrës, i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët për një mandat katërvjeçar.

Kryetari i Komunës, si organi më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur gjithashtu drejtpërdrejt nga qytetarët.

Kuvendi i Komunës ka rol qendror në miratimin e politikave dhe dokumenteve strategjike lokale, ndërsa Kryetari është përgjegjës për zbatimin e tyre dhe për menaxhimin e përgjithshëm të administratës komunale. Ky organizim institucional synon të sigurojë qeverisje efikase, transparente dhe të orientuar drejt qytetarëve, duke krijuar bazë të qëndrueshme për zhvillim ekonomik dhe social në Komunën e Junikut.

Sipas Statutit të Komunës, Juniku ka shtatë drejtori kryesore:

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis

Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim

Përveç drejtorive, në kuadër të administratës komunale funksionojnë edhe njësi dhe zyra mbështetëse që kontribuojnë në rritjen e efikasitetit dhe transparencës

institucionale. Ato përfshijnë: Njësinë për Personel, Njësinë për Barazi Gjinore, Njësinë e Auditimit të Brendshëm, Zyrën Ligjore, Zyrën e Informimit, Zyrën për Integritet Evropian, Zyrën e Prokurimit, si dhe Zyrën për Komunitete dhe Kthim.




Figura 07. Organogrami i Komunës së Junikut

Për vitin 2026, Komuna e Junikut ka të miratuara gjithsej 199 pozita të stafit. Nga to, 66 janë në administratën komunale, 15 në Kuvendin Komunal, 76 në sektorin e arsimit (11 në arsimin parashkollor, 47 në arsimin fillor dhe 18 në arsimin e mesëm) dhe 42 në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare. Në total, numri i pozitave të miratuara të stafit është 199.

6.6 Arsimi

Procesi edukativo-arsimor në Komunën e Junikut zhvillohet në nivelet: parashkollor (3-5 vjeç), parafillor (5-6 vjeç), përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta, fillor (klasat 1-5), shkolla e mesme e ulët (6-9) dhe arsimi i mesëm i lartë (10-12).

Normativa në raport nxënës-mësimdhënës është: Gjimnazi “Kuvendi i Junikut” – 1 Mësimdhënës për rreth 12 nxënës, Shkolla Filllore “Edmond Hoxha” - 1 Mësimdhënës për rreth 11 nxënës

SHML – Gjimnazi “Kuvendi i Junikut” në Junik është i organizuar në tri drejtime: Drejtimi i Shkencave Natyrore, Drejtimi i Shkencave Shqiptare-Gjuhësore dhe Drejtimi i Mjekësisë së Përgjithshme, paralele e ndarë e Shkollës së Mesme të Mjekësisë “Hysni Zajmi” në Gjakovë. Gjatë vitit shkollor 2025-2026 kanë vijuar mësimin 156 nxënës.

Në SHFMU “Edmond Hoxha”, infrastruktura shkollore ekziston në gjendje të mirë, duke pasur parasysh se objekti i ri me sipërfaqe rreth 4,000 m² është përfunduar në dhjetor të vitit 2023. Gjatë vitit shkollor 2025-2026 kanë vijuar mësimin 400 nxënës dhe 20 fëmijë në nivelin parafillor. Shkolla është pajisur me kabinete të fizikës, kimisë dhe biologjisë, ndërsa salla e sportit është pajisur me mjete dhe pajisje për veprimtari sportive.

Ndërsa objekti nr. 2 i SHFMU-së është adaptuar në objekt për Institucionin Parashkollor dhe është përfunduar në vitin 2025. Nga shtatori i vitit 2025 ku janë regjistruar 47 fëmijë të moshës 2-5 vjeç.

Objekti i vjetër nr. 1 i shkollës është nën mbrojtje të përkohshme si trashëgimi kulturore dhe i njëjti planifikohet që të ridestinohet në një objekt multifunksional.

6.7 Infrastruktura dhe shërbimet publike

Infrastruktura dhe shërbimet publike në Komunën e Junikut përfshijnë administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës publike, furnizimin me ujë, menaxhimin e mbeturinave, kanalizimin, ndriçimin publik, transportin publik, si dhe shërbime të tjera komunale në funksion të qytetarëve dhe bizneseve lokale.

Qasja në Junik arrihet nëpërmjet këtyre rrugëve kryesore:

- Lidhja me rrugën regjionale Pejë - Gjakovë, rrugë regjionale 5,5 km (deri në Rastavicë)
- Lidhja me Gjakovë/Shqipëri nëpër Ponoshec, 2,3 km në territor të Junikut
- Lidhja me Gjakovë nëpër Dobrosh, rrugë komunale, 3,5 km në territor të Junikut
- Lidhja me Gjakovë nëpër Nivokaz, rrugë komunale, 3,2 km në territor të Junikut
- Lidhja me Gjakovë nëpër Pacaj, rrugë komunale, 4,6 km në territor të Junikut
- Lidhja me Gjakovë nëpër Hereq, rrugë komunale, 3,8 km në territor të Junikut
- Lidhja me Deçan nëpër Voksh, rrugë regjionale, 2 km në territor të Junikut)
- Lidhja me Deçan nëpër Prelep dhe Drenoc, rrugë komunale, 1,2 km në territor të Junikut

Të gjitha lidhjet janë në gjendje të mirë dhe shërbejnë për nevojat e transportit aktual. Gjatësia e rrugëve të asfaltuara që përshkojnë Komunën e Junikut është rreth 26.1 km, prej tyre rrugë regjionale 7.5 km, dhe rrugë komunale 18.6 km pra në total 26.1 km. 26.1 km pjesëtuar me $77.77 \text{ km}^2 = 0.34 \text{ km}$ rrugë për çdo km^2 të sipërfaqes së komunës. Gjatësia e rrugëve fushore (dheu dhe zhavori) është rreth 15 km, me pronësi publike dhe private (sezonale).

Furnizimi me energji elektrike në komunën e Junikut vazhdon të përballet me sfida, kryesisht për shkak të rrjetit energjetik të vjetruar dhe mbingarkesës së kapaciteteve ekzistuese. Shërbimi i furnizimit me rrymë kryhet nga Korporata Elektroenergjitike e Kosovës (KEK). Sipas një informacioni të marrë nga KEDS, Divizioni i Rrjetit, Distrikti Pejë, dalja 10 kV e Junikut për momentin furnizohet nga linja TS 100/10 kV që vjen nga Lluka e Epërme në Deçan e cila furnizon qytezën e Junikut, Gjocajt dhe Jasiqin. Në aspektin energjetik kjo dalje 10 kV bën pjesë në daljet më të mbi ngarkuara dhe gjendja teknike e saj është e paqëndrueshme.

Ne rrjetin e radio televizionit dhe internetit operojnë dhe funksionojnë disa operatore si : PTK, IPKO, KUJTESA, dhe TELKOS. Rrjeti 3G, 4G dhe 5G funksionon ne pjesën me te madhe te komunës se Junikut. Nga të dhënat e PTK, Telkos dhe Ipko, aktualisht në komunën e Junikut ka rreth 1000 kycje në rrjetin e telefonisë dhe internetit. Sfidë mbetet mos mbulueshmëria me vale telefonike në Bjeshkët e Junikut.

Rrjeti i ujërave të zeza është në gjendje relativisht të mirë . Ky rrjet e mbulon një pjesë të madhe në territorin e banuar të komunës. Rrjeti i kanalizimit në disa lagje te Junikut por edhe ne fshatrat Gjocaj dhe Jasiq nuk ekziston dhe derdhja e ujërave të zeza nga familjet që jetojnë atje bëhet në natyrë.

Rrjeti i ujësjellësit është në gjendje mesatarisht të mirë. Ka mjaft burime të pastërta ujore të cilat momentalisht shfrytëzohen dhe 97% e banorëve furnizohet me ujë të pijes një nga ujësjellësi. Në vendbanimet Jasiq dhe Gjocaj rrjeti i ujësjellësit nuk është i organizuar, por ato furnizohen me ujë nga burimet natyrore që vjen me rënie të lirë. Rrjeti ka afërsisht 15 km tuba të ujit në gjendje të mirë dhe 1.4 km në gjendje më të dobët.

Transporti publik në Komunën e Junikut organizohet nga kompani private që operojnë në linja të ndryshme ndërurbane.

Transporti publik me linjat, nr e nisjeve, distanca dhe koha e udhëtimit.

Lidhja	Numri i nisjeve	Distanca km	Koha e udhëtimit
Junik-Deçan-Pejë-Prishtinë	13	110	20 / 35 / 120
Junik-Deçan-Pejë	9	12,5 / 28,0	20 / 35
Junik-Batushë-Gjakovë	9	2 / 25,5	20 / 40
Junik-Rastavicë-Gjakovë	3	5.5 / 22,5	15 / 45
Junik-Gjakovë përmes shërbimeve të Deçanit dhe lidhjes në linjën kryesore rrugore	22	23	40

Tabela 13. Transporti publik në Komunën e Junikut sipas linjave, numrit të nisjeve, distancës dhe kohës së udhëtimit

Transporti hekurudhor, në territorin e Komunës së Junikut nuk kalon asnjë linjë hekurudhore, ndërsa stacionet më të afërta hekurudhore ndodhen në Pejë dhe Klinë. Në të ardhmen është paraparë zhvillimi i një lidhjeje hekurudhore në drejtimin Gjakovë-Deçan-Pejë, e cila do të kalojë paralelisht me rrugën rajonale Gjakovë-Deçan-Pejë. Realizimi i këtij projekti do të krijonte mundësi që Komuna e Junikut të lidhet me rrjetin hekurudhor në të ardhmen, duke përmirësuar qasjen dhe lidhjet rajonale.

Qasja nga ajri e Komunës së Junikut realizohet kryesisht përmes Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, i cili ndodhet rreth 100 km larg dhe arrihet përmes Pejës ose Gjakovës. Si alternativa të tjera shërbejnë Aeroporti i Kukësit në Shqipëri, i cili ndodhet rreth 80 km larg dhe paraqet një opsion më të afërt për banorët e komunës, si dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Shkupit dhe Tiranës. Ky pozicion gjeografik mundëson lidhje ajrore me qendrat kryesore të rajonit dhe Evropës, duke krijuar mundësi për zhvillimin e turizmit, biznesit dhe investimeve.

Planifikimi urban, në zonën qendrore janë krijuar dhe funksionalizuar disa hapësira për parkingje publike, megjithëse mbetet një nevojë e madhe dhe emergjente për zgjerimin dhe sistemimin e tyre, në funksion të rritjes së qarkullimit dhe zhvillimit urban.

Në Komunën e Junikut është planifikuar rregullimi i hapësirave të Sheshit “Edmond Hoxha”, ku parashihen ndërhyrje në infrastrukturën nëntokësore dhe rregullimi i sheshit, me qëllim të sigurimit të lëvizshmërisë më të mirë për qytetarët dhe qarkullimin në trafik. Po ashtu, ky projekt pritet t’i japë një pamje më të bukur qytetës së Junikut dhe përfshin edhe disa segmente të rrugëve rajonale.

Ndriçimi publik është zgjeruar gradualisht në pjesën më të madhe të territorit të komunës, duke ndikuar në rritjen e sigurisë publike, përmirësimin e kushteve të lëvizjes

gjatë natës dhe ngritjen e standardit të jetesës për qytetarët. Megjithatë, mbetet nevoja për zgjerim të mëtejme dhe modernizim të sistemit të ndriçimit publik.

Veçoritë natyrore, Juniku ka lloje të ndryshme peizazhesh, nga ai hidrografik (lumenjtë Erenik dhe Lumi i Qetë), peizazhe fushore (fusha e Junikut) dhe peizazhe kodrinore apo malore (Gjeravica, Maja e Gusanit, Rrasa e Zogut, Moronica). Me datën 28.08.2008 Kuvendi Komunal i Junikut ka shpallur Moronicën “zonë të veçantë të komunës së Junikut”. Kjo zonë mendohet të jetë “parku i ardhshëm i qytetës e cila do të përdoret përpos aktivitetëve tjerë edhe për zhvillimin e gastronomisë tradicionale me karakter të përkohshëm, që do të jetë si urë lidhëse në mes të parkut etnografik dhe parkut nacional Bjeshkët e Nemuna”. Në tërësinë e tij, Juniku paraqitet si entitet që ka qenë, është dhe do të jetë i lidhur ngushtë me natyrën.

Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave komunale dhe i pastrimit të rrugëve kryesore kryhet nga ndërmarrje private e cila e ka shtrirë aktivitetin e saj në të gjitha vendbanimet. Tash për tash grumbullimi i mbeturinave kryhet derë më derë për ekonomitë familjare dhe bizneset, ku çdo javë bëhet pastrimi i tyre. Deponimi i mbeturinave bëhet në deponinë qendrore rajonale të Pejës.

Juniku tani ka një deponi të mbeturinave inerte në të cilën planifikohet të bëhet trajtimi i mbeturinave inerte.

Sfidat kryesore në shërbime publike janë:

- Çështja e varrezave mbetet një ndër sfidat kryesore të Komunës së Junikut, për shkak se ato janë të shpërndara në lokacione të ndryshme. Megjithëse është ndërtuar një lokacion i dedikuar për varrezat e qytetës, qytetarët ende hezitojnë ta shfrytëzojnë atë. Në të ardhmen, duhet të shqyrtohet mundësia e subvencionimit dhe përmirësimit të kushteve infrastrukturore në varrezat e reja të qytetës, me qëllim të rritjes së përdorimit dhe funksionalitetit të tyre.
- Mungesa e mjeteve financiare për mirëmbajtjen më të mirë dhe zgjerimin e hapësirave publike, përfshirë edhe varrezat, mbetet evidente.
- Paqëndrueshmëria në furnizimin me energji elektrike dhe rrjeti i vjetër vazhdon të paraqesë sfidë për qytetarët dhe bizneset lokale.
- Mbrojtja e lumenjve dhe burimeve ujore.
- Mungesa e bashkërendimit të planeve dhe projeksioneve buxhetore ndërmjet institucioneve lokale dhe ndërmarrjeve publike, të cilat janë përgjegjëse për investime në ujësjellës, kanalizim dhe sistemin e ujitjes, paraqet pengesë në realizimin efikas të projekteve infrastrukturore.

Të gjithë qytetarët e Komunës së Junikut kanë qasje në shërbimet publike, dhe këtë shërbim e marrin rreth 1000 amvisëri dhe biznese.

6.8 Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

Numri i familjeve të cilët kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale gjatë vitit 2025 është 469 familjeve ($469/12 = 39$ familje përfituese çdo muaj), mesatareja mujore është rreth 125 anëtarë nga 39 familje, shuma vjetore e mjeteve financiare është 54,708,00 €.

Nga të dhënat që kemi pranuar nga Divizioni për Transparencë në Ministrinë e Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare, rezulton se në Komunën e Junikut në vitin 2026 ka 543 përfitues të pensioneve bazike të moshës, 422 përfitues të skemës së pensioneve për veteranët e luftës, 58 përfitues të pensioneve kontributpaguese të moshës, 100 përfitues të skemës së pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës, 0 përfitues të pensioneve invalidore të punës dhe 38 përfitues të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara. Numri i përgjithshëm i përfituesve nga këto skema pensionale është 1,161.

Në Komunën e Junikut funksionon vetëm një objekt shëndetësor, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), e cila ofron shërbime bazë shëndetësore për të gjithë qytetarët e komunës. Gjendja e objektit vlerësohet si shumë e mirë, si rezultat i investimeve dhe ndërhyrjeve të realizuara gjatë viteve të fundit në përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjen me aparaturë mjekësore moderne.

Gjatë vitit 2025, në QKMF janë ofruar gjithsej 41,346 shërbime shëndetësore, duke reflektuar rritje të ndjeshme të kërkesës për shërbime dhe përmirësim të kapaciteteve të institucionit. Rritja e numrit të shërbimeve lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e infrastrukturës së objektit, rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe pajisjen me teknologji dhe pajisje mjekësore bashkëkohore.

Në fushën e mirëqenies sociale, Qendra për Punë Sociale (QPS) në Komunën e Junikut ka trajtuar gjithsej 278 raste gjatë vitit 2025, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e saj ligjore. Rastet kanë përfshirë mbështetje sociale për familjet në nevojë, fëmijët pa përkujdesje prindërore, si dhe kategori të tjera të ndjeshme sociale.

6.9 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Nga sipërfaqja prej 7,776.9931 ha sa ka Komuna e Junikut, afërsisht 4,439 ha (57.08%) janë tokë bujqësore. Livadhet dhe kullotat zënë sipërfaqe prej rreth 2,000 ha (45.05%) nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore, si dhe pyjet që zënë mbi 3,029 ha (38.95%), të cilat paraqesin potencial për zhvillim.

Kulturat më të zhvilluara bujqësore janë: gruri, misri, fasulja, thekra, pastaj perimet si: specat, domatet, lakrat dhe qepët. Në masë mesatare kultivohen kulturat e pemëtarisë si: molla, dardha, vishnja, boronica, mjedra dhe dredhëza, por kohëve të fundit shihet

tendenca e rritjes së mëtejshme të sipërfaqeve të pemishteve, me një favorizim të rritjes së kapaciteteve të ujitjes.

Në vitin 2025 kemi 18 fermerë që merren me sektorin e bletarisë, me gjithsej 802 koshere me bletë, 18 fermerë që merren me sektorin e blegtorisë, me mbi 150 krerë lopë qumështore dhe 4 fermerë që kanë rreth 900 krerë dele.

Në vitin 2025 kemi 32 fermerë që merren me kulturën e grurit me sipërfaqe prej 82.16 ha dhe 37 fermerë që merren me kulturën e misrit me sipërfaqe prej 100.36 ha.

Nën sistemin e ujitjes janë 960 ha tokë punuese.

Toka bujqësore e kulturës arë, gjithsej 653 ha, është e klasifikuar si vijon:

Kategoria I (22 ha),

Kategoria II (116 ha),

Kategoria III (181 ha),

Kategoria IV (40 ha),

Kategoria V (265 ha),

Kategoria VI (14 ha),

Kategoria VII (5 ha).

Numri i bizneseve aktive në vitin 2025 është 115, prej tyre 15 me aktivitet Bujqesia, Pylltaria dhe Peshkimi.

Përveç prodhimit bujqësor tradicional, Komuna e Junikut ka potencial për zhvillimin e bujqësisë me vlerë të shtuar, përfshirë prodhimin organik, agropërpunimin, produktet pyjore jodrusore dhe aktivitetet e lidhura me agroturizmin. Shfrytëzimi i këtyre potencialeve mund të kontribuojë në diversifikimin e të ardhurave të ekonomive familjare rurale dhe në krijimin e vendeve të reja të punës.

Komuna e Junikut posedon potencial të konsiderueshëm për kultivimin dhe valorizimin e gështenjës, e cila përfaqëson një produkt karakteristik të zonës. Përmes mbështetjes së kultivimit, përpunimit, paketimit dhe promovimit të saj, gështenja mund të kontribuojë në rritjen e të ardhurave të fermerëve, zhvillimin e agro-përpunimit dhe promovimin e agroturizmit lokal.

6.10 Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore

Në Komunën e Junikut, gjatë vitit 2025 kanë qenë aktive 3 organizata joqeveritare, ndërsa janë organizuar rreth 10 aktivitete rinore. Aktualisht funksionojnë Klubi i Pingpongut, Klubi i Shahut, Klubi i Futbollit, i cili është i dedikuar kryesisht për fëmijë, si dhe Klubi i Atletikës, i cili organizon pothuajse çdo vit aktivitetin tradicional "Vrapimi i Pavarësisë".

Ndërsa turizmi ende nuk është sektor i zhvilluar në mënyrën më të mirë, edhe pse

potenciali natyror dhe ai kulturor ekzistojnë. Vendet turistike të zhvilluara vijnë të jenë Bjeshkët e Junikut me lokacionet si Gropa e Erenikut, Kanioni i Junikut, Livadhi i Madh etj.

Sfidë mbeten çështjet ligjore mbi statusin e pazgjidhur të bujtinave (staneve), si dhe fakti që aktualisht kemi vetëm tre biznese që merren me akomodimin e turistëve.

6.11 Përkufizimi i problemit

Procesi i përkufizimit të problemit në kuadër të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Junikut është realizuar përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe analitike, duke kombinuar burime të ndryshme të të dhënave dhe konsultimeve institucionale.

Në këtë proces janë përfshirë:

- Raportet e drejtorive komunale dhe zyrtarët përgjegjës;
- Analiza e raporteve të monitorimit të zbatimit të aktiviteteve në sektorë të ndryshëm;
- Hulumtime sekondare dhe shqyrtim i dokumenteve strategjike ekzistuese;
- Analiza e të dhënave statistikore dhe indikatorëve ekonomikë;
- Analiza sektoriale e fushave kryesore të zhvillimit ekonomik.

Nga këto analiza është identifikuar se problemi kryesor i zhvillimit ekonomik në Komunën e Junikut lidhet me nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik lokal dhe mungesën e mjaftueshme të investimeve private, e cila ndikon drejtpërdrejt në mundësitë e kufizuara të punësimit, zhvillimin e pamjaftueshëm të bizneseve lokale dhe shfrytëzimin jo të plotë të potencialeve natyrore dhe turistike të komunës.

6.12 Krahassimi me komunitat të tjera

Për qëllime krahasimi janë marrë si referencë komunitat e Deçanit dhe Pejës, të cilat kanë ngjashmëri të konsiderueshme gjeografike, natyrore dhe potencial të lartë për zhvillim të turizmit malor dhe rural.

Në këto komuna është vërejtur:

- Nivel më i lartë i zhvillimit të turizmit malor dhe agroturizmit;
- Investime më të mëdha në infrastrukturë turistike dhe rrugore;
- Bashkëpunim më i zhvilluar me sektorin privat dhe donatorët ndërkombëtarë;
- Menaxhim më i avancuar i resurseve turistike dhe promovim më i fuqishëm i destinacioneve.

Në veçanti, në Komunën e Pejës, zhvillimi i zonave të bjeshkëve është ndikuar pozitivisht edhe nga fakti se një pjesë e konsiderueshme e këtyre hapësirave është në pronësi private, gjë që ka mundësuar investime më fleksibile dhe zhvillim më të shpejtë të kapaciteteve turistike dhe akomoduese.

Ndërsa Komuna e Junikut, megjithëse posedon potencial të ngjashëm natyror dhe strategjik, ende përballet me sfida në:

- Mungesë e investimeve në infrastrukturë turistike;
- Zhvillimin e pamjaftueshëm të shërbimeve mbështetëse;
- Mungesë e kapaciteteve akomoduese.

6.13 SWOT analiza

Përparësitë	Dobësitë
- Potencial i lartë për turizëm malor, natyror dhe rural - Resurse natyrore të pasura (Bjeshkët e Junikut, Ereniku, etj.) - Pozicion gjeografik strategjik dhe afër kufirit me Shqipërinë - Infrastrukturë rrugore dhe shërbime bazike relativisht të mira - Traditë në bujqësi, blegtori dhe bletari - Trashëgimi kulturore dhe historike - Diasporë aktive me potencial investues - Potencial për zhvillimin e produkteve tradicionale përfshirë gështenjën dhe produktet pyjore	- Rënie e popullsisë dhe emigrim i të rinjve - Nivel i ulët i investimeve private dhe numër i kufizuar biznesesh - Mungesë e kapaciteteve akomoduese dhe shërbimeve turistike - Mungesa e bazës ligjore të definuar mbi Bjeshkët e Junikut - Infrastrukturë energjetike e vjetruar dhe furnizim jo stabil me energji - Zhvillim i pamjaftueshëm i turizmit dhe digjitalizimit
Rreziqet	Mundësitë
- Depopullimi dhe emigrimi i vazhdueshëm - Konkurrenca nga komunat fqinje më të zhvilluara - Degradimi i mjedisit natyror nëse nuk menaxhohet mire - Kufizimet buxhetore komunale - Rritja e kostos së energjisë dhe paqëndrueshmëria ekonomike	- Zhvillimi i turizmit malor dhe agroturizmit - Tërheqja e investimeve nga donatorët vendor dhe ndërkombëtarë BE, Mërgata - Zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë, bletarisë dhe sektoreve tjera. - Zhvillimi i resurseve pyjore - Digjitalizimi i shërbimeve - Partneritetet publiko-private për projekte infrastrukturore dhe turistike

- Ndryshimet klimatike, thatësitat dhe fatkeqësitë natyrore - Konkurrenca nga rajonet tjera turistike	- Bashkëpunimi ndërkufitar me Shqipërinë dhe projektet rajonale - Zhvillimi i bujqësisë organike dhe produkteve me vlerë të shtuar - Lidhja e bujqësisë me agroturizmin dhe gastronominë tradicionale - Brendimi dhe promovimi i gështenjës së Junikut dhe produkteve tradicionale
--	---

Tabela nr 13. SWOT analiza

6.14 Përmbledhja e sfidave

Ky seksion përmbledh sfidat kryesore sektoriale që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe social të Komunës së Junikut, duke u bazuar në analizat dhe konsultimet me palët e interesit.

Sfidat në sektorin e Arsimit

- Mungesa e hapësirave adekuate sportive dhe rekreative në shkollat ekzistuese, përfshirë mungesën e terreneve të jashtme sportive.
- Nevoja për zhvillimin e arsimit profesional të orientuar në tregun e punës, veçanërisht në fushat e turizmit, gastronomisë, artizanatit dhe bujqësisë.
- Migrimi i të rinjve, i cili ndikon në zvogëlimin e potencialit njerëzor dhe kontinuitetit zhvillimor lokal.

Sfidat në sektorin e Infrastrukturës

- Transporti publik i paorganizuar dhe mungesa e lidhjeve të strukturuar ndërrbane dhe ndërshatare.
- Mbulimi i pjesshëm i shërbimeve publike si ujësjellësi, kanalizimi, telekomunikimi dhe furnizimi me energji elektrike në tërë territorin.
- Mungesa e hapësirave publike të mjaftueshme për kulturë, sport dhe rekreacion, që ndikon në cilësinë e jetës dhe rritjen e migrimit.

Sfidat në sektorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

- Kapacitetet e kufizuara të institucioneve shëndetësore për zgjerim të shërbimeve dhe përmirësim të infrastrukturës shëndetësore.
- Niveli i lartë i papunësisë dhe mungesa e mundësive të mjaftueshme për punësim, si faktor ndikues në mirëqenien sociale.
- Nevoja për zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit social, veçanërisht për personat e moshuar dhe kategoritë e cënueshme.

Sfidat në sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

- Fragmentimi i tokës bujqësore dhe qasja e kufizuar në parcelat bujqësore.
- Mungesa e organizimit të fermerëve dhe bashkëpunimit institucional në formën e kooperativave ose shoqatave profesionale.
- Infrastruktura e ujitjes e pamjaftueshme dhe jo e zhvilluar në mënyrë të plotë.
- Menaxhimi jo i qëndrueshëm i resurseve pyjore dhe prezenca e prerjeve ilegale.
- Diversifikimi i pamjaftueshëm i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale dhe mungesa e lidhjes së prodhimit bujqësor me përpunimin, turizmin dhe tregun.

Sfidat në sektorin e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore

- Potencial i madh turistik i pashfrytëzuar në mënyrë të mjaftueshme në aspektin ekonomik dhe institucional.
- Mungesa e institucioneve kulturore funksionale si muze, teatër apo qendra kulturore.
- Mbrojtje dhe promovim i pamjaftueshëm i trashëgimisë kulturore dhe historike të komunës.
- Mos-harmonizimi i plotë i kornizës ligjore dhe rregullative ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror, që krijon vështirësi në menaxhimin, zhvillimin dhe shfrytëzimin e resurseve turistike.

VII Objektivat

7.1 Objektiva e përgjithshme 1: Arsimi

Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore përmes avancimit të infrastrukturës arsimore, arsimit profesional dhe përfshirjes së të rinjve në tregun e punës.

7.1.1 Objektiva specifike 1

Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë në institucionet arsimore.

7.1.1.1 Përmirësimi i infrastrukturës dhe ambienteve shkollore

7.1.1.2 Renovimi dhe rehabilitimi i objekteve shkollore

7.1.1.3 Ndërtimi dhe rregullimi i terreneve sportive dhe hapësirave rekreative

7.1.1.2.1 Modernizimi i mjedisit mësimor

7.1.1.2.2 Pajisja e shkollave me laboratorë dhe teknologji informative

7.1.1.2.3 Furnizimi i shkollave me inventar dhe mjete bashkëkohore mësimore

7.1.2 Objektiva specifike 2

Zhvillimi i arsimit profesional dhe lidhja e tij me tregun e punës.

- 7.1.2.1 Zhvillimi i drejtimeve profesionale prioritare
 - 7.1.2.1.1 Zhvillimi i programeve profesionale në turizëm, gastronomi dhe shërbime
 - 7.1.2.1.2 Pajisja e kabineteve profesionale me pajisje praktike
- 7.1.2.2 Rritja e aftësimit praktik të të rinjve
 - 7.1.2.2.1 Bashkëpunimi me bizneset lokale për praktikë profesionale
 - 7.1.2.2.2 Organizimi i trajnimeve profesionale dhe kurseve certifikuese

7.1.3 Objektiva specifike 3

Rritja e përfshirjes së të rinjve dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.

- 7.1.3.1 Rritja e mundësive për zhvillim personal dhe profesional
 - 7.1.3.1.1 Mbështetje e programeve rinore dhe edukative
 - 7.1.3.1.2 Promovimi i orientimit profesional dhe këshillimit në karrierë
- 7.1.3.2 Parandalimi i migrimit të të rinjve
 - 7.1.3.2.1 Mbështetje financiare me bursa për nxënësit dhe studentët e dalluar
 - 7.1.3.2.2 Bashkëpunimi me mërgatën për projekte arsimore dhe profesionale

7.2 Objektiva e përgjithshme 2: Infrastruktura

Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës së transportit, infrastrukturës teknike dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme në territorin e Komunës së Junikut, sipas standardeve bashkëkohore dhe nevojave zhvillimore lokale.

7.2.1 Objektiva specifike 1

Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës rrugore dhe qasjes turistike

- 7.2.1.1 Përmirësimi i rrjetit rrugor lokal dhe rajonal
 - 7.2.1.1.1 Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale dhe rajonale
 - 7.2.1.1.2 Ndërtimi i mureve mbrojtëse, urave dhe elementeve përcjellëse rrugore
- 7.2.1.2 Përmirësimi i qasjes turistike dhe ndërkufitare
 - 7.2.1.2.1 Hapja dhe trasimi i rrugëve malore
 - 7.2.1.2.2 Përmirësimi i lidhjeve rrugore me Shqipërinë dhe komunat fqinje

7.2.2 Objektiva specifike 2

Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe sigurisë në trafik.

7.2.2.1 Zhvillimi i transportit publik

7.2.2.1.1 Përmirësimi i transportit publik ndërrurban

7.2.2.1.2 Rregullimi i hapësirave për taxi dhe stacione transporti

7.2.2.2 Përmirësimi i sigurisë për këmbësorë dhe biçiklistë

7.2.2.2.1 Ndërtimi dhe zgjerimi i trotuareve dhe shtigjeve

7.2.2.2.2 Vendosja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal

7.2.3 Objektiva specifike 3

Modernizimi i infrastrukturës teknike dhe hapësirave publike.

7.2.3.1 Përmirësimi i shërbimeve bazike

7.2.3.1.1 Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit

7.2.3.1.2 Modernizimi i ndriçimit publik dhe shërbimeve digjitale komunale

7.2.3.1.3 Modernizimi i sistemeve të ujitjes

7.2.3.2 Përmirësimi i hapësirave publike

7.2.3.2.1 Ndërtimi dhe rregullimi i parkingjeve, parqeve dhe tregjeve

7.2.3.2.2 Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave dhe gjelbërimit urban

7.3 Objektiva e përgjithshme 3: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe rritja e mirëqenies sociale për qytetarët e Komunës së Junikut.

7.3.1 Objektiva specifike 1

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

7.3.1.1 Modernizimi i infrastrukturës dhe pajisjeve shëndetësore

7.3.1.1.1 Pajisja e QKMF-së me pajisje moderne mjekësore

7.3.1.1.2 Digjitalizimi i shërbimeve shëndetësore

7.3.1.2 Ngritja e kapaciteteve profesionale

7.3.1.2.1 Trajnimi i stafit shëndetësor

7.3.1.2.2 Specializimi dhe avancimi profesional i personelit

7.3.2 Objektiva specifike 2

Përmirësimi i qasjes në shërbime shëndetësore.

7.3.2.1 Rritja e kapaciteteve njerëzore
7.3.2.1.1 Angazhimi i stafit shtesë shëndetësor
7.3.2.1.2 Përmirësimi i shërbimeve emergjente

7.3.2.2 Përmirësimi i kushteve të punës
7.3.2.2.1 Renovimi i hapësirave të QKMF-së
7.3.2.2.2 Pajisja me inventar dhe mjete mbështetëse

7.3.3 Objektiva specifike 3

Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe promovimi i jetës së shëndetshme.

7.3.3.1 Vetëdijesimi dhe parandalimi
7.3.3.1.1 Organizimi i fushatave vetëdijesuese
7.3.3.1.2 Organizimi i kontrolleve parandaluese

7.3.3.2 Mbështetja sociale
7.3.3.2.1 Mbështetja e familjeve dhe kategorive në nevojë
7.3.3.2.2 Bashkëpunimi me OJQ-të dhe donatorët për programe sociale

7.4 Objektiva e përgjithshme 4: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural përmes rritjes së prodhimit bujqësor, përmirësimit të infrastrukturës rurale dhe mbështetjes së fermerëve dhe agro-bizneseve në Komunën e Junikut.

7.4.1 Objektiva specifike 1

Rritja e prodhimit bujqësor dhe modernizimi i sektorit të bujqësisë.

7.4.1.1 Rritja e sipërfaqeve të kultivuara dhe e prodhimit bujqësor.
7.4.1.1.1 Mbështetja e fermerëve me subvencione për fara, plehra dhe mekanizëm bujqësor.
7.4.1.1.2 Promovimi i kultivimit të kulturave intensive dhe zhvillimi i serrave.
7.4.1.2 Rritja e kapaciteteve të ujitjes së tokave bujqësore.
7.4.1.2.1 Ndërtimi dhe rehabilitimi i kanaleve të ujitjes.
7.4.1.2.2 Ndërtimi i sistemit të ujitjes në tokat bujqësore me sistem të mbyllur.

7.4.2 Objektiva specifike 2

Zhvillimi i blegtorisë, bletarisë dhe pemëtarisë.

- 7.4.2.1 Rritja e numrit të fermerëve dhe kapaciteteve blegtorale.
- 7.4.2.1.1 Mbështetja e fermerëve për ngritjen dhe zgjerimin e fermave blegtorale.
- 7.4.2.1.2 Trajnime për standardet e prodhimit dhe menaxhimin e fermave.
- 7.4.2.2 Rritja e prodhimit në sektorin e bletarisë dhe pemëtarisë.
- 7.4.2.2.1 Subvencionimi i koshereve të bletëve dhe pajisjeve për bletari.
- 7.4.2.2.2 Mbështetja për zgjerimin e pemishteve, kultivimin e gështenjës dhe kulturave të tjera me vlerë të lartë ekonomike.
- 7.4.2.2.3 Promovimi dhe brendimi i produkteve karakteristike të Junikut, përfshirë gështenjën, mjaltin, boronicën dhe produktet tradicionale.

7.4.3 Objektiva specifike 3

Përmirësimi i organizimit rural dhe zhvillimi i agro-biznesit.

- 7.4.3.1 Rritja e bashkëpunimit dhe organizimit të fermerëve.
- 7.4.3.1.1 Krijimi dhe mbështetja e shoqatave dhe kooperativave bujqësore.
- 7.4.3.1.2 Organizimi i trajnimeve dhe fushatave vetëdijesuese për fermerët.
- 7.4.3.2 Zhvillimi i agro-biznesit dhe promovimi i produkteve lokale.
- 7.4.3.2.1 Mbështetja e bizneseve për përpunimin, paketimin dhe certifikimin e produkteve bujqësore.
- 7.4.3.2.2 Organizimi i panairëve, promovimi dhe brendimi i produkteve lokale, si dhe krijimi i lidhjeve tregtare me mërgatën dhe tregjet rajonale.

7.5 Objektiva e Përgjithshme 5: Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore

Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore përmes valorizimit të potencialeve natyrore, kulturore dhe historike, me qëllim rritjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe promovimin e identitetit të Komunës së Junikut.

7.5.1 Objektiva specifike 1

Rritja e numrit të vizitorëve në zonat me potencial turistik.

- 7.5.1.1 Hartimi, shenjëzimi dhe mirëmbajtja e shtigjeve turistike.
- 7.5.1.1.1 Hartimi, shenjëzimi dhe mirëmbajtja e shtigjeve për ecje malore, alpinizëm dhe çiklizëm malor.
- 7.5.1.1.2 Vendosja e pikave informuese turistike dhe materialeve promovuese në zonat kryesore natyrore.
- 7.5.1.2 Përmirësimi i infrastrukturës turistike në zonat me potencial turistik
- 7.5.1.2.1 Ndërtimi dhe rregullimi i zonave të kampingut dhe hapësirave rekreative

7.5.1.2.2 Përmirësimi i qasjes rrugore, sinjalistikës dhe infrastrukturës turistike në Bjeshkët e Junikut dhe lokacionet tjera turistike

7.5.2 Objektiva specifike 2

Mbrojtja, restaurimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

7.5.2.1 Rritja e numrit të objekteve të restauruara dhe të konservuara të trashëgimisë kulturore

7.5.2.1.1 Restaurimi dhe konservimi i kullave, mullinjve dhe objekteve tradicionale me vlera historike

7.5.2.1.2 Përditësimi i inventarit dhe dokumentimi i plotë i trashëgimisë kulturore në territorin e Komunës

7.5.2.2 Rritja e promovimit të trashëgimisë kulturore përmes turizmit kulturor dhe materialeve promovuese

7.5.2.2.1 Krijimi i një qendre lokale multifunksionale për promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Junik.

7.5.2.2.2 Organizimi i festivaleve dhe ngjarjeve kulturore

7.5.3 Objektiva specifike 3

Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm dhe fuqizimi i ekonomisë lokale

7.5.3.1 Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit lokal në sektorin e turizmit

7.5.3.1.1 Trajnimi i banorëve lokalë për shërbime turistike (udhërrëfyes, mikpritje, gastronomi)

7.5.3.1.2 Mbështetja për zhvillimin e bujtinave familjare, agroturizmit, eko-turizmit dhe gastronomisë tradicionale.

7.5.3.2 Tërheqja e investimeve dhe promovimi i potencialeve ekonomike përmes turizmit.

7.5.3.2.1 Organizimi i forumeve ekonomike, promovimi i potencialeve investuese dhe krijimi i partneriteteve sidomos me mërgatën.

7.5.3.2.2 Mbështetja e investimeve të mërgatës dhe promovimi i produkteve lokale, artizanale, bujqësore dhe gastronomike në funksion të zhvillimit të turizmit.

7.5.3.2.3 Hartimi, publikimi dhe përditësimi i Profilit Ekonomik të Komunës së Junikut për promovimin e potencialeve investuese dhe zhvillimit ekonomik lokal.

VIII Monitorimi dhe Raportimi

Monitorimi dhe raportimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2026 – 2033 të Komunës së Junikut do të realizohet në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme, me qëllim të vlerësimit të progresit në zbatimin e objektivave strategjike dhe aktiviteteve të parapara në planin e veprimit. Procesi i monitorimit do të bazohet në objektivat e përgjithshme, objektivat specifike dhe treguesit e përcaktuar në strategji, duke mundësuar matjen e rezultateve të arritura dhe identifikimin e sfidave gjatë zbatimit.

Monitorimi do të shërbejë si mekanizëm për të vlerësuar shkallën e realizimit të aktiviteteve, efikasitetin në përdorimin e resurseve financiare dhe institucionale, si dhe ndikimin e masave të ndërmarra në zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë kuadër, secila drejtori komunale dhe institucion përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve do të ketë obligim të ofrojë të dhëna periodike lidhur me progresin e arritur, rezultatet konkrete dhe sfidat e hasura gjatë implementimit.

Raportimi për zbatimin e strategjisë do të realizohet në baza vjetore dhe do të përfundojë brenda tremujorit të parë të vitit pasues, duke përfshirë informata të detajuara mbi:

- Shkallën e realizimit të objektivave të përcaktuara;
- Nivelin e zbatimit të aktiviteteve dhe projekteve prioritare;
- Burimet financiare të përdorura dhe nivelin e ekzekutimit buxhetor;
- Problemet dhe pengesat e identifikuara gjatë implementimit;
- Masat korrigjuese dhe rekomandimet për përmirësimin e procesit të zbatimit.

Bazuar në raportet e monitorimit, sipas nevojës do të realizohet rishikimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit, me qëllim përshtatjen e objektivave, aktiviteteve dhe prioriteteve ndaj ndryshimeve ekonomike, sociale apo institucionale. Ky proces do të mundësojë që strategjia të mbetet relevante, e zbatueshme dhe në përputhje me nevojat reale të zhvillimit ekonomik të Komunës së Junikut.

Në funksion të transparencës dhe llogaridhënies, raportet e monitorimit do të prezantohen para organeve komunale dhe do të publikohen për qytetarët dhe palët e interesit, duke siguruar informim të rregullt mbi progresin e zbatimit të strategjisë dhe rezultatet e arritura.

IX Vlerësimi i ndikimit buxhetor

Përmbledhje e kostove të Strategjisë	Viti 1	Viti 2	Viti 3
	2026	2027	2028
Mbështetja e zotuar me ekspertë	7757.2 €	2,000 €	2,000 €
Mbështetja e zotuar buxhetore (e harmonizuar me KAB)	190,000 €	190,000 €	200,000 €
Mundësi potenciale financimi për donatorët	200,000 €	300,000 €	400,000 €
Buxheti i Komunës	2,538,612	2,539,474	2,473,702
Totali	2,936,369.20€	3,031,474 €	3,075,702 €

Tabela 14. Vlerësimi i ndikimit buxhetor

Në vitin 2026, mbështetja e zotuar me ekspertë përfaqëson koston e angazhimit të Komisionit Hartues gjatë procesit të hartimit të Strategjisë. Ndërsa, në vitet 2027 dhe 2028 janë planifikuar mjete orientuese për ekspertizë dhe mbështetje profesionale në funksion të monitorimit, vlerësimit dhe përditësimit të zbatimit të Strategjisë.

Vlerësimi i ndikimit buxhetor në këtë dokument paraqet projeksionin orientues të kostove dhe burimeve të financimit për tri vitet e para të zbatimit të Strategjisë (2026 – 2028), në përputhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB). Këto projeksione synojnë të sigurojnë realizimin gradual të objektivave strategjike, duke u mbështetur në buxhetin komunal, fondet nga donatorët dhe burime të tjera të financimit.

X Plani i Veprimit

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2026 - 2028 PËR KOMUNËN E JUNIKUT

Objektivi i përgjithshëm 1: Arsimi						
Objektivi specifik 1.1	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Përmirësimi i kushteve dhe cilësisë në institucionet arsimore.	Numri i objekteve shkollore të renovuara			1	2	3
	Numri i shkollave të pajisura me teknologji bashkëkohore			1	2	3
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Renovimi dhe rehabilitimi i objekteve shkollore	2026-2027	20,000 € 2026: 10,000 € 2027: 10,000 €	Komuna, Donatorë	DARKS	DUMK	Përmirësim i infrastruktures shkollore
2) Ndërtimi dhe rregullimi i terreneve sportive dhe hapësirave rekreative	2026-2027	400,000 € 2026: 70,000 € 2027: 330,000 €	Komuna, MASHTI, MZHR	DARKS	DUMK	Rritja e aktiviteteve sportive dhe rekreative
3) Pajisja me laboratorë dhe pajisje TI	2027-2028	40,000 € 2027: 20,000 € 2028: 20,000 €	Komuna, MASHTI	DARKS	DARKS	Digjitalizimi i procesit mësimor

4) Furnizimi i shkollave me inventar dhe mjete bashkëkohore mësimore	2026-2028	20,000 € 2026: 5,000 € 2027: 5,000 € 2028: 10,000 €	Komuna, Donatorë	DARKS	DARKS	Përmirësimi i kushteve të mësimdhënies
Objektivi specifik 1.2	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Zhvillimi i arsimit profesional dhe lidhja e tij me tregun e punës	Numri i programeve profesionale dhe trajnimeve të realizuara			3	3	4
	Numri i nxënësve të përfshirë në praktikë profesionale / bashkëpunim me bizneset			0	20	40
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Zhvillimi i programeve profesionale në turizëm, gastronomi dhe shërbime	2028	20,000 € 2028: 20,000 €	Komuna, Donatorë	DARKS	DARKS	Zgjerimi i ofertës së arsimit profesional sipas nevojave të tregut të punës lokal
2) Organizimi i trajnimeve profesionale dhe kurseve certifikuese për të rinjtë	2027-2028	10,000 € 2027: 5,000 € 2028: 5,000 €	Komuna, Donatorë	DARKS	DARKS	Ngritja e aftësive profesionale të të rinjve dhe rritja e mundësive për punësim
3) Bashkëpunimi me bizneset lokale dhe organizimi i praktikës profesionale / trajnimeve në vendin e punës	2027-2028	10,000 € 2027: 5,000 € 2028: 5,000 €	Komuna, Donatorë	DARKS	DARKS	Rritja e punësueshmërisë së të rinjve

Objektivi specifik 1.3	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Rritja e përfshirjes së të rinjve dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore	Numri i nxënësve/studentëve të mbështetur me bursa dhe programe zhvillimore			150	150	200
	Numri i programeve rinore / edukative / orientuese të realizuara			2	5	7
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Mbështetje financiare me bursa për nxënësit dhe studentët e dalluar	2026-2028	90,000 € 2026: 30,000 € 2027: 30,000 € 2028: 30,000 €	Komuna, Donatorë	DARKS	DARKS	Mbështetja për zhvillimin e të rinjve
2) Mbështetja e programeve rinore dhe edukative	2026-2028	15,000 € 2026: 5,000 € 2027: 5,000 € 2028: 5,000 €	Komuna, Donatorë	DARKS	DARKS	Fuqizimi i të rinjve përmes aktiviteteve edukative, sociale dhe zhvillimore
3) Promovimi i orientimit profesional dhe këshillimit në karrierë	2026-2028	21,000 € 2026: 7,000 € 2027: 7,000 € 2028: 7,000 €	Komuna, Donatorë	DARKS	DARKS	Orientim më i mirë profesional i të rinjve dhe rritje e informimit për mundësitë e arsimit dhe punësimit

Objektivi i përgjithshëm 2: Infrastruktura						
Objektivi specifik 2.1	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës rrugore dhe qasjes turistike	Rrugë të rehabilituara / asfaltuara Km			5	10	25
	Numri i rrugëve / segmenteve me elemente përcjellëse rrugore të ndërtuara / rehabilituara			1	3	5
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale dhe rajonale	2026-2028	1,500,000 € 2026: 1100,000 € 2027: 200,000 € 2028: 200,000 €	Komuna, MMPHI	DUMK	DSHPMI	Përmirësimi i qarkullimit rrugor dhe zonave të banuara
2) Ndërtimi i mureve mbrojtëse, urave dhe elementeve përcjellëse rrugore	2028	50,000 € 2028: 50,000	Komuna, Donatorë	DUMK	DSHPMI	Mbrojtja e infrastrukturës nga dëmtimet
3) Hapja dhe trasimi i rrugëve malore	2026-2027	150,000 € 2026: 120,000 € 2027: 30,000 €	Komuna, Donatorë	DUMK	DSHPMI	Përmirësimi i qasjes në zonat turistike malore
Objektivi specifik 2.2	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe sigurisë në trafik	Numri i trotuareve / shtigjeve të ndërtuara ose			2	6	10
	Numri i ndërhyrjeve në sinjalizim, stacione pritese dhe hapësira për taxi			1	5	6

Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Rregullimi i hapësirave për taxi dhe stacione pritese	2028	15,000 € 2028: 15,000 €	Komuna, Donatorë	DUMK	DSHPMI	Krijimi i hapësirave funksionale dhe më të sigurta
2) Ndërtimi dhe zgjerimi i trotuareve dhe shtigjeve për biçiklistët	2026-2028	350,000 € 2026: 50,000 € 2027: 100,000 € 2028: 200,000 €	Komuna, Donatorë	DUMK	DSHPMI	Rritja e sigurisë për këmbësorët dhe biçiklistët
3) Vendosja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal	2026-2028	50,000 € 2026: 10,000 € 2027: 20,000 € 2028: 20,000 €	Komuna, Donatorë	DUMK	DSHPMI	Përmirësimi i sigurisë në trafik
Objektivi specifik 2.3	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Modernizimi i infrastrukturës dhe hapësirave publike	Numri i projekteve të realizuara në ujësjellës, kanalizim, ndriçim publik, ujitje ose shërbime digjitale			2	5	7
	Numri i hapësirave publike të rregulluara / funksionalizuara (parkingje, parqe, tregje, gjelbërim, menaxhim i mbeturinave)			1	4	5
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati

1) Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit	2026-2027	34,000 € 2026: 20,000 € 2027: 14,000 €	Komuna, KRU, Donatorë	DUMK	DSHPMI	Përmirësimi i qasjes në shërbime bazike
2) Modernizimi i ndriçimit publik dhe shërbimeve digjitale komunale	2026-2027	40,000 € 2026: 20,000 € 2027: 20,000 €	Komuna, Donatorë	DUMK	DSHPMI	Kritja e shërbimeve publike
3) Ndërtimi dhe rregullimi i parkingjeve, parqeve dhe tregjeve	2027-2028	60,000 € 2027: 20,000 € 2028: 40,000 €	Komuna, Donatorë	DUMK	DSHPMI	Krijimi i hapësirave publike funksionale

Objektivi i përgjithshëm 3: SHËNDETËSIA DHE MIRËQENIA SOCIALE

Objektivit specifik 3.1	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore	Numri i pajisjeve moderne mjekësore të siguruara			5	5	10
	Numri i stafit shëndetësor të trajnuar			10	20	30
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Pajisja e QKMF-së me pajisje dhe teknologji moderne mjekësore	2027-2028	20,000 € 2027: 15,000 € 2028: 5,000 €	Komuna, MSH, Donatorë	DSHMS	DSHMS	Përmirësim i shërbimeve shëndetësore

2) Digjitalizimi i shërbimeve shëndetësore	2026	8,000 € 2026: 8,000 €	Komuna, Donatorë	DSHMS	DSHMS	Rritja e efikasitetit të menaxhimit të të dhënave
3) Trajnimi i stafit shëndetësor	2026-2028	15,000 € 2026: 5,000 € 2027: 5,000 € 2028: 5,000 €	Komuna, MSH, Donatorë	DSHMS	DSHMS	Shërbime më efikase
Objektivi specifik 3.2	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Përmirësimi i qasjes në shërbime shëndetësore	Numri i ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve të punës dhe shërbimeve emergjente			1	3	5
	Numri i shërbimeve / hapësirave të përmirësuara në QKMF			1	2	4
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Përmirësimi i shërbimeve emergjente	2026-2028	40,000 € 2026: 10,000 € 2027: 10,000 € 2028: 20,000 €	Komuna, MSH, Donatorë	DSHMS	DSHMS	Rritja e gatishmërisë dhe efikasitetit të shërbimeve
2) Renovimi i hapësirave të QKMF-së	2026-2027	70,000 € 2026: 50,000 € 2027: 20,000 €	Komuna, Donatorë	DSHMS	DUMK	Përmirësimi i ofrit të shërbimeve për pacientët
3) Pajisja me inventar dhe mjete mbështetëse	2027-2028	12,000 € 2027: 6,000 € 2028: 6,000 €	Komuna, MSH, Donatorë	DSHMS	DSHMS	Përmirësimi i kushteve të punës

Objektivi specifik 3.3	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe promovimi i jetës së shëndetshme	Numri i fushatave vetëdijesuese			2	5	7
	Numri i familjeve të mbështetura përmes programeve sociale / QPS			469	479	489
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Organizimi i kontrolleve parandaluese dhe fushatave vetëdijesuese	2026-2028	18,000 € 2026: 6,000 € 2027: 6,000 € 2028: 6,000 €	Komuna, MSH, Donatorë	DSHMS	DARKS, QKMF	Rritja e vetëdijesimit dhe kujdesit preventiv
2) Mbështetja e familjeve dhe kategorive në nevojë	2026-2028	75,000 € 2026: 20,000 € 2027: 25,000 € 2028: 30,000 €	Komuna, Donatorë	DSHMS	QPS	Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe mbështetja e kategorive në nevojë
3) Bashkëpunimi me OJQ-të dhe donatorët për programe sociale	2026-2028	21,000 € 2026: 7,000 € 2027: 7,000 € 2028: 7,000 €	Komuna, MSH, Donatorë	DSHMS	QPS	Zgjerimi i programeve sociale dhe rritja e mbështetjes për qytetarët në nevojë

Objektivi i përgjithshëm 4: BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL						
Objektivi specifik 4.1	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Rritja e prodhimit bujqësor dhe modernizimi i sektorit të bujqësisë	Numri i fermerëve përfitues			80	120	130
	Numri i fermave/bletarëve/pemishteve të mbështetura			50	60	70
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Mbështetja e fermerëve me subvencione për fara, plehra dhe mekanizëm bujqësor	2027-2028	25,000 € 2027: 10,000 € 2028: 15,000 €	Komuna, MBPZHR, Donatorë	DZHE	Zyra e Kryetarit	Rritja e prodhimit bujqësor dhe mbështetja e fermerëve me inpute bazë
2) Ndërtimi dhe rehabilitimi i kanaleve të ujitjes	2026	41,000 € 2026: 41,000 €	Komuna, Donatorë	DZHE	DUMK	Përmirësimi i infrastrukturës dhe sipërfaqeve të tokave bujqësore nën ujitjes
3) Promovimi i kultivimit të kulturave intensive dhe zhvillimi i serrave	2027-2028	20,000 € 2027: 10,000 € 2028: 10,000 €	Komuna, Grande, MBPZHR	DZHE	DZHE	Rritja e sipërfaqeve të dhe zgjerimi i prodhimit në sera.
Objektivi specifik 4.2	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028

Zhvillimi i blegtorisë, bletarisë dhe pemëtarisë	Numri i fermerëve të mbështetur në blegtori, bletari dhe pemëtari			40	50	90
	Numri i trajnimeve / ndërhyrjeve mbështetëse në blegtori, bletari dhe pemëtari			2	5	7
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Mbështetja e fermerëve për ngritjen dhe zgjerimin e fermave blegtorale	2028	30,000 € 2028: 30,000 €	Komuna, MBPZHR, Donatorë	DZHE	DZHE	Rritja e kapaciteteve blegtorale dhe fuqizimi i fermave familjare
2) Subvencionimi i koshereve të bletëve dhe pajisjeve për bletari	2027-2028	15,000 € 2027: 5,000 € 2028: 10,000 €	Komuna, MBPZHR, Donatorë	DZHE	Zyra e Kryetarit	Rritja e prodhimit dhe kapaciteteve në sektorin e bletarisë
3) Mbështetja për zgjerimin e pemishteve dhe kultivimin e kulturave me vlerë të lartë	2028	25,000 € 2028: 25,000 €	Komuna, MBPZHR, Donatorë	DZHE	DUMK	Zgjerimi i pemishteve dhe rritja e prodhimit me vlerë më të lartë ekonomike
Objektivi specifik 4.3	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Përmirësimi i organizimit rural dhe zhvillimi i agro-biznesit	Numri i fermerëve / bizneseve të përfshira në trajnime, panaire ose forma bashkëpunimi			20	50	60
	Numri i bizneseve të mbështetura për promovim, përpunim ose certifikim të			0	2	5

Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Organizimi i trajnimeve dhe fushatave vetëdijesuese për fermerët	2027-2028	12,000 € 2027: 6,000 € 2028: 6,000 €	Komuna, MBPZHR, Donatorë	DZHE	DZHE	Ngritja e njohurive të fermerëve për praktika moderne bujqësore dhe menaxhim të fermës
2) Mbështetja e bizneseve për përpunimin, paketimin dhe certifikimin e produkteve bujqësore	2027-2028	50,000 € 2027: 20,000 € 2028: 30,000 €	Komuna, MBPZHR, Donatorë	DZHE	DZHE	Rritja e vlerës së shtuar të produkteve bujqësore dhe zhvillimi i agro-biznesit
3) Organizimi i panairove dhe promovimi i produkteve lokale	2027-2028	16,000 € 2027: 8,000 € 2028: 8,000 €	Komuna, MBPZHR, Donatorë	DZHE	Zyra e Kryetarit	Promovimi i produkteve lokale dhe zgjerimi i qasjes në treg

Objektivi i përgjithshëm 5: TURIZMI DHE TRASHËGIMIA KULTURORE						
Objektivi specifik 5.1	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Rritja e numrit të vizitorëve në zonat me potencial turistik.	Numri i shtigjeve turistike të shenjëzuara / mirëmbajtura			2	5	7
	Numri i pikave informuese, hapësirave rekreative dhe ndërhyrjeve në infrastrukturën turistike			1	4	6
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Hartimi, shenjëzimi dhe mirëmbajtja e shtigjeve për ecje malore, alpinizëm dhe çiklizëm malor	2026-2028	45,000 € 2026: 10,000 € 2027: 15,000 € 2028: 20,000 €	Komuna, Donatorë	DZHE	DUMK	Rritja e qasjes dhe orientimit të vizitorëve në zonat turistike
2) Vendosja e pikave informuese turistike dhe materialeve promovuese në zonat kryesore natyrore	2026-2028	30,000 € 2026: 8,000 € 2027: 12,000 € 2028: 10,000 €	Komuna, Donatorë	DZHE	DUMK	Rritja e informimit dhe promovimit të ofertës turistike të Junikut
3) Ndërtimi dhe rregullimi i zonave të kampingut dhe hapësirave rekreative	2027-2028	120,000 € 2027: 50,000 € 2028: 70,000 €	Komuna, MMPHI	DZHE	DUMK	Krijimi i hapësirave funksionale për qëndrim dhe rekreacion

4) Përmirësimi i qasjes rrugore, sinjalistikës dhe infrastrukturës turistike në Bjeshkët e Junikut dhe lokacionet tjera turistike	2026-2027	180,000 € 2026: 120,000 € 2027: 60,000 €	Komuna, Donatorë, MMPHI, MZHR	DZHE	DUMK	Përmirësimi i qasjes dhe kushteve infrastrukturore në zonat turistike
Objektivi specifik 5.2	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028
Mbrojtja, restaurimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore	Numri i objekteve të trashëgimisë kulturore të inventarizuara / dokumentuara / restauruara			2	4	6
	Numri i aktiviteteve kulturore dhe promovuese të organizuara			2	4	6
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Përditësimi i inventarit dhe dokumentimi i plotë i trashëgimisë kulturore në territorin e komunës	2027-2028	12,000 € 2027: 6,000 € 2028: 6,000 €	Komuna, Donatorë, Arkivi komunal	DARKS	DZHE	Krijimi i bazës së të dhënave për trashëgiminë kulturore të Junikut
2) Restaurimi dhe konservimi i kullave, mullinjve dhe objekteve tradicionale me vlera historike	2026-2028	570,000 € 2026: 200,000 € 2027: 200,000 € 2028: 170,000 €	Komuna, MKRS, Donatorë	DARKS	DZHE	Mbrojtja dhe ruajtja e objekteve me vlerë historike e kulturore
3) Organizimi i festivaleve dhe ngjarjeve kulturore	2026-2028	45,000 € 2026: 15,000 € 2027: 15,000 € 2028: 15,000 €	Komuna, Donatorë	DARKS	DZHE	Promovimi i identitetit kulturor të Junikut
Objektivi specifik 5.3	Treguesi për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Caku 2027	Caku 2028

Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm dhe fuqizimi i ekonomisë lokale	Numri i personave / bizneseve lokale të përfshira në trajnim, mbështetje ose aktivitete promovuese turistike			10	15	25
	Numri i iniciativave / partneriteteve / investimeve të mbështetura sektorin e turizmit			3	6	10
Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja Totale €	Burimi i financimit	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Rezultati
1) Hartimi, publikimi dhe përditësimi i Profilit Ekonomik të Komunës së Junikut	2026-2028	11,757.20 € 2026: 7,757.20 € 2027: 2,000 € 2028: 2,000 €	Komuna	DZHE	Zyra e Kryetarit	Profili Ekonomik i Komunës i hartuar për promovimin e zhvillimit ekonomik lokal
2) Trajnimi i banorëve lokalë për shërbime turistike (udhërrëfyes, mikpritje, gastronomi)	2027-2028	16,000 € 2027: 8,000 € 2028: 8,000 €	Komuna, Donatorë	DZHE	DARKS	Ngritja e kapaciteteve lokale
3) Mbështetja për zhvillimin e bujtinave familjare, agroturizmit, eko-turizmit dhe gastronomisë tradicionale	2027-2028	30,000 € 2027: 10,000 € 2028: 20,000 €	Komuna, Donatorë, Mërgata	DZHE	Zyra e Kryetarit	Zgjerimi i ofertës turistike dhe fuqizim ekonomik
4) Organizimi i forumeve ekonomike, promovimi i potencialeve investuese dhe krijimi i partneriteteve sidomos me mërgatën.	2027-2028	20,000 € 2027: 10,000 € 2028: 10,000 €	Komuna, Donatorë, Mërgata	DZHE	Zyra e Kryetarit	Promovimi i potencialeve turistike dhe tërheqja e investimeve të huaja



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Datë/ Datum/ Date:	21.07.2026
Për/ Za/ To:	z. Leonard Lolluni - Kryesues i Kuvendit Komunal
Përmes / Preko / Throught	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës së Junikut
Nga/ Od/ From:	z. Besart Tofaj - Nënkrjetar i Komunës së Junikut
Tema/ Subjekti/ Subject:	Kërkesë

I nderuar,

Bazuar në Planin e Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026, ku në muajin korrik është paraparë pika e rendit të ditës “Informatë rreth korrje - shirjeve të grurit në Komunën e Junikut”,

Andaj, në cilësinë e kryesuesit të Komisionit për përcjelljen e fushatës së korrje - shirjeve në Komunën e Junikut, ju përcjellim raportin mbi fushatën e korrje - shirjeve 2026 për pikën “Informatë rreth korrje - shirjeve të grurit në Komunën e Junikut”.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Datë/Datum/Date:	21.07.2026
Për/Za/To:	z. Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës së Junikut
CC:	znj. Venera Çerkini - Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Nga/Od/From:	Komisioni Komunal për korrje – shirje 2026
Tema/Subjekat/Subject:	Raporti mbi fushatën e korrje - shirjeve 2026

I/E nderuar,

Komisioni Komunal, i emëruar nga Kryetari i Komunës së Junikut, z. Ruzhdi Shehu, me Vendimin nr. 01/122, datë 30.06.2026, për monitorimin dhe realizimin e korrje - shirjeve për vitin 2026, ka këtë përbërje:

Besart Tofaj – Nënkyetar i Komunës së Junikut, kryesues i komisionit

Florentina Qestaj – Zyrtare për Bujqësi, anëtare e komisionit

Idriz Gacaferi – Inspektor i Ndërtimit, anëtar i komisionit

Komisioni Komunal, nga dita e emërimit, vazhdimisht ka qenë në terren, duke u njohur me vështirësitë dhe problemet e fermerëve dhe autokombajnerëve gjatë realizimit të procesit të korrje - shirjes, njëkohësisht duke u ofruar mbështetje profesionale për zgjidhjen e këtyre problemeve dhe vështirësive të mundshme.

Në Komunën e Junikut, korrje - shirja e grurit ka filluar më datë 05.07.2026, ndërsa më datë 18.07.2026 ka përfunduar procesi i korrje - shirjeve.

Është e rëndësishme të theksohet se në këtë operativ kanë marrë pjesë tre autokombajna, ku gjendja mekanike e tyre ka qenë e mirë dhe nuk ka pasur humbje të grurit.

Operativa e korrje - shirjes, përkundër disa problemeve të vogla, është realizuar ashtu siç është hartuar dhe planifikuar nga Komisioni Komunal.

Vlen të përmendet se çmimi për korrjen e një hektari, i rekomanduar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka qenë 140 euro/ha. Ky çmim i rekomanduar është respektuar nga autokombajnerët.

Në bazë të të dhënave nga terreni, rendimenti mesatar këtë vit ka qenë 4,200 kg/ha, i cili kryesisht është dërguar në mullinjtë më të afërt në Gjakovë, Pejë dhe Rahovcë. Gjithsej kanë qenë të mbjella 93.77 hektarë me grurë, sipas të dhënave të nxjerra nga 34 fermerët që kanë aplikuar për subvencione për sipërfaqet e mbjella me grurë.

Sfida kryesore që është paraqitur gjatë korrje - shirjes është:

- Parcelat me sipërfaqe të vogla dhe të shpërndara.
- Qasja e kufizuar në parcella për shkak të rrugëve sezonale dhe mospastrimit të tyre.

Për përfundimin me sukses të korrje - shirjeve, përveç kushteve të mira meteorologjike, kanë ndikuar edhe disa faktorë:

1. Prezenca e tre autokombajnave nga Komuna e Gjakovës.
2. Prezenca e Komisionit Komunal për monitorimin e korrje - shirjeve.

Komisioni vlerëson se fushata e korrje - shirjeve është zhvilluar me sukses në tërë territorin e Komunës së Junikut dhe se të gjithë bujqit që kanë pasur të mbjellë kulturën e grurit kanë arritur ta korrin atë me sukses.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JONIK - OPŠTINA JONIK - MUNICIPALITY JONIK

DATE/A:	22.07.2026
REFERENCE:	
PËR/TO:	z. Leonard Llojuni - Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES:	z. Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës
NGA/FROM:	Zenun Shala, Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis
REMA/SUBJECT:	Kërkesë

Për formimin e Komisionit për emërtimin e zonave të qarkullimit

I nderuarz. Leonard Llojuni Kryesues i Kuvendit Komunal,

Drejtori për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, duke u bazuar në nevojën për rregullimin dhe standardizimin e emërimit të rrugëve, në territorin e Komunës, si dhe me qëllim të përmirësimit të adresarit zyrtar, orientimit të qytetarëve, ofrimit efikas të shërbimeve publike dhe përmbushjes së obligimeve ligjore, kërkon nga Kuvendi Komunal marrjen e vendimit për formimin e Komisionit për Emërtimin e Zonave të Qarkullimit.

Formimi i këtij komisioni është i domosdoshëm për shqyrtimin profesional të propozimeve për emërtimin e Zonave të Qarkullimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore dhe interesin publik.

Detyrat kryesore të Komisionit do të jenë:

- Shqyrtimi i propozimeve për emërtimin e rrugëve,
- Vlerësimi i përputhshmërisë së propozimeve me legjislacionin në fuqi dhe kriteret përkatëse;
- Organizimi i konsultimeve publike, kur kërkohet;
- Hartimi i rekomandimeve dhe propozimeve për miratim në Kuvendin Komunal

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij procesi për zhvillimin urban, administrimin e adresave zyrtare dhe interesin e përgjithshëm të qytetarëve, kërkojmë që kjo çështje të përfshihet në rendin e ditës të mbledhjes së radhës së Kuvendit Komunal dhe të miratohet vendimi për formimin e Komisionit për Emërtimin e Rrugëve.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVES – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	13.07.2026
Referenc:	7/19
PËR/ZATTO:	z. Leonard Llojuni – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z. Xhavit Velijaj – Drejtori për Arsimit, Kulturë, Rini dhe sport (DAKRS)
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për shqyrtim dhe miratim të Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut për periudhën 2026–2030 (Leximi i parë)."

I nderuar,

— Duke u bazuar në vendimin me prot. 2-180/1637 të datës 06.03.2026 për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut 2026–2030, vendimit me nr. Prot. 1-180/3396 të datës 15.05.2026 për themelimin e grupit punues për hartimin e e planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut 2026–2030, dhe Planit të Punës së Kuvendit Komunal, në cilësinë kryesuesit të grupit punues, kërkoj që në mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), si dhe në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal, të përfshihet në rendin e ditës pika:

- **Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut për periudhën 2026–2030 (Leximi i parë).**

Përfshirja e kësaj pike në rendin e ditës është e rëndësishme për t'u informuar anëtarët e Kuvendit Komunal lidhur me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor të Arsimit për periudhën 2026–2030, përmbajtjen e tij, objektivat strategjike, prioritetet dhe aktivitetet e planifikuara për zbatimin e tij.

Njëkohësisht, shqyrtimi i dokumentit në lexim të parë do t'u mundësojë anëtarëve të Kuvendit Komunal të japin vërejtjet, rekomandimet dhe kontributin e tyre para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të këtij dokumenti të rëndësishëm strategjik për zhvillimin e arsimit në Komunën e Junikut.

Kërkesës i bashkangjitet dokumenti i Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Junikut për periudhën 2026–2030.

Me respekt!